REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

ASCAP

# METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË JASHTËM DHE TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR

Tiranë, 2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 305/1 Prot.

Tiranë, më 15.01.2025

**URDHËR**

**Nr. 18, datë 15.01.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E "KORNIZËS SË VLERËSIMIT TË CILËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR" DHE "METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjës "d" të pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.98, datë 27.02.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar" (ASCAP) dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Orjana Osmani",

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e "Kornizës së vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social shkollor" dhe "Metodologjisë për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të shërbimit psiko-social shkollor", bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**Orjana Osmani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

**Grupi koordinues:**

Gerti Janaqi - Drejtor i Përgjithshëm, ASCAP

Majlinda Ucaj - Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Organizimit të dhe Drejtimit në APU

Esion Zgjana - ASCAP, Specialist ne Sektorin e Kualifikimit dhe Zhvillimit Profesional, pranë Drejtorisë se Kurrikulës dhe Kualifikimit

Eniana Veli - Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Zbatimit të Cilësisë

**Koontribuuan:**

- Shkëlqim Allkaj
- Anilza Ferizaj
- Rezarta Basha
- Ekeld Alizoti
- Emanuela Garuli
- Olta Jaçellari
- Orsjola Miha
- Ezmeralda Xheraj
- Entela Burazeri
- Dafina Allkushi
- Mimoza Halili
- Fjorela Broli
- Ermilinda Zgjana
- Jona Hila
- Redon Tafilaku
- Ediola Jaupaj
- Mimoza Tahiri

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

# TABELA E PËRMBAJTJES


TABELA E PËRMBAJTJES ........................................................................ 3

HYRJE ........................................................................ 6

SISTEMI I VLERËSIMIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL ........................................................................ 9

Procesi i vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm ........................................................................ 11

Metodat dhe teknikat e vlerësimit ........................................................................ 11

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë ........................................................................ 11

Intervista ........................................................................ 12

Anketat dhe pyetësorët ........................................................................ 13

Shqyrtimi i dokumentacionit ........................................................................ 14

Diskutimet me fokusgrupe ........................................................................ 14

Studim rasti ........................................................................ 15

QASJET GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VLERËSIMIN DHE STRATEGJITË E PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL ........................................................................ 16

VLERËSIMI I JASHTËM I SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL ........................................................................ 22

Qëllimi dhe objektivat e vlerësimit ........................................................................ 22

Etapat e procesit të vlerësimit të jashtëm ........................................................................ 24

Paravlerësimi ........................................................................ 24

Vlerësimi i orientuar ........................................................................ 24

Vlerësimi i plotë ........................................................................ 25

Njoftimi i shkollës për procesin e vlerësimit të shërbimit psiko-social ........................................................................ 27

Dokumentacioni që i kërkohet shkollës ........................................................................ 27

Platforma e vlerësimit ........................................................................ 28

Ekipi i vlerësimit dhe kohëzgjatja e vlerësimit ........................................................................ 29

Planifikimi i procesit të vlerësimit ........................................................................ 29

Takimi informues ........................................................................ 32

Takimi përmbyllës ........................................................................ 33

Të drejtat dhe detyrat e aktorëve të përfshirë në procesin e vlerësimit ........................................................................ 33

Të drejtat dhe detyrat e drejtorit të shkollës dhe të punonjësve të shërbimit psiko-social ........................................................................ 33

Drejtori i shkollës ka për detyrë që gjatë procesit të vlerësimit: ........................... 34
Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë për detyrë, që gjatë procesit të vlerësimit: ........................................................................................................ 34
Detyrat e drejtuesit dhe të anëtarëve të ekipit të vlerësimit ................................ 34
Anëtarët e ekipit të vlerësimit: ........................................................................ 35
RAPORTI I VLERËSIMIT ........................................................................................ 36
Struktura dhe përmbajtja e raportit ..................................................................... 36
Procedura e dorëzimit të raportit të vlerësimit ..................................................... 37
SHKALLËT E VLERËSIMIT ....................................................................................... 39
VETËVLERËSIMI I PUNONJËSVE PSIKO-SOCIALË DHE LIDHJA ME VLERËSIMIN E BRENDSHËM ................................................................................................. 42
Ndërlidhja me fushat dhe treguesit e cilësisë ....................................................... 44
Fusha 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve ........................................... 44
Fusha 2: Procesi i të nxënit ................................................................................ 44
Fusha 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale ............................................. 45
Fusha 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin ....................................... 45
MONITORIMI DHE MBËSHTETJA PAS VLERËSIMIT ................................................... 46
Plani i përmirësimit të punonjësve të shërbimit psiko-social ................................. 47
ANEKS ................................................................................................................ 52
Konteksti i shërbimit psiko-social në shkollë ........................................................ 52
Formati i vetëvlerësimit të punonjësve të shërbimit psiko-social ............................. 55
Formati i platformës së vlerësimit ...................................................................... 109
Formati i raportit të vlerësimit ........................................................................... 143
Formati i planit të përmirësimit për punonjësit e shërbimit psiko-social .................. 150
MODELE ANKETASH/PYETËSORËSH PËR PRINDËRIT, NXËNËSIT DHE MËSUESIT ...... 156
Pyetësor për nxënësit, në lidhje me efikasitetin e shërbimit psiko-social në zhvillimin emocional dhe social të tyre ........................................................................... 159
Pyetësor për prindërit, për të vlerësuar cilësinë e shërbimit psiko-social, në lidhje me procesin e të nxënit të fëmijëve ...................................................................... 161
Pyetësor për nxënësit, në lidhje me shërbimin psiko-social dhe mbështetje për procesin e të nxënit, me pyetje specifike dhe shkallë të standardizuara për përgjigjet ............ 163

Pyetësor për prindërit, i cili vlerëson cilësinë e shërbimit psiko-social në lidhje me sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale në shkollë. .......... 165

Pyetësor për nxënësit, i cili vlerëson cilësinë e shërbimit psiko-social në lidhje me sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale. .......... 167

Pyetësor për prindërit në lidhje me komunikimin, mbështetjen dhe përfshirjen e prindërve në aktivitete të ndryshme që lidhen me zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. .......... 169

Pyetësor për mësuesit në lidhje me kënaqësinë e tyre ndaj shërbimit psiko-social.... 171

Pyetësor për drejtuesit e shkollës në lidhje me shërbimin psiko-social.......... 174

BAZA LIGJORE.......... 178

BIBLIOGRAFIA .......... 181

# HYRJE

Metodologjia e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë, përfaqëson një hap të rëndësishëm në drejtim të garantimit të cilësisë dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të këtij shërbimi për mirëqenien dhe zhvillimin e nxënësve. Kjo metodologji është zhvilluar në përgjigje të prioriteteve bashkëkohore të arsimit shqiptar dhe të standardeve ndërkombëtare, duke pasqyruar rëndësinë e shërbimeve psiko-sociale në mbështetjen emocionale, psikologjike dhe sociale të nxënësve, të mësuesve dhe të komunitetit të gjerë shkollor.

Përmes këtij dokumenti, synohet të ofrohet një kuadër i qartë dhe i standardizuar për proceset e planifikimit, të zbatimit, të vlerësimit dhe të raportimit të cilësisë së shërbimit psiko-social. Ky kuadër ndihmon jo vetëm punonjësit e shërbimit psiko-social dhe drejtuesit e shkollave, por edhe vlerësuesit e jashtëm që të kryejnë një analizë të thelluar mbi efektivitetin dhe ndikimin e këtyre shërbimeve, në përmirësimin e jetës shkollore dhe rezultatet e përgjithshme të nxënësve.

Historikisht, roli i shërbimit psiko-social në shkollë, ka evoluar nga një mbështetje themelore, drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse, ku përfshihen ndërhyrjet për të parandaluar sfidat psiko-sociale, promovimi i zhvillimit të shëndetshëm dhe menaxhimi i situatave të vështira, si ngacmimet, stresi akademik apo vështirësitë emocionale. Vitet e fundit, është rritur nevoja për të matur ndikimin dhe cilësinë e këtyre shërbimeve në mënyrë sistematike dhe profesionale, duke krijuar kështu, bazën për një vlerësim efektiv.

Metodologjia përfshin dy shtylla kryesore, përkatësisht:

1. ***Vlerësimin e brendshëm (vetëvlerësimi),*** i cili është një proces reflektimi i kryer nga vetë punonjësit e shërbimit psiko-social, për të identifikuar pikat e forta dhe fushat që kërkojnë përmirësim, bazuar në indikatorët e cilësisë dhe nevojat e komunitetit shkollor.

2. ***Vlerësimin e jashtëm,*** i cili është një analizë e thelluar nga institucionet vlerësuese, për të garantuar standarde të larta profesionalizmi, transparencë dhe përgjegjshmëri për cilësinë e shërbimit psiko-social.

Në këtë metodologji, përfshihen gjithashtu, qasjet për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, përdorimi i pyetësorëve për nxënësit, prindërit dhe mësuesit, si dhe teknika të tjera të matjes, për vlerësimin e cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë.

Ky dokument synon jo vetëm të sigurojë një proces të qartë dhe të strukturuar të vlerësimit, por edhe të kontribuojë në fuqizimin e rolit të shërbimit psiko-social në shkolla, si një faktor thelbësor për një mjedis të shëndetshëm dhe mbështetës, për të gjithë aktorët e përfshirë. Ai inkurajon bashkëpunimin e të gjithë palëve të interesuara, duke e kthyer vlerësimin në një mjet për zhvillim dhe rritje profesionale.

Standardizimi i përdorimit të një gjuhe të përbashkët vlerësimi, si nga aktorët e jashtëm, ashtu edhe ata të brendshëm, është një faktor kyç në garantimin e cilësisë dhe të efektivitetit të shërbimit psiko-social në shkollë. Ky harmonizim i qasjes vlerësuese, mundëson krijimin e një platforme të përbashkët ku palët e përfshira – stafi psiko-social, drejtuesit, mësuesit dhe aktorët e jashtëm – të ndërveprojnë në mënyrë të qartë dhe konstruktive.

Përdorimi i një gjuhe të unifikuar ndihmon në shmangien e keqkuptimeve dhe krijon një bazë të përbashkët për diskutim dhe reflektim mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara. Ky standardizim e shndërron procesin e vlerësimit nga një mekanizëm kontrolli në një dialog konstruktiv, duke ndihmuar në identifikimin e nevojave reale të nxënësve dhe forcimin e mbështetjes së tyre psiko-sociale.

Dialogu konstruktiv midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, siguron që shërbimi psiko-social të jetë gjithnjë në përputhje me interesat dhe me nevojat e nxënësve, duke u fokusuar në përmirësimin e mirëqenies së tyre emocionale dhe sociale. Në këtë mënyrë, procesi i vlerësimit kontribuon jo vetëm në përmirësimin e praktikave aktuale, por edhe në zhvillimin e kapaciteteve, për të krijuar një mjedis të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë komunitetin shkollor.

Në kapitujt që vijojnë, do të trajtohen qëllimet, parimet dhe veçoritë e procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të shërbimit psiko-social në shkollë, teknikat e mbledhjes dhe të analizës së të dhënave, si dhe rekomandimet për zbatimin praktik të metodologjisë.

# SISTEMI I VLERËSIMIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

Vlerësimi i cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë është një komponent i rëndësishëm në procesin e përmirësimit të mjedisit arsimor, i cili ka për qëllim mbështetje të plotë për zhvillimin emocional dhe social të nxënësve. Ky vlerësim shërben si një mekanizëm i rëndësishëm, për të përcaktuar ndikimin e shërbimit psiko-social në mirëqenien e nxënësve, për të siguruar që ky shërbim të jetë i integruar dhe efektiv, në mbështetje të nevojave të ndryshme të tyre. Sistemi i vlerësimit siguron një metodë të qartë dhe transparente për të vlerësuar performancën dhe rezultatet e këtij shërbimi, duke krijuar mundësi për përmirësimin e tij të vazhdueshëm dhe përshtatjen e tij me nevojat dhe kërkesat që shfaqen në një mjedis shkollor.

Një nga elementet kryesore të vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social, është vlerësimi i ndikimit të këtij shërbimi në suksesin dhe zhvillimin individual të çdo nxënësi. Ky lloj vlerësimi fokusohet në aftësinë e shërbimit, për të mbështetur nxënësit në menaxhimin e emocioneve, krijimin e aftësive për të trajtuar stresin dhe zhvillimin e aftësive sociale të nevojshme, për të funksionuar në mënyrë të shëndetshme në shoqëri. Pjesë e këtij procesi është edhe ndihma për nxënësit që përballen me vështirësi të natyrave të ndryshme, si dhe mbështetje për ata që kalojnë nëpër periudha të vështira emocionale dhe sociale, duke iu ofruar mundësi për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre shkollore dhe personale.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i vlerësimit të shërbimit psiko-social, është vlerësimi i ndikimit të këtij shërbimi në nivelin e përgjithshëm të shkollës. Ky vlerësim shqyrton se si shërbimi psiko-social kontribuon në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe gjithëpërfshirës, ku nxënësit mund të zhvillohen dhe të bëhen pjesë aktive e procesit arsimor. Ai analizon se sa i aftë është shërbimi për të ndihmuar në menaxhimin e konflikteve, për promovimin e respektit dhe të tolerancës, si dhe rritjen e vetëvlerësimit të nxënësve. Ky proces gjithashtu, përfshin vlerësimin e mënyrës se si shërbimi psiko-social mund të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë për nxënësit me nevoja të veçanta, si

dhe për ata që mund të jenë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme, siç janë ngacmimet ose problematikat e shëndetit mendor.

Përveç vlerësimit të shërbimit psiko-social në nivel individual dhe shkollor, është gjithashtu e rëndësishme, të shqyrtohet se sa i përshtatshëm është shërbimi psiko-social në përputhje me kërkesat dhe trendet globale. Ky vlerësim analizon se sa mirë shërbimi psiko-social është i përditësuar dhe i aftë, të adresojë nevojat e nxënësve për t'u përballur me sfidat moderne, siç janë ndikimet e shoqërisë digjitale, ngacmimet online dhe kërkesat për diversitet dhe gjithëpërfshirje. Nëpërmjet këtij vlerësimi, i përgjigjemi pyetjes: "A është ky shërbim në gjendje të mbështesë nxënësit, që janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të shëndetit mendor, siç është depresioni, ankthi dhe stresi, duke ofruar strategji efektive dhe mbështetje të vazhdueshme?".

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i vlerësimit të shërbimit psiko-social është krahasimi i këtij shërbimi me atë që ofrohet në shkolla të tjera, si në nivel lokal, ashtu edhe kombëtar. Ky vlerësim mund të shqyrtojë performancën e shërbimit psiko-social, duke krahasuar përmbushjen e objektivave të tij dhe ndikimin e tij në nxënësit me rezultatet në shkolla të tjera. Pjesë e këtij procesi është vlerësimi i përmirësimit të nivelit të mirëqenies dhe të zhvillimit emocional të nxënësve ndër vite, duke krahasuar rezultatet e këtij viti me ato të vitit të kaluar.

Një nga qëllimet kryesore të sistemit të vlerësimit të shërbimit psiko-social, është të sigurojë transparencë në lidhje me përgjegjësitë dhe rezultatet e këtij shërbimi. Ky vlerësim siguron që të gjitha palët e përfshira, punonjësit e shërbimit psiko-social, stafi i shkollës dhe prindërit, të kuptojnë se çfarë pritet nga shërbimi psiko-social dhe si mund të kontribuojnë për të përmirësuar cilësinë e mbështetjes, që ofrohet për nxënësit. Ky proces, gjithashtu, synon të krijojë mundësi, për të marrë vendime të bazuara në të dhëna, të shpërndajë burimet dhe të sigurojë mbështetje të vazhdueshme për nxënësit, për të garantuar që ata të marrin mbështetjen e duhur, për zhvillimin e tyre akademik, emocional dhe social.

# Procesi i vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm

Sigurimi i cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë, është një proces kompleks, i cili ka për qëllim të garantojë mirëqenien emocionale dhe sociale të nxënësve dhe të mbështesë zhvillimin e tyre të plotë. Ky proces përfshin përdorimin e një sistemi të integruar të vlerësimit, i cili përbëhet nga vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm.

Përmes këtij sistemi, sigurohet një bashkëveprim i pandërprerë mes institucioneve dhe profesionistëve që ofrojnë shërbime psiko-sociale. Vlerësimi i cilësisë synon të analizojë performancën e punonjësve, efektivitetin e ndërhyrjeve dhe përmbushjen e standardeve të vendosura. Ky proces është instrument vendimtar për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe përmbushjen e nevojave dhe të interesave të nxënësve.

# Metodat dhe teknikat e vlerësimit

Grupi i vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë së shërbimit psiko-social të shkollës, për të siguruar një analizë gjithëpërfshirëse dhe të saktë të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë, përdor kombinimin e metodave cilësore dhe sasiore. Këto metoda dhe teknika janë përshtatur, për të mbledhur informacion të detajuar, për të garantuar objektivitet dhe për të identifikuar aspektet që kanë nevojë për përmirësim.

Në vijim, paraqiten metodat dhe teknikat që do të përdoren, shoqëruar me një përshkrim narrativ, për të pasqyruar efektivitetin e tyre në praktikë.

## Vëzhgimi i drejtpërdrejtë

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve psiko-sociale, i ndërveprimeve me nxënësit dhe i sesioneve të këshillimit, është një metodë që përdoret për identifikimin dhe analizimin e sjelljeve, të qëndrimeve dhe të marrëdhënieve në situata të kontrolluara dhe të pakontrolluara, të shërbimit psiko-social brenda dhe jashtë shkollës. Ai ndihmon në matjen e ndryshimeve dhe në mbledhjen e informacionit mbi sjelljen e nxënësve, të

mësuesve dhe të drejtuesve, duke krijuar një kuptim të thellë të dinamikave të mjedisit shkollor. Për një vëzhgim efektiv, është thelbësore planifikimi i kujdesshëm dhe raportimi i besueshëm i të dhënave, duke përfshirë të gjitha faktet dhe dukuritë e rëndësishme për qëllimin e vlerësimit.

Grupi i vlerësimit merr pjesë në situata konkrete, siç janë seancat individuale të këshillimit apo aktivitetet grupore të drejtuara nga psikologu ose punonjësi social.

Në këtë proces, vëmendja fokusohet te:

- Ndërveprimi midis punonjësit të shërbimit psiko-social dhe nxënësve;
- Reagimet e nxënësve gjatë aktiviteteve;
- Metodat dhe teknikat që përdoren për të adresuar nevojat specifike të nxënësve;
- Procesi që do të ndihmojë për të identifikuar praktikat pozitive, që të mund të përforcohen dhe dobësitë që kërkojnë përmirësim;
- Vëzhgimi i seancave individuale ose në grupe të këshillimit, të drejtuara nga psikologu ose punonjësi social.
- Përcaktimi i nivelit të përfshirjes së nxënësve dhe të efektivitetit të metodave të përdorura.

## Intervista

Intervista është një mjet kërkimor, që synon mbledhjen e të dhënave të dobishme, që nuk mund të merren nëpërmjet dokumenteve të ndryshme dhe as të identifikohen nëpërmjet vëzhgimeve. Intervista karakterizohet nga një fleksibilitet i madh, si në renditjen e pyetjeve, ashtu edhe në formën e tyre. Intervistat zhvillohen për të mbledhur perceptime dhe opinione nga të gjitha palët që përfshihen apo përfitojnë nga shërbimin psiko-social. Përmes një qasjeje të personalizuar dhe empatike, grupi i vlerësimit do të krijojë një atmosferë të hapur për bashkëbisedim.

Intervista mund të jetë e strukturuar paraprakisht ose mund të jetë plotësisht e pastrukturuar, domethënë, pa pyetje të përgatitura, por organizohet si bisedë e lirë mbi një temë të caktuar. Kur është e nevojshme, mund të bëhet edhe kombinimi i dy llojeve të intervistave, të strukturuara dhe të pastrukturuara.

Intervistat kryhen me:

- Punonjësit e shërbimit psiko-social, për të kuptuar sfidat e tyre profesionale dhe burimet që përdorin;
- Drejtuesit e shkollës, për të marrë një vlerësim mbi integrimin e shërbimit psiko-social në prioritetet e shkollës;
- Nxënësit, për të dëgjuar përvojat e tyre personale dhe ndjeshmërinë e shërbimit ndaj nevojave të tyre;
- Prindërit dhe mësuesit, për të marrë perceptime të jashtme mbi efektivitetin dhe impaktin e shërbimit.

Pyetjet ndërtohen në mënyrë që të nxisin përgjigje të hapura dhe të detajuara, duke përfshirë aspekte si besimi, qasja e personalizuar dhe ndikimi afatgjatë i shërbimit.

## Anketat dhe pyetësorët

Anketat dhe pyetësorët përdoren për mbledhjen dhe analizimin e informacionit, për të vlerësuar opinionet, mendimet, eksperiencat etj., në procesin e vlerësimit. Ato nuk limitohen në mbledhjen e informacionit, duke përdorur pyetje/pohime me shkrim, të hapura dhe të mbyllura, por kanë një larmi qëllimesh dhe mund të realizohen në shumë mënyra, në varësi të metodologjisë së zgjedhur dhe të qëllimeve që duhet të arrihen në vlerësim.

Për të pasur një panoramë më të gjerë dhe për të përfshirë sa më shumë pjesëmarrës, përdoren anketa dhe pyetësorë të strukturuar. Ato kanë për qëllim që të mbledhin të dhëna mbi cilësinë e shërbimit, nga një grup i madh individësh, në mënyrë të shpejtë dhe të efektshme. Si rregull, përpara zhvillimit të anketës/pyetësorit, vlerësuesi bën një hyrje për njohjen e të intervistuarve me natyrën dhe qëllimin e tyre. Gjithashtu, ai i njeh ata me mënyrën e përpunimit të tyre dhe i siguron për ruajtjen e privatësisë.

Pyetësorët përfshijnë:

- Pyetje që vlerësojnë nivelin e kënaqësisë së nxënësve, të mësuesve dhe të prindërve për cilësinë e shërbimit psiko-social;

- Matjen e perceptimeve mbi qasjen profesionale të punonjësve të shërbimit psiko-social;
- Sugjerime për përmirësime të mundshme.

Rezultatet e mbledhura analizohen në mënyrë statistikore, për të identifikuar ndërlidhjet kryesore midis aspekteve të ndryshme të shërbimit.

## Shqyrtimi i dokumentacionit

Dokumentet që mbajnë evidencë të shërbimit psiko-social, janë burime të rëndësishme, për të kuptuar mënyrën se si funksionon ky shërbim në praktikë. Grupit të vlerësimit i vihen në dispozicion dokumente, si:

- Planifikimi vjetor dhe mujor i shërbimit psiko-social;
- Raportet e progresit të nxënësve;
- Analizat periodike dhe raportet vjetore;
- Dosjet e rasteve të trajtuara.

Duke shqyrtuar këto dokumente, vlerësohet përputhshmëria e shërbimit psiko-social, me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

## Diskutimet me fokusgrupe

Diskutimet në fokusgrupe organizohen për të inkurajuar shkëmbimin e mendimeve dhe për të identifikuar perceptimet kolektive mbi shërbimin psiko-social.

Këto sesione zhvillohen me:

- Nxënës të përzgjedhur nga grupe të ndryshme të shkollës;
- Prindër që janë përfshirë në mënyrë aktive në aktivitetet e shkollës;
- Stafin e shkollës, për të dëgjuar përvojat e tyre me ekipin psiko-social.

Diskutimet fokusohen në aspekte, si ndikimi i shërbimit në mirëqenien emocionale dhe sociale të nxënësve, si dhe ndihmesa që ai ofron në përballimin e sfidave personale dhe akademike.

## Studim rasti

Studimi i rasteve është një metodë efektive për vlerësimin e ndikimit të ndërhyrjeve psiko-sociale në shkolla, pasi ofron mundësinë të kuptohet më thellë si funksionojnë këto ndërhyrje në kushte të ndryshme. Duke shqyrtuar raste konkrete, si ato të suksesshme dhe sfiduese, mund të identifikohen faktorët që ndikojnë në rezultate, duke ndihmuar në përshtatjen e strategjive të përdorura. Ky proces lejon mësuesit dhe profesionistët e tjerë të analizojnë se si mbështetje të ndryshme, si ajo e familjes dhe e bashkëmoshatarëve, mund të ndikojnë në procesin e ndryshimit dhe të përmirësimit të nxënësve.

Një rasti i suksesshëm, për shembull, mund të tregojë se, kur nxënësit ndihen të mbështetur dhe të sigurt në mjedisin shkollor, ata janë më të gatshëm të përballen me sfidat personale dhe akademike. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e vetëvlerësimit dhe përmirësimin e performancës.

Nga ana tjetër, një rast sfidues mund të zbulojë pengesat që shfaqen, si mungesa e mbështetjes nga familja ose mosgatishmëria e nxënësve për të angazhuar veten. Këto raste ofrojnë mundësinë për të mësuar dhe për të zbuluar, se si të përmirësohen qasjet dhe të krijohen strategji më të personalizuara dhe më të përshtatshme për nevojat e çdo nxënësi.

Në fund, analiza e rasteve të ndryshme është thelbësore, për të krijuar ndërhyrje më efektive dhe për të rritur mundësinë që këto ndërhyrje, të kenë një ndikim të qëndrueshëm dhe pozitiv në jetën e nxënësve. Ajo ofron mësime të vlefshme, që mund të përdoren për të përshtatur metodat e punës dhe për të adresuar nevojat e ndryshme emocionale dhe sociale të individëve.

# QASJET GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VLERËSIMIN DHE STRATEGJITË E PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

Për të siguruar një vlerësim të plotë dhe efektiv të shërbimit psiko-social në shkollë, është thelbësore të përdoren qasje që kombinojnë të dhëna të ndryshme dhe analiza strategjike.

Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë dhe analiza SWOT janë dy teknika kyçe, që punojnë së bashku, për të garantuar një proces të plotë dhe gjithëpërfshirës vlerësimi dhe përmirësimi të shërbimit psiko-social në shkollë. Secila prej tyre ka një rol të veçantë, por, kur përdoren bashkë, krijojnë një bazë të fortë, për të kuptuar performancën aktuale dhe për të zhvilluar strategji që adresojnë nevojat dhe sfidat.

Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë është i rëndësishëm, sepse mbështetet në tri dimensione të ndryshme të informacionit: të dhënat sasiore, perceptimet e aktorëve dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë. Përmes kësaj qasjeje, sigurohet një pasqyrë objektive dhe të ekuilibruar të situatës. Të dhënat sasiore ndihmojnë në matjen e performancës përmes statistikave dhe rezultateve konkrete, si numri i rasteve të trajtuara apo progresi i nxënësve. Nga ana tjetër, perceptimet e aktorëve (si nxënësit, prindërit dhe mësuesit) japin informacion cilësor, për mënyrën se si shërbimi perceptohet dhe përjetohet nga komuniteti shkollor. Së fundi, vëzhgimi i drejtpërdrejtë ofron një element realist dhe praktik, duke treguar se si zbatohen shërbimet në terren, duke nxjerrë në pah aspekte që mund të mos shfaqen në të dhëna apo raporte.

Nga ana tjetër, analiza SWOT luan rol kyç në strukturimin e këtyre të dhënave, për t'i kthyer ato në veprime konkrete. SWOT-i shikon brenda dhe jashtë organizatës, për të identifikuar pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që ndikojnë në shërbimin psiko-social. Pikat e forta dhe dobësitë përqendrohen në faktorët e brendshëm, duke ndihmuar në identifikimin e aspekteve që mund të mbështeten ose të përmirësohen. Ndërkohë, mundësitë dhe kërcënimet analizojnë faktorët e jashtëm, duke krijuar një kuptim të plotë të kontekstit ku operon shërbimi.

Këto dy teknika lidhen në mënyrë të natyrshme. Trekëndëshi siguron informacion të detajuar dhe të besueshëm, që shërben si bazë për analizën SWOT. Për shembull, të dhënat statistikore mund të ndihmojnë në identifikimin e sukseseve, ndërsa perceptimet e aktorëve mund të zbulojnë dobësi apo kërcënime që nuk janë lehtësisht të dukshme nga statistikat. Në të njëjtën kohë, SWOT-i strukturon të gjithë këtë informacion, duke ndihmuar në krijimin e strategjive, për të adresuar dobësitë dhe kërcënimet, duke shfrytëzuar mundësitë dhe duke ndërtuar mbi pikat e forta.

Në terma praktikë, këto dy qasje krijojnë një cikël të vazhdueshëm të vlerësimit dhe të përmirësimit. Trekëndëshi ndihmon në identifikimin e situatës aktuale dhe krijimin e një baze të dhënash, ndërsa SWOT-i ndihmon në përdorimin e kësaj baze, për të planifikuar dhe për të zbatuar përmirësime strategjike. Kombinimi i tyre siguron që vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës, realist dhe i orientuar drejt veprimit, duke siguruar një shërbim psiko-social që i përgjigjet nevojave të komunitetit të shkollës dhe ndihmon në mirëqenien e nxënësve.

## Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë

Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë, është një teknikë që përdoret për të krahasuar dhe për të sinkronizuar të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme. Në kontekstin e vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë, "Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë" shërben si qasje gjithëpërfshirëse, për të siguruar që vlerësimi është objektiv, i saktë dhe i bazuar në të dhëna. Përdorimi i këtyre të dhënave siguron objektivitet, transparencë dhe vë fokusin në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit psiko- social.




Ky model përfshin kombinimin e tri burimeve kryesore të informacionit, përkatësisht:

- Të dhënat sasiore;
- Këndvështrimet e aktorëve;
- Vëzhgimin e drejtpërdrejtë.

***Të dhënat sasiore*** përfshijnë statistika mbi rastet e adresuara nga shërbimi psiko-social, frekuencën e ndërhyrjeve dhe rezultatet e arritura, të tilla si:

- Numri i rasteve të trajtuara nga punonjësit e shërbimit psiko-social.
- Statistikat mbi natyrën e rasteve (probleme emocionale, sociale, familjare, bullizëm etj.).
- Numri i sesioneve këshillimore individuale dhe në grupe.
- Raporte mbi përparimin e nxënësve (p.sh., reduktimi i mungesave në shkollë, përmirësimi i rezultateve akademike etj.).
- Shkalla e përfshirjes së nxënësve në aktivitete psiko-sociale të organizuara.
- Shkalla e ndjekjes së rasteve (follow-up) pas ndërhyrjeve.
- Të dhëna mbi shpërndarjen gjinore dhe grupmoshat e përfituesve.
- Numri i rasteve të referuara te specialistë jashtë shkollës (psikologë, punonjës socialë, qendra etj.).

***Këndvështrimi i aktorëve*** përmbledh të dhënat cilësore nga intervistat, anketat dhe dëshmitë e ofruara nga nxënësit, prindërit, mësuesit dhe stafi psiko-social, të cilat kontribuojnë për të kuptuar perceptimet, përvojat dhe pritshmëritë e komunitetit të shkollës, në lidhje me shërbimin psiko-social. Të dhënat cilësore mblidhen nga:

- Perceptimet e nxënësve mbi efektivitetin e shërbimit psiko-social (anketa, intervista);
- Përvojat e prindërve në lidhje me mbështetjen e ofruar nga shërbimi psiko-social;
- Perceptimet e mësuesve për ndikimin e ndërhyrjeve psiko-sociale në sjelljen dhe përparimin e nxënësve;
- Komentet dhe sugjerimet e punonjësve të shërbimit psiko-social, mbi mjedisin, burimet dhe sfidat e shërbimit;
- Perceptimet e komunitetit shkollor, mbi rëndësinë dhe ndikimin e shërbimit psiko-social.

**Vëzhgimi i drejtpërdrejtë** përfshin monitorimin në terren të aktiviteteve dhe të ndërveprimeve të stafit psiko-social me nxënësit dhe komunitetin. Ky element kombinon të dhënat cilësore dhe sasiore, duke siguruar vlerësim realist të mënyrës si funksionon shërbimi psiko-social në praktikë. Nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë mblidhen të dhëna sasiore dhe cilësore, në lidhje me:

- Sjelljen e nxënësve (në klasë, pushim, aktivitete jashtëshkollore);
- Ndërveprimet midis punonjësve të shërbimit psiko-social me nxënësit, prindërit dhe mësuesit;
- Zbatimin e teknikave dhe të strategjive këshillimore nga punonjësit shërbimit psiko-social;
- Cilësinë e dokumentacionit të mbajtur nga punonjësit e shërbimit psiko-social (raporte, plane veprimi, dosje të rasteve);
- Monitorimin e zbatimit të aktiviteteve parandaluese (seminare, trajnime, seanca ndërgjegjësimi);
- Vlerësimin e mjedisit fizik të ofruar për shërbimin psiko-social (privatësia dhe aksesi për nxënësit);
- Etj.

Përmes kombinimit të këtyre tri dimensioneve, vlerësuesit mund të krijojnë një pasqyrë të balancuar dhe të saktë të cilësisë së shërbimit psiko-social. Ndonjëherë, fakti, edhe pse i dokumentuar, nuk është domosdoshmërisht i njëjtë me atë që ndodh në të vërtetë në shkollë. Në mënyrë të ngjashme, raportet e progresit të realizuara në planet e përmirësimit, mund të jenë të dobishme, por duhet të kontrollohen, çfarë është bërë në të vërtetë.

Shqyrtimi i të gjitha burimeve dhe dëshmive, duhet të seleksionohet me kujdes, që të jetë gjithmonë në funksion të qëllimit të vlerësimit, për identifikimin e pikave të forta, të sfidave dhe të mundësive për përmirësim, duke siguruar që procesi të jetë në funksion të mirëqenies dhe të zhvillimit të nxënësve.

## Analiza SWOT

Analiza SWOT (Sukseset, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet) është mjet i fuqishëm për vlerësimin dhe përmirësimin e shërbimeve psiko-sociale në shkollë. Ajo ofron një kornizë të strukturuar, që ndihmon në identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, që ndikojnë në ofrimin e shërbimit, dhe mundëson zhvillimin e strategjive për rritjen e efektivitetit.

Në fazën e analizës së "Sukseseve", fokusi është në identifikimin e forcave dhe të pikave të forta të shërbimit, si përvoja e punonjësve, mbështetja e drejtuesve të shkollës, bashkëpunimi i mirë me mësuesit dhe rezultatet pozitive të arritura deri tani. Kjo ndihmon që të konsolidohen praktikat e mira dhe të vazhdohet puna me to, për të forcuar kapacitetin e shërbimit psiko-social.

Nga ana tjetër, analiza e "Dobësive" ka për qëllim të identifikojë fushat ku shërbimi psiko-social mund të përmirësohet, si mungesa e burimeve të mjaftueshme, mbingarkesa e punonjësve ose sfidat që lidhen me mungesën e trajnimeve të përditësuara. Identifikimi i këtyre dobësive është i rëndësishëm, për të zhvilluar një plan veprimi që adreson këto probleme dhe e bën shërbimin më të qëndrueshëm dhe efektiv.

Analiza e "Mundësive" është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi, pasi ndihmon në identifikimin e mundësive të reja, për të përmirësuar shërbimin psiko-social, si mundësitë për të zhvilluar partneritete me organizata të jashtme, përdorimi i teknologjisë për të ofruar mbështetje ose mundësitë për të zhvilluar trajnime të reja për punonjësit. Përdorimi i mundësive që dalin nga ky analizim, mund të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe në ofrimin e mbështetjes më të mirë për nxënësit dhe komunitetin shkollor.

Në përfundim, analiza e "Kërcënimeve" është thelbësore, për të kuptuar faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që mund të dëmtojnë ose mund të pengojnë funksionimin efektiv të shërbimit psiko-social. Këtu mund të përfshihen ndryshimet në politikat e arsimit, mungesa e financimeve ose faktorë socialë dhe kulturore që ndikojnë në mirëqenien e nxënësve. Identifikimi i këtyre kërcënimeve mund të ndihmojë në

zhvillimin e strategjive, për të minimizuar rreziqet dhe për të siguruar që shërbimi të vazhdojë të ofrojë mbështetje të duhur, në kushtet më të mira të mundshme.

| Sukseset | Dobësitë |
|---|---|
| - Aftësitë profesionale të psikologëve dhe të punonjësve socialë.<br>- Angazhimi për të adresuar nevojat emocionale, sociale dhe akademike të nxënësve.<br>- Angazhimi i aktorëve të shkollës për të mbështetur shërbimin.<br>- Etj. | - Kufizimet financiare dhe mungesa e pajisjeve adekuate.<br>- Një raport i lartë psikolog/nxënës ose punonjës social/nxënës.<br>- Mungesa e koordinimit ndërmjet shërbimit psiko-social, nxënësve, mësuesve dhe familjeve.<br>- Etj. |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| - Mundësitë për trajnime të avancuara, përfshirë tema si trauma, shëndeti mendor dhe ndërhyrjet sistemike.<br>- Përdorimi i mjeteve digjitale për monitorimin, analizimin dhe mbështetjen e nxënësve.<br>- Forcimi i partneriteteve që mbështesin shëndetin mendor dhe zhvillimin akademik e social të nxënësve.<br>- Etj. | - Perceptimet negative të komunitetit për shëndetin mendor dhe ndërhyrjet psiko-sociale.<br>- Mungesa e qartësisë ligjore për rolin dhe funksionet e shërbimit psiko-scocial, mund të kufizojnë autonominë dhe efektivitetin.<br>- Vështirësitë ekonomike të disa familjeve.<br>- Etj. |

# VLERËSIMI I JASHTËM I SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

Vlerësimi i jashtëm i punonjësve të shërbimit psiko-social është proces i domosdoshëm, për të garantuar cilësinë e shërbimeve dhe për të përmirësuar vazhdimisht ndikimin e tyre. Ky proces jo vetëm që kontribuon në zhvillimin profesional të punonjësve, por gjithashtu, ndihmon në krijimin e një mjedisi shkollor të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës, për nxënësit, prindërit dhe komunitetin. Me një sistem vlerësimi të bazuar në kritere të qarta dhe strategji efektive, shkolla mund të forcojë rolin e saj, në mbështetjen e zhvillimit të nxënësve dhe në përmbushjen e qëllimeve të saj arsimore.

## Qëllimi dhe objektivat e vlerësimit

Vlerësimi i jashtëm i shërbimit psiko-social shkollor synon të analizojë në mënyrë të hollësishme, efektivitetin, efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara në shkollë. Qëllimi përfundimtar është të identifikohen pikat e forta dhe sfidat, duke sugjeruar masa për përmirësimin e standardeve të kujdesit dhe të mbështetjes psiko-sociale për nxënësit.

Vlerësimi i jashtëm i punonjësve të shërbimit psiko-social shkollor është proces i planifikuar dhe i standardizuar, që kryhet nga institucionet arsimore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin ose nga ekipe profesionale të ngritura posaçërisht për këtë qëllim. Ai siguron një analizë të paanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u mbështetur në kritere të matshme dhe të qarta.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të sigurojë që shërbimet psiko-sociale në shkolla janë efektive, gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt nxënësve. Përmes këtij procesi, synohet:

1. Zhvillimi profesional i punonjësve të shërbimit psiko-social, nëpërmjet identifikimit të nevojave për trajnime dhe përmirësim të vazhdueshëm të kompetencave profesionale.

2. Përmirësimi i praktikave të punës, nëpërmjet përshtatjes së metodave më të mira bashkëkohore, për të adresuar sfidat dhe nevojat e ndryshme.
3. Përmbushja e nevojave të nxënësve, duke garantuar që çdo nxënës përfiton shërbime të personalizuara dhe të përshtatshme për situatën e tij.
4. Ndërtimi i besimit, duke siguruar që familjet dhe komuniteti shkollor të kenë besim në shërbimin psiko-social dhe rol në mjedisin arsimor.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë është vendimmarrje e vlerësuesve, bazuar në gjetjet e grumbulluara, që realizohet në tri etapa, përkatësisht:




Vlerësimi i jashtëm është proces i vazhdueshëm, që mund të arrihet vetëm në bazë të sigurimit të të dhënave të mjaftueshme dhe reale, të cilat gjatë shqyrtimit nga vlerësuesit, sigurojnë identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të veprimtarisë mësimore-edukative të shkollës.

Të dhënat e grumbulluara analizohen në përputhje me qëllimin e vlerësimit. Duhet theksuar, se nuk mund të mjaftojë vetëm kujdesi për planifikimin e veprimtarive vlerësuese, por, nëse përdoren strategji dhe teknika të papërshtatshme, mund të merren vendime "joefektive" për vlerësimin e cilësisë së shkollës, si rrjedhojë rekomandimet e dhëna nuk sigurojnë përmirësimin e cilësisë së shkollës.

# Etapat e procesit të vlerësimit të jashtëm

## Paravlerësimi

Paravlerësimi siguron që procesi i vlerësimit të jetë i orientuar dhe i mbështetur në të dhëna reale, duke lehtësuar analizën e mëtejshme dhe përgatitjen e rekomandimeve për përmirësimin e shërbimit psiko-social.

Ky proces synon hartimin e një platforme vlerësimi që reflekton realitetin e shërbimit dhe përgatitjen për një vlerësim të jashtëm të mirëstrukturuar. Në këtë fazë, vlerësuesi shfrytëzon informacionin mbi kontekstin e institucionit dhe karakteristikat specifike të shërbimit psiko-social që do të vlerësohet.

## Vlerësimi i orientuar

Në rastet kur vlerësimi fokusohet vetëm në disa aspekte të caktuara të shërbimit psiko-social dhe nuk kërkon një analizë të thelluar të situatës, procesi paraprak i përgatitjes është më i thjeshtë. Ai realizohet përmes disa hapave të thjeshtë, që sigurojnë mbledhjen e informacionit të nevojshëm, për të vlerësuar aspekte të caktuara, përkatësisht:

- *Komunikimi telefonik ose online,* i cili shërben për t'u njohur paraprakisht me informacionin bazë mbi shërbimin, mund të realizohet një komunikim i shpejtë dhe i drejtpërdrejtë me drejtuesin e shërbimit psiko-social, psikologët ose specialistët e përfshirë. Ky komunikim mund të ndihmojë në marrjen e informacionit të përgjithshëm mbi funksionimin e shërbimit.
- *Identifikimi i informacionit të përgjithshëm,* i cili përfshin detaje të thjeshta, si numri i rasteve të trajtuara gjatë një periudhe të caktuar, përqindja e nxënësve që kanë marrë mbështetje psiko-sociale, profilin e nxënësve që janë në ndihmë etj. Ky informacion ofron një pamje të përgjithshme mbi shërbimin dhe ndihmon për të kuptuar se cilat janë aspektet që kërkojnë vëmendje.

## Vlerësimi i plotë

Për vlerësime gjithëpërfshirëse që synojnë analizimin e të gjitha aspekteve të shërbimit psiko-social, procesi paraprak është më i thelluar dhe kërkon mbledhje të të dhënave më të detajuara. Këtu, vlerësuesi duhet të ndjekë një qasje më të plotë dhe më holistike, për të kuptuar mirë situatën dhe për të vlerësuar çdo komponent të shërbimit psiko-social:

- *Shkëmbimi i të dhënave përmes komunikimeve elektronike:* Vlerësuesi mund të përdorë mjetet elektronike (e-mail, platforma online etj.), për të marrë informacion të detajuar mbi funksionimin e shërbimit psiko-social. Kjo mund të përfshijë dokumente që tregojnë statistika mbi përdorimin e shërbimeve, raporte të aktiviteteve dhe detaje mbi ndërhyrjet dhe mbështetjen që është ofruar për nxënësit. Këto të dhëna mund të ndihmojnë për të kuptuar përfitimet dhe sfidat që ka shërbimi.
- *Analizë paraprake e të dhënave:* Para se të fillojë vlerësimi i plotë, vlerësuesi do të analizojë të dhënat që janë mbledhur, për të identifikuar problematikat kryesore dhe nevojat për përmirësim. Ky hap mund të përfshijë identifikimin e fushave të dobëta, si mungesa e burimeve, vështirësitë në qasjen ndaj nxënësve ose mosfunksionimi i disa aktiviteteve të shërbimit. Kjo analizë ndihmon në përgatitjen e një platforme vlerësimi të fokusuar dhe të detajuar, që merr parasysh çdo aspekt të nevojshëm për vlerësimin e shërbimit.

Përcaktimet gjatë fazës së paravlerësimit

### 1. *Përzgjedhja e fushave dhe të treguesve të cilësisë*

- Fushat të cilat nga analiza paraprake (vlerësimi i riskut, të dhënat e dërguara nga shkolla, pyetësorët e KPSh-së etj.) rezultojnë më problematike.
- Identifikimi i treguesve kryesorë ku do të fokusohet vlerësimi, si cilësia e këshillimit psiko-social, qasja ndaj nxënësve me nevoja të veçanta, efektiviteti i ndërhyrjeve parandaluese etj.

### *2. Burimet njerëzore*

- Përcaktimi i specialistëve që do të përfshihen në vlerësim.
- Në varësi të fokusit, mund të kërkohen burime mbështetëse, si vlerësues të certifikuar apo ekspertë të jashtëm.

### *3. Koha e nevojshme*

- Hartimi i një plani kohor për realizimin e vlerësimit në përputhje me kompleksitetin e shërbimit dhe me kontekstin e shkollës.

### *4. Metodologjia*

- Zgjedhja e metodologjisë së përshtatshme, në varësi të tipit të shkollës, numrit të nxënësve, të stafit dhe të kontekstit specifik.
- Përdorimi i metodave sasiore dhe cilësore.

### *5. Mjetet ekonomiko-financiare*

- Planifikimi i burimeve ekonomike për realizimin e vlerësimit, duke përfshirë kostot për shumëfishimin e pyetësorëve, zhvillimin e trajnimeve të stafit dhe mbledhjen e të dhënave.

## Përzgjedhja e shkollës

Institucionet vlerësuese i referohen manualit të riskut, për përcaktimin e shkollave në të cilat do të vlerësohet cilësia e shërbimit psiko-social, si dhe treguesve specifikë në nivel lokal/rajonal dhe kombëtar. Në shumë raste, për vlerësime të karakterit kombëtar ose rajonal, përzgjedhja e shkollave dhe të treguesve që do të vlerësohen, orientohet nga ministria përgjegjëse e arsimit. Në këtë rast, numri i shkollave të planifikuara duhet të jetë i mjaftueshëm, që përfundimet të kenë shkallë të lartë besueshmërie. Parimet bazë të statistikës, për të arritur në përfundime që mund të kenë një shmangie te lejuar nga e vërteta, janë mbështetje e domosdoshme për zgjedhjen e kampionit të duhur.

## Njoftimi i shkollës për procesin e vlerësimit të shërbimit psiko-social

Njoftimi i shkollës bëhet nga titullari i institucionit vlerësues, 10-15 ditë para vlerësimit, në rastin e vlerësimeve të plota, dhe 2-3 ditë para vlerësimit, në rastin e vlerësimeve të tematike/të orientuara. Drejtori i shkollës menjëherë me të marrë njoftimin e vlerësimit, njofton punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe stafin e shkollës.

Në të njëjtën kohë, njoftohet edhe titullari i zyrës vendore arsimore, për vlerësimin që do të bëhet në shkollën nën juridiksionin e njësisë që ai drejton. Shkolla konfirmon zyrtarisht, pranimin e njoftimit dhe gatishmërinë për bashkëpunim në realizimin e vlerësimit të jashtëm. Bëjnë përjashtim rastet, kur:

- njoftimi paraprak i shkollës mund të cenojë efektivitetin e vlerësimit të saj;
- cenohet mirëqenia dhe siguria e nxënësve;
- vlerësimi kryhet me urdhër të ministrisë përgjegjëse të arsimit;
- shqyrtohen ankesa të bëra nga mësues, nxënës, prindër apo komuniteti etj.

## Dokumentacioni që i kërkohet shkollës

Institucioni vlerësues i kërkon drejtorit të shkollës të dhëna të përgjithshme, në lidhje me veprimtarinë mësimore-edukative të shkollës, si dhe dokumentacionin e punonjësve të shërbimit psiko-social. Punonjësit e shërbimit psiko-social në shkollë, duhet të mbajnë dokumente të ndryshme, për të siguruar që puna e tyre të jetë e organizuar, e dokumentuar dhe në përputhje me standardet profesionale.

Në dokumentacionin që i kërkohet shkollës, përfshihen:

- Konteksti[1] i shkollës;
- Analiza vjetore;
- Plani afatmesëm dhe plani vjetor i shkollës;
- Raporti vjetor i shkollës;
- Raporti i vlerësimit të brendshëm të shkollës;
- Regjistri i riskut;
- Planet e trajtimit të faktorëve të riskut;

[1] Në shtojcën 1 jepet konteksti i shkollës.

- Planifikimet vjetor dhe mujore të punonjësve të shërbimit psiko-social;
- Të dhënat e aktiviteteve të realizuara;
- Dokumentacioni i referimeve dhe të ndjekjeve të rasteve;
- Dosja individuale e nxënësit;
- Plane individuale të ndërhyrjeve të nxënësve me nevoja të veçanta;
- Raportet e progresit të nxënësve;
- Formularët për vlerësimin psiko-social;
- Dokumente për punën me prindërit dhe komunitetin shkollor;
- Regjistri i takimeve me nxënës, mësues, prindër;
- Raporte/informacione të bashkëpunimit me komunitetin shkollor;
- Formularët e miratimit nga prindërit për ndërhyrje specifike ose pjesëmarrje në aktivitete;
- Listat e pjesëmarrësve në seancat e zhvilluara në grup;
- Plani dhe raportet/informacionet e aktiviteteve në grup;
- Raporti për analizën vjetore të punës të ShPS-ës;
- Fletë vlerësimi dhe reagime nga nxënësit dhe prindërit;
- Dokumente që dëshmojnë bashkëpunimin ndërinstitucional;
- Raporte të referimit të rasteve për institucione të jashtme;
- Lista e trajnimeve të ndjekura;

Etj.

## Platforma e vlerësimit[2]

Dokumentacioni i sjellë nga shkolla, shërben për të krijuar një tablo të qartë të cilësisë së shërbimit psiko-social të shkollës, si dhe për t'u njohur me anët e forta dhe të dobëta. Institucioni vlerësues, pasi ka shqyrtuar dhe ka analizuar të dhënat paraprake të kontekstit të shkollës, brenda 2-3 ditëve, harton platformën e vlerësimit, ku përcakton:

- llojin e vlerësimit;
- qëllimin e vlerësimit;

[2] Formati i platformës së vlerësimit (shembull) jepet ne aneks.

- fushat e cilësisë;
- treguesit e cilësisë;
- bazën ligjore ku do të mbështet vlerësimi;
- metodologjinë e vlerësimit;
- kohëzgjatjen e vlerësimit;
- anëtarët e ekipit të vlerësimit;
- institucionet arsimore që do të vihen në dijeni me raportin e vlerësimit.

### Ekipi i vlerësimit dhe  kohëzgjatja e vlerësimit

Titullari i institucionit vlerësues përcakton numrin e anëtarëve të ekipit të vlerësimit, në varësi të qëllimit të vlerësimit, të fushave dhe të treguesve që do të vlerësohen, duke marrë parasysh edhe numrin e nxënësve, numrin e mësuesve, specifikat që lidhen me kontekstin e shkollës etj. Ai përcakton edhe drejtuesin e ekipit të vlerësimit, i cili, në përgjithësi, është një specialist që zotëron shkathtësi analitike dhe organizative. Në rastet kur numri i vlerësuesve është i pamjaftueshëm, mund të kërkohen specialistë edhe nga institucione të tjera arsimore.

Titullari i institucionit vlerësues përcakton kohëzgjatjen e vlerësimit të jashtëm, e cila varion 1-3 ditë, bazuar në kompleksitetin e çështjeve që do të vlerësohen dhe kontekstin e shkollës.

Drejtuesi i ekipit të vlerësimit mund të kërkojë shtyrjen e kohëzgjatjes së vlerësimit për arsye objektive. Shtyrjen e kohëzgjatjes së vlerësimit e vendos dhe e miraton titullari i institucionit vlerësues, sipas procedurave përkatëse.

## Planifikimi i procesit të vlerësimit

Drejtuesi i ekipit të vlerësimit, në bashkëpunim me anëtarët, harton një plan pune që zhvillohet gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë. Ky plan siguron një proces të detajuar dhe gjithëpërfshirës, për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë, duke përfshirë të gjitha grupet e interesit dhe duke vlerësuar të gjitha aspektet e funksionimit të këtij shërbimi.

Vlerësuesit, në mirëkuptim me stafin drejtues të shkollës dhe punonjësit e shërbimit psiko-social, mund të përfshijnë edhe veprimtari të tjera, por pa devijuar nga fokusi i qëllimit të vlerësimit.

*Më poshtë, është dhënë grafiku sugjerues i veprimtarive të ekipit të vlerësimit dhe detyrimet e shkollës gjatë vlerësimit.*

| **DITA 1** | | |
|---|---|---|
| **Koha** | **Veprimtaria** | **Detyrimet e shkollës** |
| 07:40-08:00 | Takim hyrës me drejtorinë dhe ekipin psiko-social të shkollës. | Paraqitja e qëllimit të vlerësimit dhe prezantimi i stafit vlerësues.<br><br>Dokumentacioni bazë për shërbimin psiko-social dhe statistikat e përgjithshme. |
| 08:00-11:00 | Analizë e dokumentacionit të shërbimit psiko-social. | Dokumentet kryesore: planet vjetore dhe mujore, raportet e përparimit, dosjet e nxënësve, planet e ndërhyrjes individuale, statistikat për rastet dhe ndërhyrjet. |
| 11:00-12:30 | Takime me punonjësit e shërbimit psiko-social. | Diskutime për praktikat, sfidat, përvojat dhe rezultatet. Shembuj të rasteve për diskutim. |
| 12:30-14:00 | Intervista dhe anketime me prindër. | Organizimi i prindërve për të siguruar përfaqësim të përshtatshëm (prindër të nxënësve me ndërhyrje psiko-sociale dhe pa të tilla). |
| 14:00-16:00 | Vëzhgim i ambientit dhe i infrastrukturës që mbështet shërbimin psiko-social. | Vizitë në hapësirat e ofruara për punën e punonjësve psiko-socialë: zyrat, bibliotekën, laboratorët dhe mjediset për aktivitete jashtëshkollore. |
| **Dita 2** | | |
| 08:00-10:00 | Vëzhgim i veprimtarive | Ofrimi i aksesit për të vëzhguar veprimtari ndërgjegjësuese dhe në grup. |

| | | |
|---|---|---|
| | ndërgjegjësuese dhe aktiviteteve në grup sipas planifikimin të punës të ShPS-ës. | |
| 10:00-12:00 | Takime dhe anketime me nxënës. | Organizimi i takimeve me përfaqësues të nxënësve, përfshirë ata me vështirësi në të nxënë dhe me nevoja të veçanta. |
| 12:00-13:00 | Intervista me mësues për bashkëpunimin me shërbimin psiko-social. | Organizimi i takimeve me mësues të lëndëve dhe kujdestarët e klasave. |
| 13:00-14:00 | Analizë e materialeve të trajnimeve dhe të zhvillimit profesional të punonjësve psiko-socialë. | Ofrimi i dokumentacionit për pjesëmarrjen e punonjësve në trajnime, certifikatat dhe temat e trajtuara. |
| 14:00-16:00 | Përmbledhje e gjetjeve të ditës së dytë dhe përgatitja për ditën e tretë. | Diskutim i gjetjeve paraprake me drejtuesit dhe stafin psiko-social. |
| **Dita 3** | | |
| 08:00-11:00 | Analizë mbi efektivitetin e ndërhyrjeve psiko-sociale për rastet ndjekura. | Dokumente të progresit të nxënësve, analiza e statistikave të sukseseve dhe të rasteve të referuara. |
| 10:00-11:00 | Analizë e raporteve për efektivitetin e ndërhyrjes psiko- | Dokumente të komisioni për nxënësit me aftësi të kufizuara. Dokumente të ecurisë së nxënësve me aftësi të kufizuara (planet PEI, vlerësimet periodike |

| | | |
|---|---|---|
| | sociale për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe veprimtarisë së komisionit për nxënësit me aftësi të kufizuara. | të ecurisë së nxënësve me AK, vlerësimet psiko-sociale etj.). |
| 12:30-14:00 | Takim për dhënien e gjetjeve paraprake dhe të rekomandimeve me drejtuesit dhe ekipin psiko-social. | Diskutimi mbi pikat e forta, dobësitë dhe mundësitë për përmirësim të shërbimit. |
| 14:00-16:00 | Përgatitja e raportit përfundimtar dhe diskutimi i tij. | Prezantimi i rezultateve të vlerësimit dhe ndarja e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme. |

## Takimi informues

Grupi i vlerësimit zhvillon një takim paraprak me drejtuesit e shkollës, punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe stafin e shkollës, ku prezanton platformën e vlerësimit për shërbimin psiko-social, duke përcaktuar një orar të përshtatshëm, që nuk cenon procesin mësimor dhe sigurinë e nxënësve. Kjo fazë është e rëndësishme për ndërtimin e marrëdhënieve profesionale, etike dhe bashkëpunuese midis grupit të vlerësimit dhe stafit të shkollës. Vlerësuesit duhet të trajtojnë çdo punonjës të shërbimit psiko-social me paanshmëri dhe respekt.

Në këtë takim, grupi i vlerësimit:

- Prezanton platformën dhe qëllimin e vlerësimit;
- Diskuton metodologjinë e procesit;
- Identifikon burimet njerëzore dhe infrastrukturore për mbështetje.

Drejtuesi i ekipit i kërkon stafit drejtues të shkollës dhe punonjësve të shërbimit psiko-social, t'i vërë në dispozicion dokumentacionin përkatës të shërbimit psiko-social dhe informon për numrin e seancave që do të vëzhgohen, numrin e pyetësorëve që do të zhvillohen dhe mënyrën e përzgjedhjes së nxënësve, të prindërve dhe të stafit për realizimin e tyre.

Drejtuesi i shkollës ofron një panoramë të qartë për nivelin e ofrimit të shërbimeve psiko-sociale dhe pritshmëritë e institucionit. Gjithashtu, ai njofton ekipin për çdo rrethanë që mund të vështirësojë procesin e vlerësimit.

### Takimi përmbyllës

Ditën e fundit të vlerësimit, drejtori i shkollës cakton një orar të përshtatshëm për diskutimin e gjetjeve paraprake. Ekipi i vlerësimit duhet të kërkojë që, përveç punonjësve të shërbimit psiko-social, të marrin pjesë sa më shumë aktorë të shkollës (pushteti lokal, zyra vendore arsimore, këshilli i prindërve, kryetari i bordit të shkollës etj.), në pasqyrimin e gjetjeve dhe të gjykimeve të vlerësimit. Në këtë takim i jepet mundësi shkollës, të reagojë ndaj konkluzioneve paraprake të ekipit të vlerësimit. Gjatë takimit dialogohet mbi gjetjet paraprake të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të vlerësimit, për të rënë në një konsensus të përbashkët, duke rritur frymën e bashkëpunimit profesional mes kolegëve.

## Të drejtat dhe detyrat e aktorëve të përfshirë në procesin e vlerësimit

### Të drejtat dhe detyrat e drejtorit të shkollës dhe të punonjësve të shërbimit psiko-social

Drejtori i shkollës dhe punonjësit e shërbimit psiko-social kanë të drejtë, që:

- të njihen me platformën e vlerësimit, para fillimit të procesit të vlerësimit;
- të njihen me të gjithë anëtarët e ekipit të vlerësimit;
- të jenë prezent dhe të ndjekin vetë, të gjitha veprimet gjatë vlerësimit;
- të kërkojnë dhe të marrin informacion nga vlerësuesi mbi metodologjinë e vlerësimit;

- të paraqesin me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat që kanë të bëjnë me vlerësimin;
- të paraqesin me shkrim apo me gojë, propozimet, për zgjidhjen e çështjes/ve dhe dokumentet përkatëse, për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me vlerësimin;
- të njihen me raportin e vlerësimit;
- të paraqesin me shkrim kontestimet, për përfundimet e vlerësuesve, në përputhje me procedurat e ankimimit.

### Drejtori i shkollës ka për detyrë që gjatë procesit të vlerësimit:

- të komunikojë me vlerësuesit ose të caktojë një përfaqësues, për të komunikuar kur nuk e ka të mundur;
- të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të vlerësimit;
- të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e vlerësuesve;
- të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për vlerësimin, brenda afateve të përcaktuara nga vlerësuesi;
- t'i lejojë grupit të vlerësimit përdorimin e rrjetit WI-FI;
- të lejojë dhe të mundësojë zhvillimin e anketave/pyetësorëve me mësues, nxënës dhe prindër.

### Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë për detyrë, që gjatë procesit të vlerësimit:

- të komunikojnë me vlerësuesit gjatë gjithë procesit të vlerësimit;
- të bashkëpunojnë dhe të mos pengojnë kryerjen e veprimeve të vlerësimit;
- të paraqesin çdo informacion, dokument dhe të japin çdo shpjegim për faktet dhe rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për vlerësimin, brenda afateve të përcaktuara nga vlerësuesi.

### Detyrat e drejtuesit dhe të anëtarëve të ekipit të vlerësimit

Drejtuesi i ekipit të vlerësimit:

- harton planin e realizimit të vlerësimit, i cili miratohet nga eprori;
- bën ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësive për secilin anëtar;

- organizon zhvillimin e vlerësimit;
- sigurohet që anëtarët marrin mbështetjen e nevojshme;
- garanton përdorimin e burimeve të vlerësimit në mënyrë të dobishme, në funksion të përmbushjes së qëllimit;
- siguron që vlerësimi të kryhet sipas platformës së miratuar, në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të jashtëm dhe standardet e inspektorit;
- drejton hartimin e raportit të vlerësimit.

### Anëtarët e ekipit të vlerësimit:

- vëzhgojnë veprimtarinë e shërbimit psiko-social;
- zhvillojnë analizën e veprimtarive të vëzhguara, bazuar në përshkruesit praktikë, sipas treguesve të cilësisë;
- kryejnë fotografime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike, të mjediseve, të dokumentacionit shkollor, të klasave etj., duke ruajtur konfidencialitetin e nxënësve, të mësuesve dhe të prindërve;
- shqyrtojnë çdo dokument të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe dokumente të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik;
- zhvillojnë pyetësorë, anketa apo biseda me mësues prindër, nxënës, duke ruajtur privatësinë e tyre;
- marrin pa pagesë dhe përdorin për qëllimet e vlerësimit, çdo të dhënë të shkollës dhe veprimtarisë së saj;
- administrojnë çdo mjet tjetër prove, për përcaktimin e situatës/situatave faktike dhe të rrethanave të nevojshme, për marrjen e një vendimi përfundimtar;
- komunikojnë me punonjësit e shkollës në mënyrë bashkëpunuese, të hapur, të qartë, etike dhe të çliruar nga çdo formë diskriminimi;
- krijojnë marrëdhënie pune të bazuara në profesionalizëm dhe mirëkuptojnë çdo shqetësim apo rrethanë të veçantë të institucionit.

# RAPORTI[3] I VLERËSIMIT

***Raporti i vlerësimit*** është një dokument i strukturuar që përmbledh gjetjet, analizat dhe rekomandimet e bëra gjatë vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë. Ky raport ka për qëllim të paraqesë një pasqyrë të qartë dhe të saktë të shërbimit psiko-social në shkollë, duke u fokusuar te ndikimi i tij mbi mirëqenien dhe zhvillimin psiko-social të nxënësve, si dhe te përmirësimi i mjedisit shkollor.

## Struktura dhe përmbajtja e raportit

### *1. Përshkrimi i përgjithshëm*

- Vendndodhja e shkollës.
- Numri dhe profili i punonjësve të shërbimit psiko-social.
- Numri i nxënësve që përfitojnë nga shërbimi psiko-social dhe kategoritë e rasteve.
- Mjetet dhe burimet e përdorura nga punonjësit e shërbimit psiko-social.

### *2. Gjetjet dhe gjykimet*

- Analizimi i rasteve të trajtuara (kategoritë e problemeve dhe përqindjet përkatëse).
- Cilësia e ndërhyrjeve këshillimore dhe efektiviteti i tyre.
- Bashkëpunimi i stafit psiko-social me nxënësit, prindërit dhe mësuesit.
- Aktivitetet parandaluese dhe promovuese (seminare, trajnime, fushata ndërgjegjësimi).
- Qasja dhe aksesueshmëria e shërbimit për nxënësit.

### *3. Përfundimet*

- Pikat e forta dhe dobësitë e shërbimit psiko-social në shkollë.

[3] Në aneks jepet formati i raportit të vlerësimit

- Identifikimi i mundësive për përmirësim dhe i kërcënimeve potenciale që mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit.

### *4. Rekomandimet për përmirësim*

- Udhëzime konkrete për fuqizimin e shërbimit psiko-social (p.sh., rritja e burimeve financiare, trajnime të avancuara për stafin, përmirësimi i hapësirave fizike etj.).
- Sugjerime për bashkëpunim më të gjerë me institucione/organizata jashtëshkollore (qendra shëndetësore, organizata sociale).
- Planifikim të aktiviteteve parandaluese.
- Përfshirje më aktive e komunitetit shkollor.

### *5. Masat e mundshme administrative*

- Në rast të identifikimit të mangësive të mëdha të shërbimit psiko-social, të funksionimit të tij në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, grupi i vlerësimit mund të propozojnë masa disiplinore/administrative organit kompetent për dhënien e tyre.

## Procedura e dorëzimit të raportit të vlerësimit

Raporti i vlerësimit dorëzohet shkollës brenda 5 ditëve nga përfundimi i vlerësimit. Një afat prej 2-3 ditësh i jepet shkollës për të paraqitur komentet apo kontestimet e saj, të cilat shqyrtohen me kujdes nga ekipi vlerësues për të përgatitur raportin përfundimtar.

Raporti përfundimtar i dërgohet shkollës dhe institucioneve përkatëse, ndërsa shkolla duhet të ndërmarrë hapa për zbatimin e rekomandimeve, duke përfshirë prindërit, mësuesit dhe nxënësit në këtë proces.

Raporti duhet të publikohet në faqen zyrtare të shkollës, duke rritur transparencën dhe duke informuar palët e interesuara për cilësinë e shërbimit psiko-social. Përvojat pozitive të identifikuara gjatë procesit të vlerësimit, shpërndahen për të frymëzuar praktika të mira në shkollat e tjera.

Ky dokument siguron jo vetëm një analizë të thelluar të cilësisë së shërbimit psiko-social, por gjithashtu, është një udhërrëfyes për përmirësimin e vazhdueshëm të tij, në funksion të mirëqenies së nxënësve dhe të komunitetit shkollor.

# SHKALLËT E VLERËSIMIT

Vlerësimi i cilësisë së shërbimit psiko-social bazohet në "Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor", në të cilën janë përcaktuar shkallët e vlerësimit të cilësisë, në nivel të përshkuesve praktikë, të treguesve të cilësisë, të fushave të cilësisë dhe të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkollë.

"Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor" ofron një qasje të strukturuar për vlerësimin e cilësisë së shërbimit psiko-social, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare për vlerësimin e cilësisë së aktiviteteve trajnuese.

Shkalla e vlerësimit bazohet në kritere të standardizuara, që përfshihen në proceset e vlerësimit. Ajo është krijuar duke marrë parasysh kompetencat profesionale të punonjësve të shërbimit psiko- social, standardet profesionale, metodologjinë e përdorur dhe përmbushjen e rezultateve të pritshme.

Shkalla e vlerësimit është një metodë e përdorur, për të vlerësuar gjykimin *me shprehje* ose *me numra,* në lidhje me një aspekt, objekt, karakter ose një atribut të veprimtarisë së shërbimit psiko-social në shkollë. Shkalla e vlerësimit dhe normat përkatëse të vlerësimit, përbëjnë sistemin që përdoret nga vlerësuesi gjatë vlerësimit të cilësisë. Shkalla e vlerësimit ndihmon për të ofruar një analizë të detajuar të cilësisë së një ofruesi të aktiviteteve trajnuese, duke mundësuar identifikimin e pikave ku nevojiten përmirësime dhe forcimin e aspekteve pozitive.

***Përshkruesit praktikë*** vlerësohen me shkallën numerike sipas niveleve të vlerësimit nga 1 në 4, ku shkalla 1 është niveli më i ulët i cilësisë së shërbimit psiko-social dhe shkalla 4 është niveli më i lartë i saj.

| Nivelet e vlerësimit | Vlerësimi përkatës |
|---|---|
| 4 | Vlerësim shumë pozitiv |
| 3 | Vlerësim pozitiv |
| 2 | Vlerësim negativ |
| 1 | Vlerësim shumë negativ |

***Treguesit e cilësisë*** vlerësohen sipas shkallës së cilësisë, referuar shprehjeve: "*Shumë mirë", "Mirë, "Mjaftueshëm" dhe "Dobët"* (kritike), në përputhje me normën e vlerësimit.

***Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas formulës:***

***Treguesit e cilësisë*** vlerësohen sipas formulës: (Diferenca e ***shumës*** së përshkruesve (të vlerësuar) me ***numrin*** e përshkruesve të treguesit) / (Diferenca e ***pikëve maksimale*** të mundshme me ***pikët minimale*** të përshkruesve të treguesit) x 100.

Për shembull:

- ***Treguesi 1.1. "Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe të sjelljeve problematike".*** ka 15 përshkrues në total.
- Shuma e përshkruesve të vlerësuar është p.sh.: 35.
- Vlerësimi minimal është 15 (15x1) dhe vlerësimi maksimal është 60 (15x4), diferenca e pikëve është 45.
- Vlerësimi i treguesit 1.1. =((35-15)/(60-15)) x 100=(22/39) x 100 = 44.44% (Mirë)

| | | | |
|---|---|---|---|
| Diferenca e **shumës** së përshkruesve (të vlerësuar) me **numrin** e përshkruesve të treguesit | x 100 | = | Norma e vlerësimit të treguesit |
| Diferenca e **pikëve maksimale** të mundshme me **pikët minimale** të përshkruesve të treguesit | | | |

**Treguesit e cilësisë kanë peshë të barabartë.**

***Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimit psiko-social kryhet sipas formulës:***

| | | |
|---|---|---|
| F1 + F2 + F3 + F4 | = | Norma e vlerësimit të përgjithshëm të shërbimit psiko-social. |
| 4 | | |

***Norma e vlerësimit*** *është* model standard, që përcakton shkallën e cilësisë sipas nivelit të vlerësimit.

***Tabela e vlerësimit të përgjithshëm të shërbimit psiko social:***

| **Norma e vlerësimit** | **Shkalla e cilësisë** | **Rekomandime** |
|---|---|---|
| 83.33% - 100% | Shumë mirë | Të ruhet cilësia. |
| 50% - 83.32% | Mirë | Ka nevojë për disa përmirësime të vogla. |
| 16.66% - 49.99% | Mjaftueshëm | Ka nevojë për përmirësime në disa fusha. |
| deri në 16.65% | Dobët | Kërkon rishikim të plotë të shërbimeve të ofruara. |

*Më poshtë janë paraqitur përshkrime të përgjithshme të vlerësimeve, të cilat përdoren gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social.*

***Përshkruesit praktikë*** vlerësohen sipas niveleve të vlerësimit: 1, 2, 3, 4.

***Treguesit e cilësisë*** vlerësohen sipas shkallës së cilësisë, në përputhje me normën e vlerësimit të përshkruesve praktikë, përkatësisht:

- ***Shumë mirë:*** kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar 83.33% - 100% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- ***Mirë**:* kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar 50% - 83.32% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- ***Mjaftueshëm*:** kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar 16.66% - 49.99% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- ***Dobët:*** kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar deri në 16.65% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.

# VETËVLERËSIMI I PUNONJËSVE PSIKO-SOCIALË DHE LIDHJA ME VLERËSIMIN E BRENDSHËM

Vetëvlerësimi është proces sistematik i reflektimit, që kryhet nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për të analizuar efektivitetin e praktikave dhe ndikimin që ato kanë në mirëqenien dhe zhvillimin e nxënësve. Vetëvlerësimi i ndihmon ata në identifikimin e mënyrës, se si shërbimi psiko-social ndikon në zhvillimin e nxënësve, në përmirësimin e procesit të të nxënit, në sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale, si dhe në bashkëpunimin me familjen dhe me komunitetin.

Ky proces përfshin:

- ***Analizën e punës së tyre:*** Psikologët dhe punonjësit socialë analizojnë të dhënat për ndikimin e ndërhyrjeve të tyre në menaxhimin e emocioneve, përmirësimin e sjelljes dhe zhvillimin e aftësive sociale dhe të nxënit të nxënësve.
- ***Përcaktimin e pikave të forta dhe të dobëta:*** Psikologët dhe punonjësit socialë identifikojnë fushat, ku praktikat e tyre kanë qenë më efektive dhe ato që kërkojnë përmirësim.
- ***Dokumentimin e rezultateve:*** Psikologët dhe punonjësit socialë hartojnë raporte, që përfshijnë të dhëna nga testet psikologjike të standardizuara, anketat me nxënësit, prindërit dhe mësuesit, planet individuale të ndërhyrjes dhe aktivitete sensibilizuese.
- ***Formulimin e rekomandimeve:*** Psikologët dhe punonjësit socialë hartojnë plane për përmirësimin e shërbimeve të tyre, duke përfshirë propozime për qasje më efektive dhe bashkëpunim të zgjeruar me pjesën tjetër të stafit shkollor.

Punonjësit e shërbimit psiko-social, përmes vetëvlerësimit, reflektojnë mbi arritjet dhe sfidat në punën e tyre. Ata mbledhin të dhëna dhe evidenca mbi ndërhyrjet e bëra, si identifikimi i nxënësve me probleme në sjellje dhe vështirësi në të nxënë, analizat e problematikave të sjelljes, të bullizmit apo të varësive, si dhe aktivitetet sensibilizuese me nxënësit, prindërit dhe mësuesit. Këto të dhëna ndihmojnë në evidentimin e

praktikave të suksesshme, si dhe përcaktojnë fushat ku nevojiten ndryshime, për të përmirësuar efektivitetin e shërbimit.

Nga ana tjetër, shkolla realizon vlerësimin e brendshëm në përputhje me "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë" dhe "Metodologjia e vlerësimit të brendshëm të shkollës", ASCAP 2020, ku vlerësimi i brendshëm:

- përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të shkollës, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;
- kryhet çdo vit;
- mbulon të gjitha fushat e cilësisë, në përputhje me "Udhëzuesi për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës", ASCAP, 2020;
- kryhet në nivel individual (drejtori, nëndrejtori, mësuesi) dhe në nivel organizmash të shkollës (drejtoria, këshilli i mësuesve, ekipi lëndor).

Vlerësimi i brendshëm i shkollës realizohet nga një grup qendror, i cili përbëhet nga anëtarët e drejtorisë së shkollës dhe kryetarët e ekipeve lëndore.

Vetëvlerësimi i punonjësve të shërbimit psiko-social dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës nuk janë procese të izoluara, por funksionojnë në mënyrë sinergjike. Këto dy procese ndihmojnë në krijimin e një kulture të reflektimit dhe të përmirësimit të vazhdueshëm, ku shërbimi psiko-social dhe grupi qendror i vlerësimit të brendshëm punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta. Kjo ndërlidhje është thelbësore, për të kuptuar se si shërbimi psiko-social ndikon jo vetëm në mirëqenien individuale të nxënësve, por edhe në performancën dhe funksionimin e përgjithshëm të shkollës.

Procesi i vetëvlerësimit të punonjësve të shërbimit psiko-scocial ndërlidhet ngushtë me treguesin e cilësisë 4.5: "*Psikologu/punonjësi social kontribuon për mirëqenien e të gjithë individëve dhe të grupeve në shkollë",* i cili përdoret për vlerësimin e brendshëm të shkollës. Fushat dhe treguesit e cilësisë të përcaktuara në "Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor", ofrojnë një kornizë të qartë për matjen e performancës së shërbimit psiko-social.

Përmes kësaj kornize, procesi i vetëvlerësimit siguron një analizë të detajuar të fushave specifike të shërbimit psiko-social, duke nxjerrë në pah ndikimin e tij në mirëqenien e nxënësve dhe në krijimin e një klime pozitive në shkollë. Kjo analizë ndihmon grupin qendror, të ndërtojë një kuptim më të plotë të sfidave dhe të suksesit të përgjithshëm të shkollës.

Grupi qendror i vlerësimit të brendshëm përdor të dhënat e vetëvlerësimit, për të krahasuar dhe për të verifikuar ndikimin e punës së shërbimit psiko-social. Ky proces përfshin analizimin e raportimeve dhe të dokumenteve, intervistat me nxënës, prindër dhe mësues, si dhe vëzhgimin e situatave konkrete në shkollë. Integrimi i vetëvlerësimit të punonjësve të shërbimit psiko-social në vlerësimin e brendshëm të shkollës krijon një pasqyrë të plotë të cilësisë së shërbimit psiko-social dhe ndihmon në formulimin e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme.

## Ndërlidhja me fushat dhe treguesit e cilësisë

### Fusha 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve

Përmes vetëvlerësimit, punonjësit e shërbimit psiko-social dokumentojnë punën e tyre në mbështetjen e nxënësve, për menaxhimin e emocioneve dhe trajtimin e sjelljeve problematike. Ata analizojnë dhe raportojnë ndërhyrjet e bëra, si:

- Identifikimi i nxënësve me probleme emocionale ose sjellje problematike.
- Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale për përmirësimin e mirëqenies emocionale.
- Organizimi i aktiviteteve që nxisin vetëbesimin dhe zhvillimin emocional.

### Fusha 2: Procesi i të nxënit

Në vetëvlerësim, punonjësit psiko-socialë theksojnë mënyrat se si ndihmojnë nxënësit në zhvillimin e aftësive të tyre për të përballuar sfidat e të nxënit. Për shembull, ata:

- Përcaktojnë strategji për përshtatjen e metodave të të nxënit me nevojat individuale të nxënësve.

- Hartojnë plane ndërhyrjeje për nxënësit me vështirësi specifike ose nevoja të veçanta edukative.
- Organizojnë trajnime për mësuesit dhe prindërit mbi teknika mbështetëse për të nxënët.

### Fusha 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale

Në këtë fushë, vetëvlerësimi i punonjësve psiko-socialë dokumenton mënyrat, se si ata:

- Promovojnë komunikimin e hapur dhe të respektueshëm ndërmjet nxënësve, mësuesve dhe prindërve.
- Trajtojnë situatat e konfliktit dhe ndërhyjnë për të ndërtuar marrëdhënie bashkëpunuese.
- Zhvillojnë aktivitete për sensibilizimin ndaj diversitetit dhe respektimit të të drejtave të të gjithëve.

### Fusha 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin

Vetëvlerësimi përfshin gjithashtu, të dhëna mbi aktivitetet e realizuara për përmirësimin e bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin, si:

- Sesione informuese me prindërit mbi shëndetin mendor dhe prindërimin pozitiv.
- Përfshirja e komunitetit në aktivitetet shkollore. Zhvillimi i marrëdhënieve transparente dhe të qëndrueshme me prindërit.

# MONITORIMI DHE MBËSHTETJA PAS VLERËSIMIT

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së shërbimit psiko-social, hapi vijues dhe po aq i rëndësishëm është faza e monitorimit dhe e mbështetjes, për të siguruar zbatimin efektiv të rekomandimeve dhe për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Kjo fazë është thelbësore, për të garantuar që ndryshimet e propozuara, të mos mbeten thjesht teori, por të shndërrohen në veprime konkrete dhe të prekshme, që ndikojnë pozitivisht në mirëqenien dhe zhvillimin e nxënësve.

Pas dorëzimit të raportit të vlerësimit, ekipi vlerësues duhet të angazhohet ngushtë me drejtuesit e shkollës dhe stafin psiko-social, për të hartuar një plan përmirësimi[4] konkret, zbatimi të rekomandimeve. Ky plan duhet të përfshijë afate kohore, burime të nevojshme dhe role të qarta për të gjithë aktorët e përfshirë. Në këtë fazë, është e rëndësishme që rekomandimet të përshtaten me rrethanat specifike të shkollës, duke marrë parasysh kapacitetet ekzistuese dhe sfidat që mund të hasen gjatë zbatimit. Një qasje bashkëpunuese siguron që rekomandimet të jenë realiste dhe të zbatueshme, duke rritur gjasat për një përmirësim të qëndrueshëm**.**

Një nga elementet kryesore të mbështetjes pas vlerësimit, është fuqizimi i kapaciteteve të shërbimit psiko-social dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë. Organizimi i trajnimeve fokusohet në fuqizimin e punonjësve të shërbimit psiko-social me njohuri të avancuara dhe aftësi praktike, për t'u përballur me sfidat që lidhen me mirëqenien psiko-sociale të nxënësve.

Trajnimet mund të përfshijnë tema, si ndërhyrjet për menaxhimin e stresit dhe të ankthit te nxënësit, trajtimi i rasteve të ndërlikuara (p.sh., bullizmi, trauma, shëndeti mendor etj.), si dhe përdorimi i qasjeve digjitale për mbështetjen dhe monitorimin e nxënësve.

Për të siguruar që rekomandimet janë zbatuar me sukses dhe për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave që mund të dalin gjatë procesit të implementimit, është thelbësore

---

[4] Ne aneks gjendet nje format për planin e përmirësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social.

kryerja e një monitorimi periodik. Ky monitorim përfshin vlerësimin e progresit të arritur dhe identifikimin e fushave që mund të kërkojnë mbështetje shtesë.

Raportet e progresit, intervistat me stafin psiko-social, drejtuesit dhe përfaqësuesit e nxënësve, si dhe vëzhgimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve psiko-sociale ndihmojnë në krijimin e një pasqyre të qartë mbi ndryshimet që janë realizuar. Ky proces duhet të jetë i vazhdueshëm dhe të përqendrohet në ndërtimin e një kulture të përmirësimit të qëndrueshëm dhe të përbashkët në shkollë.

Për një mbështetje të qëndrueshme, rekomandohet që shkolla të krijojë ose të forcojë partneritetet me organizata, institucione dhe individë, që mund të ofrojnë mbështetje të specializuar në fusha të ndryshme. Këto mund të përfshijnë qendra për shëndetin mendor, organizata joqeveritare ose profesionistë të fushës. Po ashtu, investimi në burimet e brendshme, si pajisje, materiale dhe teknologji për shërbimin psiko-social, është një hap i domosdoshëm për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e këtij shërbimi.

Në këtë mënyrë, monitorimi dhe mbështetja pas vlerësimit, nuk është thjesht një hap përmbyllës, por një cikël i vazhdueshëm që garanton se shërbimi psiko-social në shkollë, zhvillohet si një mjet i fuqishëm për mbështetjen dhe zhvillimin e nxënësve në çdo aspekt të jetës së tyre.

# Plani i përmirësimit të punonjësve të shërbimit psiko-social

Punonjësit e shërbimit psiko-social luajnë rol kritik në sigurimin e mirëqenies emocionale dhe sociale të nxënësve, ndihmojnë për tejkalimin e sfidave të ndryshme dhe krijimin e një mjedisi shkollor mbështetës. Vlerësimi i brendshëm i shkollës, vetëvlerësimi i punonjësve të shërbimit psiko-social, si dhe vlerësimi i jashtëm, shpesh, tregojnë nevojën për të fuqizuar këta profesionistë nëpërmjet trajnimeve, përmirësimit të burimeve dhe përforcimit të bashkëpunimit me stafin dhe prindërit.

Nisur nga aspektet që kanë nevojë për përmirësim, të dala nga këto vlerësime, ata duhet të hartojnë një plan përmirësimi, i cili synon të adresojë këto nevoja, duke rritur

kompetencat profesionale, duke përmirësuar mjedisin e punës dhe duke siguruar që të jenë më profesional, për të përmbushur sfidat e kohës. Në këtë mënyrë, përmes edhe bashkëpunimit të ngushtë me stafin e shkollës, prindërve dhe komunitetin, ata do të jenë më të aftë për të ndihmuar nxënësit, për të parandaluar situata problematike dhe për të mbështetur komunitetin shkollor në tërësi. Ky plan do të shërbejë si udhërrëfyes, për të fuqizuar punonjësit e shërbimit psiko-social, duke krijuar një shkollë më mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse.

### *Shembull: Ndërhyrjet për trajtimin e bullizmit*

Bullizmi në shkollë është një sfidë komplekse që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien emocionale, sociale dhe akademike të nxënësve. Për ta adresuar atë në mënyrë efektive, kërkohet një qasje e koordinuar dhe gjithëpërfshirëse, që përfshin punonjësit e shërbimit psiko-social, stafin mësimdhënës dhe prindërit. Më poshtë, është një përshkrim i detajuar i hapave kryesorë për trajtimin e situatave të bullizmit në shkollë.

*Konteksti:*

Shkolla 9-vjecare "Horizonti" është një shkollë me 500 nxënës. Kohët e fundit, janë raportuar raste bullizmi në klasën e tetë, ku një grup nxënësish kanë shënjestruar një vajzë të quajtur Alisa.

*Situata:*

Alisa është një vajzë e qetë dhe e përkushtuar ndaj mësimeve. Ajo shpesh qëndron e tërhequr dhe preferon të shoqërohet me një grup të vogël miqsh.

Grupi i bullizuesve:

- Tallen me të për pamjen e saj fizike dhe mënyrën e të folurit.
- Postojnë foto të saj në rrjetet sociale, duke e etiketuar me komente ofenduese.
- Ndodh që e izolojnë Alisën, të mos marrë pjesë në aktivitete të klasës, duke i thënë se "nuk je e mirëpritur".
- Në disa raste, e kanë shtyrë fizikisht gjatë pushimeve apo i kanë marrë sendet personale.

*Ndikimi:*

- Alisa ka filluar të mungojë shpesh në shkollë, duke dhënë justifikime të paqarta.
- Rezultatet e saj në mësime kanë rënë ndjeshëm, në krahasim me vitet e mëparshme.
- Ajo ka filluar të shfaqë shenja ankthi, si lodhje e vazhdueshme, mungesë përqendrimi dhe dëshirë për të qëndruar vetëm në shtëpi.

*Rezultatet e pritshme:*

- Alisa rimerr vetëbesimin dhe integrimin në mjedisin shkollor.
- Ndryshimi i sjelljeve te bullizuesit, duke rritur ndjeshmërinë dhe aftësitë ndërvepruese sociale.
- Një shkollë më e sigurt, duke krijuar një kulture respekti dhe bashkëpunimi midis nxënësve, stafit dhe prindërve.

***1.*** *Identifikimi dhe vlerësimi i rastit*

- Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me stafin e shkollës dhe prindërit, mbledhin informacione për rastin konkret dhe raste të tjera të mundshme, përmes intervistave individuale me nxënësit dhe Alisën, bullizuesit dhe aktorët e tjerë të përfshirë.
- Analiza bëhet bazuar në vëzhgime, raportime nga mësuesit dhe shprehjet emocionale të nxënësve.
- Vlerësimi i Alisës, për të identifikuar ndikimet emocionale dhe sociale të përvojës së saj, si ankthi, ulja e vetëbesimit ose izolimi, si dhe për të kuptuar motivet pas sjelljeve të saj dhe për të identifikuar nevoja të mundshme për adresimin e ndërhyrjeve të mundshme terapeutike të jashtme.

*2. Organizimi i takimeve dhe komunikimi*

- Informimi i stafit për situatën dhe politikat e shkollës mbi bullizmin.
- Zhvillimi i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e njohjes dhe adresimit të bullizmit në klasë.

- Udhëzime për prindërit e Alisës (dhe të tjerë nëse janë identifikuar), mbi mënyrat për të mbështetur emocionalisht fëmijën e tyre.
- Angazhimi i prindërve të Alisës në një proces dialogu, për të kuptuar ndikimin e sjelljeve të fëmijës së tyre dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta.

*3. Ndërhyrje psiko-sociale për nxënësit*

- Seanca individuale për të adresuar emocionet e shkaktuara nga përvoja e bullizmit dhe për të ndërtuar vetëbesimin.
- Ofrimi i strategjive për të menaxhuar situata të ngjashme në të ardhmen, përfshirë teknika të komunikimit dhe aftësi për zgjidhjen e konflikteve.

- Organizimi i seancave edukative me nxënësit bullizues, për zhvillimin e empatisë dhe të ndërgjegjësimit mbi pasojat e bullizmit.
- Përfshirja e nxënësve bullizues në aktivitete sociale që promovojnë bashkëpunimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve pozitive.

*4. Fuqizimi i bashkëpunimit shkollë-prindër-komunitet*

- Promovimi i një kulture mbështetëse në klasë, përmes aktiviteteve të grupit që forcojnë respektin dhe bashkëpunimin mes nxënësve.
- Vëzhgimi i sjelljeve në klasë dhe raportimi i çdo rasti të sjelljes së papërshtatshme.

- Takime edukative për rëndësinë e shëndetit emocional dhe ndikimin që sjelljet e tyre kanë te fëmijët.
- Udhëzime praktike për prindërit për të ndihmuar në ndryshimin e sjelljes së fëmijëve.

*5. Parandalimi afatgjatë dhe edukimi*

- Organizimi i aktiviteteve edukative për të luftuar stigmën mbi bullizmin dhe për të promovuar empatinë.
- Përfshirja e diskutimeve të hapura, lojërave interaktive dhe sesioneve edukative mbi respektin në aktivitete.

- Hartimi dhe implementimi i planeve antibullizëm, që përfshijnë protokolle të qarta për raportimin dhe trajtimin e rasteve.
- Përdorimi i një linje raportimi anonime për nxënësit, për të siguruar që çdo rast të adresohet në kohë.

*6. Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm*

- Zhvillimi i anketave, i pyetësorëve, i fokusgrupeve për të marrë feedback të vazhdueshëm nga nxënësit, prindërit dhe stafi, për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve.
- Takime të rregullta me të gjitha palët, për të rishikuar dhe për të përmirësuar planin sipas nevojave të reja.
- Fushata ndërgjegjësimi me të gjithë aktorët e shkollës, për të luftuar bullizmin dhe për të promovuar një kulturë të shëndetshme komunikimi.
- Politika antibullizëm që përcaktojnë masa disiplinore të qarta dhe konkrete, për rastet e raportuara.

# ANEKS

## Konteksti i shërbimit psiko-social në shkollë

Ky dokument përfshin të dhëna më të detajuara dhe sasiore për shërbimin psiko-social në shkollë. Të dhënat do të ndihmojnë në monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e shërbimeve psiko-sociale të ofruara për nxënësit, mësuesit dhe prindërit.

**1. Të dhënat e përgjithshme të shërbimit psiko-social:**

- Emri i shkollës: ______________________
- Lloji i shkollës: ________________________
- Adresa e shkollës: ______________________
- Numri total i nxënësve: ______________
- Numri i nxënësve që përfitojnë nga shërbimi psiko-social:________
- Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara: _______
- Përqindja krahasuar me totalin: _____%
- Numri i punonjësve psiko-socialë në shkollë:

  - Psikologë:______
  - Punonjës socialë:______
  - Oficer sigurie:______

- Kohëzgjatja e shërbimit psiko-social të ofruar në ditë/javë:______
- Data e vlerësimit të fundit të shërbimit psiko-social:_____________
- Vlerësimi i shërbimit psiko-social sipas shkallëve të cilësisë:______

**2. Mbështetje individuale dhe këshillim psikologjik:**

- Numri i seancave individuale për nxënësit gjatë vitit shkollor:_______
- Nxënës që kanë marrë mbështetje individuale:______ nxënës
- Numri i nxënësve që kanë kërkuar mbështetje për çështje të shëndeti mendor (ankth, depresion etj.): ______ nxënës

- Numri i nxënësve që kanë kërkuar mbështetje për çështje sociale (bullizmi, vështirësi në marrëdhëniet shoqërore etj.): _______ nxënës
- Numri i nxënësve që janë mbështetur pas ngjarjeve traumatike (dhunë familjare, ndarje prindërish, vdekje): _______ nxënës

**3. Seanca në grup dhe aktivitetet psiko-edukative:**

- Numri i seancave të këshillimeve në grup me nxënës për çështje të shëndeti mendor (stresi, ankthi etj.):_______
- Numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në seancat në grup për problematika të shëndetit mendor( stres, ankth etj.):_______
- Numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në seanca në grup për çështje sociale (bullizmi, vështirësi në marrëdhëniet shoqërore etj.): _______
- Numri i aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuese, psiko-edukative me nxënës për çështje të shëndetit mendor, përdorimit të substancave dhe varësive, zgjidhjen e konflikteve etj. : _______
- Numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuese, psiko-edukative me nxënës për çështje të shëndetit mendor, përdorimit të substancave dhe varësive, zgjidhjen e konflikteve : _______

**4. Konsultime dhe këshillime për prindërit dhe trajnime për stafin:**

- Numri i seancave këshilluese me prindërit (individuale dhe grup): _______
- Numri i prindërve të mbështetur për çështje të shëndetit mendor të fëmijëve të tyre: _______
- Numri i prindërve që kanë marrë konsultim/ këshillim për menaxhimin e sjelljeve problematike të fëmijëve: _______
- Numri i trajnimeve për stafin mësimor: _______
- Numri i mësuesve të trajnuar për të identifikuar dhe për të adresuar nevojat psiko-sociale të nxënësve: _______
- Orët e trajnimeve të ofruara për stafin gjatë vitit shkollor: _______ orë

5. **Të dhënat mbi aktivitetet e shërbimit psiko-social gjatë tri viteve të fundit:**

- Numri i nxënësve që kanë marrë mbështetje individuale gjatë viteve të fundit:

  - 2021-2022:______ nxënës
  - 2022-2023:______ nxënës
  - 2023-2024:______ nxënës

- Numri i këshillimeve në grup për nxënësit me vështirësi emocionale dhe sociale:

  - 2021-2022:______ nxënës
  - 2022-2023:______ nxënës
  - 2023-2024:______ nxënës

- Numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitete për dhunën dhe përdorimin e substancave:______ nxënës
- Numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitete për shëndetin mendor:______ nxënës

- Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara:

  - 2021-2022:______ nxënës
  - 2022-2023:______ nxënës
  - 2023-2024:______ nxënës

# Formati i vetëvlerësimit të punonjësve të shërbimit psiko-social

| Fusha e cilësisë 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Treguesi i cilësisë** | **Përshkruesit praktikë** | **Nivelet e vlerësimit** | | | |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| **1.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe sjelljeve problematike. | **1.1.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda të ndryshme vlerësimi (si, vëzhgimi, intervistimi, listëkontrolli, etj.), për vlerësimin e sjelljes së nxënësve. | | | | |
| | **1.1.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista individuale me nxënësit, për të kuptuar ndryshimet emocionale dhe sjellore. | | | | |
| | **1.1.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë, fokusgrupe, për të mbledhur të dhëna, në funksion të vlerësimit të sjelljes së nxënësve. | | | | |
| | **1.1.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë analizat periodike dhe vjetore të shkollës dhe raportet e stafit të shkollës, për të vlerësuar ndryshimet në sjellje. | | | | |
| | **1.1.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | standardizuara (listëkontrolli, teste, etj.), për identifikimin e problematikave emocionale të nxënësve. | | | | |
| | **1.1.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë faktorët e jashtëm, që ndikojnë në mirëqenien sociale dhe emocionale të nxënësve, nëpërmjet vëzhgimeve dhe komunikimit me nxënësit dhe familjet e tyre. | | | | |
| | **1.1.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë fokusgrupin me nxënës, si metodë për të vlerësuar përfshirjen dhe angazhimit e tyre në jetën shkollore. | | | | |
| | **1.1.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente vlerësimi, për të matur nivelin e stresit te nxënësit. | | | | |
| | **1.1.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë aftësitë e nxënësve, për të menaxhuar dhe për të zgjidhur konflikte dhe i ndihmojnë ata. | | | | |
| | **1.1.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve gjatë veprimtarisë në mjediset e shkollës. | | | | |
| | **1.1.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë burime të dhënash | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | nga shërbime të tjera (si terapi, mbështetje të jashtme, etj.), për të kuptuar më gjerë nevojat dhe ecurinë e nxënësve. | | | | |
| | **1.1.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të standardizuara, vetëraportuese, listëkontrolli, teste, etj., për vlerësimin e vetëvlerësimit, të vetëkontrollit dhe menaxhimin e emocioneve të nxënësve. | | | | |
| | **1.1.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të edukimit bashkëmoshatar (si grupet mbështetëse) për nxënësit me vështirësi sjellore dhe emocionale. | | | | |
| | **1.1.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin materiale edukative, për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë dhe të menaxhojnë emocionet (libra, fletushka, aktivitete online etj.), për t'u mësuar nxënësve si të kuptojnë dhe menaxhojnë emocionet e tyre. | | | | |
| | **1.1.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social referojnë për shërbime të specializuara (si vlerësim i thelluar, trajtim, etj.) nxënësit të cilët manifestojnë vështirësi sjellore ose emocionale, kur vlerësojnë që | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | ndërhyrjet brenda shkollës nuk janë të mjaftueshme. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 1.1.:** | | | | | |
| **1.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht. | **1.2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë ose fokusgrupe, për të vlerësuar klimën në shkollë. | | | | |
| | **1.2.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve gjatë procesit mësimor, kur nevojitet vlerësim për planifikimin e ndërhyrjes. | | | | |
| | **1.2.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në grupet e diskutimit dhe në organizimin e aktiviteteve që promovojnë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për nxënësit. | | | | |
| | **1.2.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë raportet e stafit të shkollës mbi sigurinë në shkollë. | | | | |
| | **1.2.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna për të vlerësuar besimin dhe sigurinë e nxënësve në shkollë. | | | | |
| | **1.2.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social evidentojnë, vlerësojnë, ndërhyjnë dhe monitorojnë rastet e bullizmit dhe të dhunës. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **1.2.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin masa të ofrojnë ose të referojnë për shërbime më të specializuara nxënësit në nevojë për mbështetje sociale. | | | | |
| | **1.2.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna për të vlerësuar nivelin e stresit dhe të mirëqenies psiko-emocionale te nxënësit. | | | | |
| | **1.2.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna, për të vlerësuar nivelin e shqetësimeve që lidhen me shëndetin mendor të nxënësve (ankthin, depresionin etj.). | | | | |
| | **1.2.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete dhe veprimtari praktike me nxënësit, me qëllim mësimin e aftësive të qëndrueshme, për të menaxhuar stresin dhe për të përballuar situatat sociale të vështira. | | | | |
| | **1.2.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë hapësira të dedikuara për mbështetjen emocionale të nxënësve. | | | | |
| | **1.2.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teknika të ndryshme ndërhyrjeje për përmirësimin e | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | sigurisë emocionale të nxënësve. | | | | |
| | **1.2.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit për integrimin në aktivitetet që promovojnë zhvillimin social. | | | | |
| | **1.2.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit në situata që shkaktojnë pasiguri (kriza, emergjenca etj.). | | | | |
| | **1.2.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete trajnuese/informuese për mbështetjen e mësuesve dhe të nxënësve dhe për ndihmën e parë psikologjike. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 1.2.:** | | | | | |
| **1.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshm | **1.3.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë në bashkëpunim me mësuesit, nxënësit me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.3.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit lëndorë dhe ndihmës, për hartimin e planeve individuale për nxënësit me aftësi të kufizuara. | | | | |
| | **1.3.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit lëndorë dhe ndihmës, për hartimin e planeve individuale për nxënësit me nevoja të | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| e dhe individuale. | veçanta. | | | | |
| | **1.3.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për përshtatjen e mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.3.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për vlerësimin e gjendjes së nxënësve me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta dhe ecurinë e tyre. | | | | |
| | **1.3.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me prindërit për vlerësimin e gjendjes së nxënësve me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta dhe ecurinë e tyre. | | | | |
| | **1.3.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për angazhimin e nxënësve të tjerë, në mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.3.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin e shkollës për angazhimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta në aktivitete mësimore dhe sociale, me qëllim integrimin e tyre në grup. | | | | |
| | **1.3.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | standardizuara, për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve individuale mbi performancën sociale dhe shkollore të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.3.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë në mënyrë periodike ndryshimet në sjellje dhe zhvillimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.3.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika kreative, si lojërat ose artin, për të ndihmuar nxënësit të shprehin emocionet e tyre, duke ndihmuar që ata të rriten nga pikëpamja psiko-socio-emocionale. | | | | |
| | **1.3.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë drejtuesit e shkollës, mësuesit dhe prindërit për ecurinë e nxënësve, mbi zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale. | | | | |
| | **1.3.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta, për të bashkëpunuar me specialistë të fushave përkatëse, për përmbushjen dhe nevojat terapeutike, rehabilituese etj. | | | | |
| | **1.3.14.** Punonjësit e shërbimit psiko- | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | social zhvillojnë seanca informuese, trajnime me mësuesit, mbi aftësinë e kufizuar dhe nevojat e veçanta të nxënësit. | | | | |
| | **1.3.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit, bazuar në analizën e funksioneve të sjelljes, në ofrimin e ndihmës dhe të mbështetjes për menaxhimin e sjelljes te nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta në klasë. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 1.3:** | | | | | |
| **1.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë dhe zbatojnë plane për të parandaluar dhe për të trajtuar problematikat e sjelljes dhe të shëndetit mendor të nxënësve. | **1.4.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente vlerësues për identifikimin e nxënësve që shfaqin simptoma të depresionit, të ankthit ose problematika të tjera që lidhen me shëndetin mendor dhe mirëqenien e nxënësve. | | | | |
| | **1.4.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente vlerësuese për identifikimin e nxënësve që manifestojnë problematika sjellore. | | | | |
| | **1.4.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë dhe zbatojnë plane për trajtimin e sjelljeve problematike. | | | | |
| | **1.4.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë ndikimin e ndërhyrjeve të | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | aplikuara për trajtimin dhe përmirësimin e sjelljes te nxënësit. | | | | |
| | **1.4.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë ecurinë e nxënësve në mjedisin e shkollës, kur nxënësi merr shërbime dhe terapi të specializuara jashtë institucionit arsimor. | | | | |
| | **1.4.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe përpunojnë të dhëna për të vlerësuar pasojat e dhunës dhe të bullizmit. | | | | |
| | **1.4.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të standardizuara, vetëraportuese, listëkontrolli, teste etj., për vlerësimin e vetëkontrollit dhe menaxhimin e sjelljes te nxënësit. | | | | |
| | **1.4.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë ndryshimet në sjelljen e nxënësve në raste krize dhe emergjence. | | | | |
| | **1.4.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social raportojnë mbi ecurinë dhe efektivitetin e planeve të ndërhyrjes në përmirësimet e sjelljeve të papërshtatshme. | | | | |
| | **1.4.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social raportojnë te drejtuesit e | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | shkollës dhe prindërit mbi ndihmën që u kanë ofruar nxënësve në raste krize dhe emergjence. | | | | |
| | **1.4.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë sjelljet dhe efektivitetin e ndërhyrjeve për rastet që kanë marrë trajtim dhe mbështetje psiko-sociale. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 1.4:** | | | | | |
| **Vlerësimi i fushës 1: (T1+T2+T3+T4)/4** | | | | | |
| **Fusha 2: Procesi i të nxënit** | | | | | |
| **2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre, në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në procesin mësimor dhe vetëbesimin në aftësitë e tyre në të nxënë. | **2.1.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme, si: vëzhgime, intervista, pyetësorë dhe teste, për të identifikuar aftësitë dhe nevojat e nxënësve në të nxënë. | | | | |
| | **2.1.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme vlerësimi, për të ndihmuar nxënësit të reflektojnë mbi aftësitë e tyre dhe mundësitë për përmirësim. | | | | |
| | **2.1.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista individuale me nxënësit, për të kuptuar më mirë aftësitë e tyre, pasionet dhe interesat, të cilat mund të ndikojnë në përfshirjen e mëtejshme në procesin mësimor. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **2.1.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione nga prindërit, mësuesit dhe aktorë të tjerë të shkollës, për të krijuar një pamje më të plotë të aftësive dhe të potencialeve të nxënësve. | | | | |
| | **2.1.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin në vijimësi të dhëna nga stafi i shkollës, për përfshirjen e nxënësve në veprimtari të ndryshme në klasë dhe jashtë saj, për të analizuar faktorët që ndikojnë në angazhimin ose jo të nxënësve. | | | | |
| | **2.1.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teste të standardizuara për vlerësimin e aftësive të veçanta akademike të nxënësve, në funksion të hartimit të strategjive mbështetëse për përmirësimin e tyre. | | | | |
| | **2.1.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë me prindërit për përfshirjen e nxënësve në veprimtari të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj, për të analizuar faktorët që ndikojnë në angazhimin ose jo të nxënësve dhe ndikimin e përfshirjes në aktivitete shkollore. | | | | |
| | **2.1.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social, bashkëpunojnë me mësuesit për | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | organizimin aktivitete me nxënësit, me qëllim zhvillimin e aftësive të tyre. | | | | |
| | **2.1.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë të dhënat e mbledhura në lidhje me arritjet e nxënësve dhe përfshirjen e tyre në veprimtaritë në klasë e shkollë, për të orientuar mësuesit si të ofrojnë mbështetje ndaj nxënësve në fushat që kanë nevojë për përmirësim. | | | | |
| | **2.1.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social raportojnë në vijimësi te drejtuesit e shkollës dhe mësuesit mbi arritjet dhe vështirësitë e nxënësve brenda kufijve të konfidencialitetit. | | | | |
| | **2.1.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë plane individuale për nxënësit, me qëllim zhvillimin e aftësive dhe përmirësimin e angazhimit në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.1.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë sesione informuese, aktivitete sociale në grup me nxënësit, për t'i ndihmuar në forcimin e vetëbesimit dhe përfshirjen në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.1.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë në vijimësi zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | vlerësojnë përparimin me qëllim përshtatjen e strategjive mbështetëse. | | | | |
| | **2.1.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi, që nxënësit të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre, me qëllim përmirësimin e zhvillimin e tyre shkollor dhe personal, duke krijuar mundësi për reflektim dhe vetëvlerësim. | | | | |
| | **2.1.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë raporte periodike mbi ndërhyrjet dhe rezultatet e tyre në arritjet e nxënësve, bazuar në objektivat e planifikuar. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 2.1:** | | | | | |
| **2.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe prindërit, për të përshtatur strategjitë e të nxënit sipas nevojave individuale të nxënësve, veçanërisht | **2.2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë/fokusgrupe me mësuesit, për të mbledhur mendime dhe sugjerime mbi mënyrën e përshtatjes së metodave të mësimdhënies, në përputhje me nevojat individuale të nxënësve dhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative. | | | | |
| | **2.2.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione nga prindërit, për të kuptuar nevojat e veçanta të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| për ata me aftësi të kufizuara dhe nevoja veçanta. | | fëmijëve dhe për të siguruar që strategjitë e të nxënit të përshtaten me nevojat e tyre individuale. | | | | |
| | **2.2.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë mësimdhënien dhe punën e mësuesve, për të vlerësuar implementimin e strategjive individuale për nxënësit, duke identifikuar mundësitë për përmirësime dhe përshtatje të mëtejshme të metodave. | | | | |
| | **2.2.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit në mënyrë të vazhdueshme, për të analizuar të dhënat dhe për të siguruar përfshirjen e çdo nxënësi. | | | | |
| | **2.2.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë mësuesit dhe prindërit, të zhvillojnë aktivitete të ndryshme që i përshtaten nevojave të nxënësve dhe që kontribuojnë në përmirësimin e angazhimit të tyre në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.2.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë rezultatet dhe ndikimin e metodave të mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative dhe rekomandojnë ndryshime ose | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | përmirësime në strategjitë e përdorura. | | | | |
| | **2.2.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë udhëzime dhe këshilla për mësuesit, në lidhje me përmbushjen e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative. | | | | |
| | **2.2.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin shkëmbimin e ideve dhe të praktikave mes mësuesve, për të siguruar se strategjitë e mësimdhënies janë të përshtatura për nevojat individuale të nxënësve. | | | | |
| | **2.2.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit të integrojnë teknologjinë dhe mjetet didaktike, për të mbështetur nxënësit në procesin e të nxënit dhe për t'i bërë mësimet më të përshtatshme për ata. | | | | |
| | **2.2.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit për implementimin e programeve të veçanta mbështetëse për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative, për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për suksese shkollore dhe sociale. | | | | |
| | **2.2.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përdorin instrumente të standardizuara, për të vlerësuar ecurinë e nxënësve në lidhje me metodat individuale të të nxënit dhe ndikimin e këtyre metodave në performancën shkollore dhe sociale. | | | | |
| | **2.2.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin në konsideratë informacionin e dhënë nga nxënësi dhe prindi mbi efektivitetin e strategjive dhe ndikimin e tyre në përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.2.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë ndikimin e ndërhyrjeve në dinamikën e mësimit dhe në adresimin e nevojave të nxënësve në klasë. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 2.2:** | | | | | | |
| **2.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë plane individuale ndërhyrjeje, për të mbështetur nxënësit për përmirësimin | **2.3.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social evidentojnë nevojat specifike të nxënësve në aspektet akademike dhe emocionale. | | | | |
| | **2.3.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë pyetësorë për vetëvlerësimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e nevojave në të nxënë dhe zhvillimin personal. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| e aftësive të tyre të të nxënit dhe zhvillimin personal. | **2.3.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë me prindërit, për të mbledhur opinione mbi fushat ku ata vërejnë nevoja ose sfida të veçanta te fëmijët e tyre. | | | | |
| | **2.3.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista të strukturuara me nxënësit, për të kuptuar vështirësitë dhe nevojat e veçanta të tyre. | | | | |
| | **2.3.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista dhe metoda të tjera vlerësuese me mësuesit, për të marrë informacion mbi vështirësitë dhe nevojat e nxënësve të tyre. | | | | |
| | **2.3.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë të dhëna mbi vështirësitë dhe arritjet e nxënësve, në funksion të vlerësimit të ecurisë së tyre. | | | | |
| | **2.3.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve gjatë mësimit, duke identifikuar fusha ku ata kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme. | | | | |
| | **2.3.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë mësuesit për përshtatjen e metodave të të nxënit me nevojat specifike të nxënësve. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **2.3.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teste të standardizuara, për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në fusha të caktuara dhe identifikimin e nevojave individuale. | | | | |
| | **2.3.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme, për të matur aftësitë socio-emocionale dhe nevojat për mbështetje në këto fusha. | | | | |
| | **2.3.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përcaktojnë fushat që kërkojnë ndërhyrje parësore, bazuar në nevojat e vlerësuara. | | | | |
| | **2.3.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përshkruajnë progresin e nxënësve, bazuar në hapat e ndjekur përgjatë ndërhyrjes. | | | | |
| | **2.3.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social dokumentojnë realizimin e objektivave të vendosur për nxënësit dhe vështirësitë specifike që ata hasin. | | | | |
| | **2.3.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë metoda vlerësuese, për të matur aftësinë e nxënësve në përballimin e sfidave shkollore ose emocionale dhe për të zbuluar fusha | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | që kërkojnë përmirësim. | | | | |
| | **2.3.15.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë nivelin e angazhimit dhe të motivimit të nxënësve, për të identifikuar nevojat e tyre për mbështetje shtesë. | | | | |
| | **2.3.16.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista me prindërit, për të mbledhur mendime mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe për të identifikuar nevoja të reja që mund të kenë lindur. | | | | |
| | **2.3.17.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë mendimet e tyre me nxënësit mbi përfitimet e ndërhyrjeve, për të përmirësuar planet e ndërhyrjeve. | | | | |
| | **2.3.18.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë metoda vlerësuese për të matur nivelin e vetëbesimit të nxënësve në të nxënë, i cili ndikon drejtpërdrejt në angazhimin dhe përparimin e tyre. | | | | |
| | **2.3.19.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin në konsideratë informacionin e dhënë nga mësuesi, mbi efektivitetit e ndërhyrjeve të përdorura dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e aftësive dhe të sjelljes | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | së nxënësve. | | | | |
| | **2.3.20.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë në vazhdimësi cilësinë dhe përputhshmërinë e planeve me nevojat e nxënësve. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 2.3:** | | | | | | |
| **2.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve. | **2.4.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda vlerësimi, si vëzhgime, intervista, listëkontrolli, për të identifikuar qëndrimin e nxënësve në zgjidhjen e problemeve. | | | | |
| | **2.4.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë tema që lidhen me aftësinë e nxënësve për të zgjidhur problemin përmes të menduarit kritik, duke ofruar mbështetje dhe udhëzime për zhvillimin e procesit të të menduarit kritik dhe strategjive të zgjidhjes së problemeve. | | | | |
| | **2.4.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë këshillime individuale ose në grup me nxënës, bazuar në rezultatet e vlerësimeve dhe të analizave të bëra për kapacitetin e nxënësve për të menduar dhe për të zgjidhur probleme. | | | | |
| | **2.4.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin strategji të përshtatshme | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe teknika vlerësimi për identifikimin e vështirësive dhe pikave të forta individuale. | | | | |
| | **2.4.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të ndryshme vlerësuese, si intervista me prindër dhe mësues për vlerësimin e aspektit socio-emocional të nxënësve, me qëllim përmirësimin e aftësive të nxënësve, për të menduar dhe për të zgjidhur problemet. | | | | |
| | **2.4.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit në zhvillimin e aftësive të nevojshme, për të komunikuar në mënyrë efektive, për të sintetizuar njohuritë dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe aplikimin e këtyre aftësive në situata jetësore. | | | | |
| | **2.4.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë këshillim dhe ndërhyrje në krizë, për të ndihmuar nxënësit të aftësohen në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve. | | | | |
| | **2.4.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë takime në grup, ku nxënësit nxiten të praktikojnë situata për zgjidhjen e problemeve, zhvillojnë të menduarit kritik, duke | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përdorur metoda, si diskutime në grup, lojë me role dhe aktivitete të tjera interaktive | | | | |
| | **2.4.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit të përdorin teknika për zgjidhjen e situatave dhe lojëra didaktike, për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve në kontekste reale. | | | | |
| | **2.4.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përshtatin ndërhyrjet individuale dhe në grup, për të përmirësuar aftësitë e nxënësve në të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, bazuar në nevojat dhe aftësitë e çdo nxënësi. | | | | |
| | **2.4.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë konsulta dhe këshillime me nxënësit, për t'i ndihmuar ata të njohin pikat e forta dhe dobësitë e tyre në lidhje me të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve. | | | | |
| | **2.4.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete me grupe nxënësish, me qëllim zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve te nxënësit, planifikuar sipas nevojave dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përshtatur sipas grupmoshës. | | | | |
| | **2.4.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje për zhvillimin e aftësive të nxënësve, për të reflektuar mbi përvojat e tyre mësimore dhe për të analizuar mënyrat, për të përmirësuar qasjet e tyre në të menduarin dhe zgjidhjen e problemeve. | | | | |
| | **2.4.14.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika vlerësimi për të identifikuar dhe për të ndihmuar nxënësit që kanë vështirësi në të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe zhvillojnë strategji për të mbështetur përparimin e tyre. | | | | |
| | **2.4.15.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në zbatimin e strategjive të të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në projekte dhe detyra individuale, duke përfshirë mbikëqyrjen dhe ofrimin e feedback-ut për përmirësim. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 2.4:** | | | | | | |
| **2.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin | **2.5.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë me nxënësit, për të vlerësuar perceptimin e tyre mbi mbështetjen e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| teknika dhe qasje të ndryshme që nxisin mësimin aktiv dhe bashkëpunues për nxënësit, duke rritur motivimin dhe përfshirjen e tyre në klasë. | | marrë nga mësuesit në motivimin dhe përfshirjen në klasë. | | | | |
| | **2.5.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë me nxënësit, për të kuptuar përvojat e tyre dhe ndikimin e ndërhyrjeve psiko-sociale në nxitjen e mësimit aktiv dhe bashkëpunues. | | | | |
| | **2.5.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit të përdorin teknika motivuese, për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë rëndësinë e mësimit dhe ndikimin e tij në zhvillimin personal dhe profesional të tyre. | | | | |
| | **2.5.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të vendosin qëllime konkrete dhe të arritshme, për t'i mbajtur ata të angazhuar dhe të motivuar gjatë gjithë procesit mësimor. | | | | |
| | **2.5.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete në grup me nxënësit, përmes situatave reale ose të simuluara, për të praktikuar bashkëpunimin dhe rritjen e aftësive sociale. | | | | |
| | **2.5.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë lojëra edukative, detyra | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | që kërkojnë zgjidhje të problemeve në grup apo aktivitete kreative që nxisin mendimin kritik. | | | | |
| | **2.5.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi të komunikimit dhe të bashkëpunimit, si dhe të praktikojnë empatinë për të kuptuar më mirë ndjenjat dhe perspektivat e të tjerëve. | | | | |
| | **2.5.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje individuale për nxënësit që hasin vështirësi, si në aspektin akademik, ashtu edhe në atë emocional. | | | | |
| | **2.5.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social punojnë individualisht me nxënësit, për të adresuar çështje specifike që mund të ndikojnë në angazhimin dhe motivimin e tyre, ose mund të organizojnë këshillim grupi, për të rritur vetëbesimin dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve. | | | | |
| | **2.5.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit si të integrojnë teknikat e të mësuarit aktiv dhe bashkëpunues gjatë procesit mësimor. | | | | |
| | **2.5.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndihmojnë mësuesit të realizojnë aktivitete që nxisin më shumë angazhim dhe përfshirje të nxënësve, dhe sugjerojnë mënyra të ndryshme për të inkurajuar nxënësit gjatë mësimit. | | | | |
| | **2.5.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social rekomandojnë ose përdorin platforma online, ku nxënësit mund të punojnë bashkërisht në projekte ose mund të përdorin aplikacione edukative, që i bëjnë ata të zhvillojnë aftësi të reja në një mënyrë më interaktive. | | | | |
| | **2.5.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për të krijuar projekte dhe aktivitete ndërdisiplinore, që ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi për të punuar në grupe dhe për të zgjidhur probleme komplekse. | | | | |
| | **2.5.14.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë vëzhgime në klasë, për të dokumentuar pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e nxënësve në aktivitete, për rastet për të cilat është kryer ndërhyrje. | | | | |
| | **2.5.15.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë në vijimësi ndikimin e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbështetjes psiko-sociale në angazhimin dhe progresin e nxënësve. | | | | |
| | **2.5.16.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë grupe diskutimi me nxënësit, për të vlerësuar mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe motivimin e krijuar. | | | | |
| | **2.5.17.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë ose intervista me mësuesit dhe prindërit, për të marrë mendimet e tyre mbi ndryshimet në motivimin dhe përfshirjen e fëmijëve të tyre në shkollë. | | | | |
| | **2.5.18.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin informacion nga mësuesit për efektivitetin e teknikave kreative dhe bashkëpunuese të zbatuara nga ata. | | | | |
| | **2.5.19.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë për efektet që ka pasur në përmirësimin e performancës së nxënësve, bashkëpunimi ndërmjet shërbimit psiko-social, mësuesve dhe prindërve. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 2.5:** | | | | | | |
| **Vlerësimi i fushës 2: (T1+T2+T3+T4+T5)/5** | | | | | | |
| **Fusha e cilësisë 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale** | | | | | | |
| **3.1.** Punonjësit | **3.1.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve, për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi. | | fillojnë çdo bisedë duke përshëndetur me ton të ngrohtë dhe miqësor, për të krijuar një atmosferë të rehatshme dhe mirëpritëse për palët. | | | | |
| | **3.1.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin gjuhë të thjeshtë dhe të qartë për të shpjeguar çështje psiko-sociale me terma të lehtë për t'u kuptuar, duke shmangur përdorimin e fjalëve teknike të komplikuara. | | | | |
| | **3.1.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ushtrojnë veprimtarinë në një mjedis ku nxënësit ndihen të sigurt për të shprehur ndjenjat dhe shqetësimet e tyre pa frikë nga gjykimi. | | | | |
| | **3.1.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përshtatin mënyrën e komunikimit sipas moshës dhe nivelit të të kuptuarit të nxënësve. | | | | |
| | **3.1.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social në fund të çdo takimi, përmbledhin pikat kryesore të bisedës për të siguruar komunikim efektiv. | | | | |
| | **3.1.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social, reagojnë me ndjeshmëri dhe empati ndaj shqetësimeve të nxënësve, duke treguar mirëkuptim, përkushtim dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbështetje. | | | | |
| | 3.1.7. | Punonjësit e shërbimit psiko-social i kushtojnë vëmendje të plotë secilës palë, duke dëgjuar pa ndërprerje dhe duke treguar respekt për mendimet dhe ndjenjat e tyre. | | | | |
| | 3.1.8. | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin gjuhë pozitive për të motivuar nxënësit, për të krijuar besim, duke inkurajuar dhe duke nxitur vetëbesimin e tyre, për t'i frymëzuar ata të arrijnë qëllimet e vendosura. | | | | |
| | 3.1.9. | Punonjësit e shërbimit psiko-social shpjegojnë me qartësi të plotë hapat që duhet të ndiqen, duke siguruar që të gjitha palët të kenë udhëzime të qarta për veprimet e mëtejshme. | | | | |
| | 3.1.10. | Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë privatësinë e informacionit të ndarë dhe sigurojnë që çdo komunikim të trajtohet në përputhje me standardet e etikës profesionale. | | | | |
| | 3.1.11. | Punonjësit e shërbimit psiko-social prezantojnë rregullat dhe udhëzimet e shkollës në mënyrë të kuptueshme dhe të saktë, duke ndihmuar nxënësit dhe prindërit të ndihen të informuar | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe të mbështetur. | | | | |
| | **3.1.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një atmosferë bashkëpunimi, duke nxitur palët të punojnë së bashku për arritjen e zgjidhjeve të përbashkëta. | | | | |
| | **3.1.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social shmangin përdorimin e gjuhës kritikuese ose të ngarkuar emocionalisht, duke shmangur çdo koment që mund të perceptohet si kritikë apo akuzë. | | | | |
| | **3.1.14.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social planifikojnë dhe organizojnë takime në mënyrë efektive, duke konsideruar kohën dhe mundësinë e të gjitha palëve, duke e bërë komunikimin efikas dhe produktiv. | | | | |
| | **3.1.15.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ftojnë të gjitha palët të kontribuojnë në diskutime, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të konsiderohet në vendimmarrje. | | | | |
| | **3.1.16.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë qetësinë dhe profesionalizmin në situata të tensionuara, duke menaxhuar emocionet personale, për të ruajtur | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | një komunikim konstruktiv. | | | | |
| | **3.1.17.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë pjesëmarrjen e nxënësve dhe të prindërve në procesin e vendimmarrjes, për të ndërtuar mirëkuptim dhe për të rritur përgjegjësinë e përbashkët. | | | | |
| | **3.1.18.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të gjitha pikëpamjet e ndryshme të shprehura në diskutime, duke qëndruar neutral dhe profesional në ndërveprime. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.1:** | | | | | | |
| **3.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykime të gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe te nevojat e tyre për të ofruar mbështetje të | **3.2.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurohen që nxënësit të kenë mundësinë të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre pa ndërprerje, duke i dhënë hapësirën e nevojshme për të komunikuar lirshëm dhe pa frikë. | | | | |
| | **3.2.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të dëgjimit aktiv (si shprehje të fytyrës dhe sinjale joverbale), për të treguar se është plotësisht i angazhuar dhe i fokusuar në fjalët dhe emocionet e nxënësit. | | | | |
| | **3.2.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin pyetje të hapura, duke i | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| përshtatshme dhe efektive. | | dhënë mundësinë nxënësit të shpjegojë ndjenjat dhe mendimet e tij në një mënyrë më të thellë. | | | | |
| | **3.2.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social shprehin empati dhe mbështetje për ndjenjat e nxënësit, duke përdorur fraza që tregojnë se e kupton dhe e vlerëson emocionin e tij. | | | | |
| | **3.2.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të vëmendshëm ndaj shprehjeve të fytyrës dhe gjuhës së trupit të nxënësit, për të zbuluar ndjenja apo emocione që mund të jenë të fshehura, si ankthi, frika ose pasiguria. | | | | |
| | **3.2.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë shënime të detajuara gjatë bisedave me nxënësit, duke u fokusuar te çështjet dhe shqetësimet kryesore, për të siguruar që asnjë informacion i rëndësishëm nuk humbet dhe mund të përdoret për mbështetje të mëtejshme. | | | | |
| | **3.2.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë çdo shqetësim me seriozitet dhe përkushtim të plotë, duke siguruar që çdo situatë trajtohet me respekt dhe përgjegjshmëri. | | | | |
| | **3.2.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të artikulojnë më qartë ndjenjat e tyre, duke përdorur pyetje udhëzuese dhe mbështetje, për të ndihmuar në shprehjen emocionale. | | | | |
| | **3.2.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social u krijojnë mundësi nxënësve për të shpjeguar shqetësimet e tyre, duke i inkurajuar të shprehin mendimet e ndjenjat e tyre dhe duke u dhënë kohën e nevojshme. | | | | |
| | **3.2.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin riformulimin, për t'u siguruar që ka kuptuar saktësisht informacionin që ka dhënë nxënësi dhe për të shmangur keqkuptimet që mund të ndodhin. | | | | |
| | **3.2.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë nxënësit drejt mundësive për zgjidhjen e shqetësimeve të tyre, duke i ndihmuar të fokusohen te zgjidhjet praktike dhe pozitive për problemet që mund të hasin. | | | | |
| | **3.2.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që çdo vendim dhe ndërhyrje të bëhet duke pasur prioritet nevojat dhe interesat e nxënësve. | | | | |
| | **3.2.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ofrojnë mbështetje për nxënësit në procesin e vendimmarrjes, duke i udhëzuar dhe duke i ndihmuar të marrin vendime të informuara për situatat që ata përjetojnë. | | | | |
| | **3.2.14.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të ndjeshëm ndaj përjetimeve të nxënësve mbi ndryshimet kulturore, sociale dhe emocionale, duke qenë të hapur dhe të kujdesshëm, për të kuptuar dhe për të mbështetur këto ndryshime në mënyrë të përshtatshme. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.2:** | | | | | | |
| **3.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të hapur, të drejtë dhe të barabartë ndaj të gjithë nxënësve, prindërve dhe stafit, duke shmangur çdo lloj favorizimi, diskriminimi ose paragjykimi. | **3.3.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë qëndrim të barabartë ndaj çdo nxënësi, duke i trajtuar pa dallim, pavarësisht nga pozita sociale, etnia, statusi ekonomik etj. | | | | |
| | **3.3.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social shmangin gjuhën që mund të krijojë paragjykime apo mund të përforcojë stereotipe, duke siguruar që të gjitha palët të ndihen të barabarta dhe të respektohet çdo diferencë. | | | | |
| | **3.3.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të ngrohtë dhe miqësor, ku çdo nxënës ndihet i mirëpritur dhe i përfshirë, duke | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | krijuar mundësi për bashkëpunim dhe integrim të të gjithë nxënësve. | | | | |
| | **3.3.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë diversitetin kulturor, social dhe emocional të nxënësve, duke vlerësuar kultura, besime, përvojat e ndryshme të nxënësve dhe duke promovuar respektin për këto dallime. | | | | |
| | **3.3.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social i kushtojnë të njëjtën vëmendje dhe përkushtim të gjitha kërkesave të nxënësve dhe prindërve, pa bërë dallime, duke siguruar që çdo kërkesë të trajtohet me seriozitet dhe profesionalizëm. | | | | |
| | **3.3.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social shmangin praktikat që mund të favorizojnë nxënësit për shkak të marrëdhënieve personale, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit. | | | | |
| | **3.3.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që të gjitha procedurat e mbështetjes së nxënësve të jenë të qarta dhe të disponueshme për të gjithë, pa diskriminim ndaj grupeve të caktuara. | | | | |
| | **3.3.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përfshijnë nxënësit me nevoja të veçanta në aktivitete shkollore dhe sociale, duke u dhënë mundësi të barabarta për zhvillim dhe integrim. | | | | |
| | **3.3.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë çdo ankesë apo shqetësim në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke siguruar një qasje të ekuilibruar dhe profesionale në çdo situatë. | | | | |
| | **3.3.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me nxënësit, prindërit dhe stafit e shkollës, duke promovuar një atmosferë respekti dhe ndihme të ndërsjellë. | | | | |
| | **3.3.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtat e nxënësve, privatësinë dhe konfidencialitetin, për çdo informacion të ndjeshëm që mund të ndahet gjatë ofrimit të mbështetjes psiko-sociale. | | | | |
| | **3.3.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi për nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, që të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre pa pasur frikë nga gjykimi. | | | | |
| | **3.3.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje individuale për nxënësit, duke përshtatur shërbimet | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për të përmbushur nevojat e tyre specifike, pa diskriminim. | | | | |
| | **3.3.14.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për nxënësit që përballen me diskriminimin ose padrejtësitë, duke i ndihmuar ata t'i adresojnë dhe të përballen me situatat e tilla. | | | | |
| | **3.3.15.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që të gjitha politikat e shkollës dhe praktikat mbështetëse të jenë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke promovuar barazinë dhe mundësitë për të gjithë nxënësit. | | | | |
| | **3.3.16.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë me veprimtari të ndryshme, barazinë gjinore dhe mbështetje të barabartë për të gjithë nxënësit. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.3:** | | | | | | |
| **3.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe metoda të strukturuara | **3.4.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin të dhëna nga të gjitha palët e përfshira në konflikt, duke bërë pyetje të qarta dhe neutrale, për të kuptuar burimin dhe shkaqet e konfliktit. | | | | |
| | **3.4.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| dhe efektive, për të trajtuar konfliktet dhe situatat e ndjeshme, duke siguruar një zgjidhje që respekton të drejtat dhe ndjenjat e të gjitha palëve. | | dëgjojnë me vëmendje personat e përfshirë, duke i lënë të shprehin plotësisht mendimet dhe ndjenjat e tyre pa ndërhyrje. | | | | |
| | **3.4.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social propozojnë alternativa të ndryshme për zgjidhjen e konfliktit, duke u siguruar që të jenë të pranueshme për të gjitha palët. | | | | |
| | **3.4.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë një mjedis të qetë dhe neutral, ku të gjithë ndihen të lirë për të diskutuar dhe për të dhënë mendimet e tyre. | | | | |
| | **3.4.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika ndërmjetësimi për të mundësuar pajtimin e palëve, si ndarja e përgjegjësive apo bashkëpunimi, duke orientuar në një zgjidhje të drejtë dhe të kënaqshme. | | | | |
| | **3.4.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ruajnë një qëndrim neutral dhe të drejtë gjatë trajtimit të konflikteve, duke shmangur çdo lloj favorizimi apo anësie. | | | | |
| | **3.4.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë raste pozitive nga përvoja, për t'u treguar nxënësve mënyra efektive dhe të shëndetshme në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | trajtimin e mosmarrëveshjeve. | | | | |
| | **3.4.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë prindërit për mënyrën e menaxhimit të konflikteve dhe i përfshijnë ata si partnerë në procesin e zgjidhjes. | | | | |
| | **3.4.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social tregojnë kujdes të veçantë ndaj emocioneve të palëve të përfshira, duke përdorur një qasje që respekton ndjenjat dhe përvojat e tyre. | | | | |
| | **3.4.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë thellë shkaqet kryesore të konfliktit, për të krijuar strategji parandalimi në të ardhmen. | | | | |
| | **3.4.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë nxënësit të propozojnë strategji të thjeshta dhe praktike për parandalimin dhe zgjidhjen e situatave të ngjashme në të ardhmen, duke nxitur mendimin kritik dhe përfshirjen. | | | | |
| | **3.4.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë një plan konkret veprimi pas zgjidhjes së konfliktit, për hapat që duhet të ndjekin të gjitha palët për të zbatuar zgjidhjen. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **3.4.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë dinamikën midis palëve pas zgjidhjes së konfliktit, për të garantuar që marrëdhëniet janë përmirësuar dhe që zgjidhja ka qenë efektive. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.4:** | | | | | |
| **3.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuara për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm | **3.5.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë takime të rregullta me nxënësit, prindërit dhe stafit e shkollës, për të diskutuar çdo shqetësim, sfidë apo problem që mund të lindë, dhe për të shqyrtuar mundësitë e zgjidhjeve të përbashkëta që kontribuojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve. | | | | |
| | **3.5.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete të përbashkëta, për të forcuar bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërmjet nxënësve, stafit dhe prindërve, duke krijuar mundësi për të ndarë eksperienca dhe për të përmirësuar marrëdhëniet ndërpersonale. | | | | |
| | **3.5.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin nxënësit të ndajnë përvoja të mira dhe arritjet pozitive mes tyre dhe me të tjerët, për të krijuar një mjedis, ku mund të ndërtohet | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| shkollor. | | mirëkuptimi dhe respekti reciprok mes grupeve të ndryshme në shkollë. | | | | |
| | **3.5.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, për të punuar së bashku dhe për të mbështetur marrëdhëniet ndërmjet tyre. | | | | |
| | **3.5.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë grupe diskutimi me nxënësit, ku ata mund të flasin dhe të diskutojnë për tema që lidhen me marrëdhëniet ndërpersonale, si miqësia, bashkëpunimi dhe respekti, për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale. | | | | |
| | **3.5.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete socio-emocionale dhe lojëra në grup, që inkurajojnë nxënësit dhe stafin të punojnë së bashku dhe të ndërtojnë bashkëpunim dhe marrëdhënie më të forta. | | | | |
| | **3.5.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit, për të krijuar një model të sjelljes pozitive, që nxënësit mund të ndjekin, për të ndihmuar në zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale të shëndetshme. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **3.5.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë udhëzime dhe këshilla për prindërit, duke i ndihmuar ata të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të mbështesin zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve të tyre. | | | | |
| | **3.5.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda dhe teknika efektive, për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet nxënësve dhe stafit, duke i ndihmuar të ndërtojnë një komunikim të hapur dhe me respekt. | | | | |
| | **3.5.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë trajnime për nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi dhe teknika për ndërtimin e komunikimit të hapur dhe të shëndetshëm mes tyre, duke kontribuar në marrëdhëniet më të mira shkollore dhe familjare. | | | | |
| | **3.5.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë nxënësit të zhvillojnë ndjeshmëri dhe të tregojnë respekt ndaj ndjenjave dhe nevojave të bashkëmoshatarëve dhe stafit, duke i mësuar ata të vlerësojnë diversitetin dhe të përfshijnë të tjerët në | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | aktivitetet shkollore. | | | | |
| | **3.5.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë një kulturë shkollore që mbështet dhe shpërblen sjelljen bashkëpunuese dhe të respektueshme, duke nxitur nxënësit dhe stafin të angazhohen në aktivitete dhe qëndrime pozitive që kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve ndërpersonale. | | | | |
| | **3.5.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërhyjnë për të ndihmuar në zgjidhjen e keqkuptimeve dhe tensioneve ndërmjet prindërve dhe stafit shkollor me teknika ndërmjetësimi, për të siguruar një komunikim të hapur dhe konstruktiv. | | | | |
| | **3.5.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë në vijimësi marrëdhëniet ndërpersonale ndërmjet nxënësve, stafit dhe prindërve, për të siguruar që të gjitha palët të ndihen të mbështetura dhe të kenë mundësi përmirësimi në marrëdhëniet e tyre, me mbështetje të vazhdueshme. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.5:** | | | | | |
| **Vlerësimi i fushës 3: (T1+T2+T3+T4+T5)/5** | | | | | |
| **Fusha e cilësisë 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin** | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **4.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social komunikojnë në vijimësi me familjet dhe komunitetin në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse. | **4.1.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë takime periodike me prindërit/kujdestarët ligjorë, për të diskutuar progresin dhe mirëqenien e fëmijëve, për të vlerësuar nevojat psiko-sociale dhe për të përcaktuar qëllimet e përbashkëta. | | | | |
| | **4.1.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përshtatin qasjen e komunikimit në përputhje me kulturën dhe nivelin e njohurive të çdo familjeje, duke siguruar që informacioni të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë. | | | | |
| | **4.1.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë në vijimësi prindërit/kujdestarët ligjorë për aktivitetet, ndërhyrjet dhe progresin e bërë nga nxënësit, duke siguruar transparencë të plotë për familjet. | | | | |
| | **4.1.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë familjet për qasjet dhe metodat e përdorura në ndërhyrjet psiko-sociale të nxënësve, duke shpjeguar ndikimin e tyre në mirëqenien së fëmijës. | | | | |
| | **4.1.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë familjet për strategjitë dhe aktivitetet që familjet mund të përdorin në kontekstin familjar, për | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të mbështetur progresin psiko-social të fëmijës. | | | | |
| | **4.1.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social këshillojnë dhe mbështesin familjet për të kuptuar dhe për të përballuar sfidat psiko-sociale. | | | | |
| | **4.1.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të qartë dhe të hapur në dhënien e informacioneve, për qëllimet, proceset dhe rezultatet e ndërhyrjes psiko-sociale me familjen dhe komunitetin. | | | | |
| | **4.1.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të hapur ndaj pyetjeve dhe shqetësimeve të familjarëve dhe të anëtarëve të komunitetit. | | | | |
| | **4.1.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë rezultatet e ndërhyrjeve psiko-sociale me prindërit, duke treguar se cilat janë përmirësimet dhe sfidat e vazhdueshme. | | | | |
| | **4.1.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin komente dhe sugjerime nga familjet për përmirësimin e shërbimeve dhe për t'u siguruar që ndërhyrjet janë në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre. | | | | |
| | **4.1.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | sigurojnë respektimin e privatësisë së familjeve dhe të nxënësve gjatë ndarjes së informacionit, duke i dhënë rëndësi të veçantë konfidencialitetit. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 4.1:** | | | | | |
| **4.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime dhe sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve. | **4.2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë seanca ndërgjegjësuese me prindërit për rëndësinë e shëndetit mendor dhe ndikimin e tij në sjelljen dhe suksesin e fëmijëve. | | | | |
| | **4.2.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë me prindërit ndikimin e stresit shkollor, ankthit, depresionit, bullizmit etj., në mirëqenien e fëmijëve. | | | | |
| | **4.2.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë prindërit për menaxhimin e sjelljeve të fëmijëve, duke i trajnuar mbi teknikat për të menaxhuar dhe për t'u përballur me situata të vështira në mënyrë konstruktive. | | | | |
| | **4.2.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë prindërit për strategji të ndryshme, për ndërtimin e një mjedisi familjar që mbështet zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve, si dhe për zgjidhjen e konflikteve. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **4.2.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë prindërit për krijimin e një mjedisi mbështetës që nxit të nxënit dhe zhvillimin e aftësive jetësore. | | | | |
| | **4.2.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social u japin udhëzime prindërve, për të forcuar marrëdhëniet prind-fëmijë dhe për të ndërtuar vetëbesimin te fëmijët. | | | | |
| | **4.2.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë takime me prindër në mjediset e shkollës, për të diskutuar në mënyrë interaktive me shembuj praktikë dhe situate reale. | | | | |
| | **4.2.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin platforma virtuale, për të përfshirë edhe prindërit që nuk mund të marrin pjesë fizikisht, me prezantime multimediale dhe seanca pyetje-përgjigje. | | | | |
| | **4.2.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë prindërit përmes broshurave dhe udhëzuesve të thjeshtë, mbi tema specifike, video ose infografikë, për ta bërë përmbajtjen më të kuptueshme dhe të lehtë për t'u zbatuar. | | | | |
| | **4.2.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë këshillime individuale për | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | raste të veçanta, bazuar në nevojat specifike të familjeve. | | | | |
| | **4.2.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social u japin prindërve udhëzime për identifikimin e shenjave të bullizmit dhe trajtimin e tij. | | | | |
| | **4.2.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë prindërit me strategji praktike për fëmijët, në përballimin e stresit shkollor dhe social. | | | | |
| | **4.2.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë familjet, që fëmijët të përdorin teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 4.3:** | | | | | | |
| **4.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë diversitetin e familjeve dhe të komunitetit si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për | **4.3.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione rreth burimeve të komunitetit që janë të rëndësishme për familjet dhe zhvillimin e nxënësve. | | | | |
| | **4.3.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktiviteteve që synojnë edukimin e nxënësit, të mësuesit dhe të prindërit, mbi rëndësinë e respektimit dhe të vlerësimit të kulturave dhe të identiteteve të ndryshme. | | | | |
| | **4.3.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës. | trajnojnë stafin, për t'i ndihmuar të jenë të ndjeshëm ndaj diversitetit kulturor, ekonomik, gjinor apo të identiteteve të tjera të nxënësve dhe të familjeve. | | | | |
| | **4.3.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjithë aktorët e shkollës, për krijimin e materialeve edukative që reflektojnë një shumëllojshmëri identitetesh dhe kulturash, duke normalizuar kështu, diversitetin dhe duke e konsideruar atë një pjesë natyrale të mjedisit të shkollës. | | | | |
| | **4.3.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjitha familjet, pavarësisht prejardhjes së tyre kulturore, etnike, gjuhësore dhe shoqërore. | | | | |
| | **4.3.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe edukimin e diversitetit, si dhe për të sfiduar dhe për të trajtuar stereotipet. | | | | |
| | **4.3.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin e shkollës, nxënësit, prindërit dhe me komunitetin, për organizimin e veprimtarive që lidhen me njohjen e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kulturës, së traditave dhe të zakoneve krahinore. | | | | |
| | **4.3.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis përfshirës dhe mbështetës për nxënësit nga familje dhe prejardhje të ndryshme, për t'u ndjerë pjesë e shkollës dhe për të pasur hapësira ku mund të ndajnë përvojat e tyre unike. | | | | |
| | **4.3.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë diskutime të hapura me nxënësit, për të nxitur dialogun mes tyre dhe për të ndarë përvojat e tyre, duke theksuar vlerën e diversitetit kulturor dhe familjar, si një pasuri për shkollën. | | | | |
| | **4.3.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë familjet nga kultura të ndryshme, për të kontribuar në jetën e shkollës, duke marrë pjesë në aktivitete, festa, takime, për të promovuar një atmosferë harmonie ndërkulturore. | | | | |
| | **4.3.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë projekte, nisma vullnetare, që përfshijnë nxënës, prindër dhe anëtarë të komunitetit, stafin e shkollës, në funksion të promovimit të solidaritetit ndërmjet | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nxënësve nga familje të ndryshme. | | | | |
| | **4.3.12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë takime ndërgjegjësuese me të gjithë aktorët e shkollës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të qarta kundër diskriminimit dhe bullizmit, në lidhje me përkatësinë etnike, kulturore, racore ose sociale të nxënësve dhe të familjeve. | | | | |
| | **4.3.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjithë aktorët e shkollës, për të përfshirë të gjithë nxënësit në aktivitet e shkollës, duke siguruar që të trajtohen me respekt. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 4.3:** | | | | | | |
| **4.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme, të besueshme dhe të ndershme me familjet dhe komunitetin, duke siguruar një mjedis të | **4.4.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë që mjedisi i shkollës të jetë një vend ku familjet ndihen të mirëpritura dhe ku të gjitha palët punojnë së bashku në interesin më të lartë të fëmijëve. | | | | |
| | **4.4.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi për përfshirjen aktive të prindërve dhe të komunitetit në aktivitetet shkollore. | | | | |
| | **4.4.3.** | Punonjësit psiko-social krijojnë mundësi për përfshirjen aktive të prindërve në vendimmarrjet që | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| sigurt dhe mbështetës, ku interesat e fëmijëve janë gjithmonë në qendër të vëmendjes. | | lidhen me mirëqenien e fëmijëve, duke promovuar një ndjenjë bashkëpunimi dhe përkatësie. | | | | |
| | **4.4.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë me familjet të gjitha informacionet mbi zhvillimin dhe mirëqenien e nxënësve, në mënyrë transparente dhe të qartë. | | | | |
| | **4.4.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis, ku prindërit ndihen të dëgjuar dhe të respektuar. | | | | |
| | **4.4.6.** | Familjet dhe komuniteti ndajnë lirshëm shqetësimet dhe nevojat e tyre me punonjësin e shërbimit psiko-social. | | | | |
| | **4.4.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë familjet, duke ofruar mbështetje në përshtatje me nevojat e tyre specifike. | | | | |
| | **4.4.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë me respekt dhe konfidencialitet informacionet e ndara me familjen dhe komunitetin, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm. | | | | |
| | **4.4.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë në krijimin e një ndjenje përkatësie dhe mbajtjes së lidhjeve | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | midis shkollës, familjes dhe komunitetit, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 4.4:** | | | | | |
| **Vlerësimi i fushës 4: (T1+T2+T3+T4)/4** | | | | | |
| **Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimit psiko-social: (F1+F2+F3+F4)/4** | | | | | |

# Formati i platformës së vlerësimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË**

Nr._____ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

## PLATFORMË VLERËSIMI

### A. QËLLIMI

Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit psiko-social në fushat “Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve”, “Procesi i të nxënit”, “Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale”, “Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin”, me qëllim sigurimin e mirëqenies psiko-emocionale, ndërtimin e aftësive ndërpersonale dhe promovimin e një klime pozitive në klasë dhe në shkollë.

### B. BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar".
- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022, "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar.
- Udhëzimi i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024, "Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar".
- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, "Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social".
- "Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor", ASCAP 2022
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-social Shkollor, ASCAP 2024.
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, ASCAP 2020.
- Udhëzuesi "Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës", ASCAP, 2020.
- "Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të shkollës", ASCAP, 2020.

## C. FREJTIMET E VLERËSIMIT

### FUSHA 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe të sjelljeve problematike**.**
- Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe individuale.

### FUSHA 2: Procesi i të nxënit

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në procesin mësimor dhe vetëbesimin në aftësitë e tyre në të nxënë.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe prindërit për të përshtatur strategjitë e të nxënit sipas nevojave individuale të nxënësve, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuara dhe nevoja veçanta.

**FUSHA 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale**

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykime të gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe te nevojat e tyre për të ofruar mbështetje të përshtatshme dhe efektive.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuara për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm shkollor.

**FUSHA 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime dhe sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë diversitetin e familjeve dhe të komunitetit si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës.

## D. METODOLOGJIA

- Takime me drejtues të shkollës, punonjësit e shërbimit psiko-social, mësues, nxënës dhe prindër;
- Studimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të shërbimit psiko-social;
- Vëzhgime të seancave ndërgjegjësuese të punonjësve të shërbimit psiko-social, seanca në grup.
- Analiza të vëzhgimeve;
- Zhvillimi i pyetësorëve, anketave, fokusgrupeve me nxënës, mësues dhe prindër;
- Takim përmbyllës me drejtorinë e shkollës dhe punonjësit e shërbimit psiko-social.

## E. INSTITUCIONI QË DO TË VLERËSOHET

- Institucionet arsimore sipas urdhrit bashkëlidhur.

## F. KOHA E REALIZIMIT TË VLERËSIMIT

- Koha e realizimit sipas urdhrit bashkëlidhur.

## G. PËRBËRJA E EKIPIT TË VLERËSIMIT

Përbërja e grupeve të vlerësimit sipas urdhrit bashkëlidhur.

## H. RAPORTI I VLERËSIMIT DO T'I DORËZOHET

- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit
- Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
- Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar
- Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, përkatëse
- Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, përkatëse
- Shkollës së vlerësuar.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**GERTI JANAQI**

## ANEKS:TREGUESIT E VLERËSIMIT

**Qëllimi**: Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit psiko-social në fushat "Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve", "Procesi i të nxënit", "Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale", "Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin", me qëllim sigurimin e mirëqenies psiko-emocionale, ndërtimin e aftësive ndërpersonale dhe promovimin e një klime pozitive në klasë dhe në shkollë.

**Shkolla** "____________" **ZVAP:** __________ **DRAP:** _____________

| **Fusha e cilësisë 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Treguesi i cilësisë** | **Përshkruesit praktikë** | **Nivelet e vlerësimit** | | | |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| **1.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe sjelljeve problematike. | **1.5.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda të ndryshme vlerësimi, si vëzhgimi, intervistimi, listëkontrolli etj., për vlerësimin e sjelljes së nxënësve. | | | | |
| | **1.5.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista individuale me nxënësit, për të kuptuar ndryshimet emocionale dhe sjellore. | | | | |
| | **1.5.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë, fokusgrupe, për të mbledhur të dhëna, në funksion të vlerësimit të sjelljes së nxënësve. | | | | |
| | **1.5.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë analizat periodike dhe vjetore të shkollës dhe raportet e stafit të shkollës, për të vlerësuar ndryshimet në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | sjellje. | | | | | |
| | **1.5.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të standardizuara (listëkontrolli, teste etj.), për identifikimin e problematikave emocionale të nxënësve. | | | | | |
| | **1.5.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë faktorët e jashtëm që ndikojnë në mirëqenien sociale dhe emocionale të nxënësve, nëpërmjet vëzhgimeve dhe komunikimit me nxënësit dhe familjet e tyre. | | | | | |
| | **1.5.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë fokusgrupin me nxënës, si metodë për të vlerësuar përfshirjen dhe angazhimit e tyre në jetën shkollore. | | | | | |
| | **1.5.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente vlerësimi për të matur nivelin e stresit te nxënësit. | | | | | |
| | **1.5.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë aftësitë e nxënësve, për të menaxhuar dhe për të zgjidhur konflikte dhe i ndihmojnë ata. | | | | | |
| | **1.5.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve gjatë veprimtarisë në mjediset e shkollës. | | | | | |
| | **1.5.11.** Punonjësit e shërbimit psiko- | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | social shqyrtojnë burime të dhënash nga shërbime të tjera, si terapi, mbështetje të jashtme etj., për të kuptuar më gjerë nevojat dhe ecurinë e nxënësve. | | | | |
| | **1.5.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të standardizuara, vetëraportuese, listëkontrolli, teste etj., për vlerësimin e vetëvlerësimit, vetëkontrollit dhe menaxhimin e emocioneve të nxënësve. | | | | |
| | **1.5.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të edukimit bashkëmoshatar (si grupet mbështetëse), për nxënësit me vështirësi sjellore dhe emocionale. | | | | |
| | **1.5.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin materiale edukative për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë dhe të menaxhojnë emocionet (libra, fletushka, aktivitete online etj.), për t'u mësuar nxënësve si të kuptojnë dhe të menaxhojnë emocionet e tyre. | | | | |
| | **1.5.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social referojnë për shërbime të specializuara (si vlerësim i thelluar, trajtim etj.), nxënësit të cilët manifestojnë vështirësi sjellore ose emocionale, kur vlerësojnë që ndërhyrjet brenda shkollës nuk janë të mjaftueshme. | | | | |

| Vlerësimi i treguesit 1.1.: | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht. | **1.6.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë ose fokusgrupe për të vlerësuar klimën në shkollë. | | | | |
| | **1.6.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve gjatë procesit mësimor, kur nevojitet vlerësim për planifikimin e ndërhyrjes. | | | | |
| | **1.6.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin pjesë në grupet e diskutimit dhe në organizimin e aktiviteteve që promovojnë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për nxënësit. | | | | |
| | **1.6.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë raportet e stafit të shkollës mbi sigurinë në shkollë. | | | | |
| | **1.6.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna, për të vlerësuar besimin dhe sigurinë e nxënësve në shkollë. | | | | |
| | **1.6.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social evidentojnë, vlerësojnë, ndërhyjnë dhe monitorojnë rastet e bullizmit dhe të dhunës. | | | | |
| | **1.6.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin masa të ofrojnë ose të referojnë për shërbime më të specializuara | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | nxënësit në nevojë për mbështetje sociale. | | | | |
| | **1.6.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna për të vlerësuar nivelin e stresit dhe të mirëqenies psiko-emocionale te nxënësit. | | | | |
| | **1.6.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna, për të vlerësuar nivelin e shqetësimeve që lidhen me shëndetin mendor (ankthin, depresionin etj.) të nxënësve. | | | | |
| | **1.6.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete dhe veprimtari praktike me nxënësit, me qëllim mësimin e aftësive të qëndrueshme, për të menaxhuar stresin dhe për të përballuar situatat sociale të vështira. | | | | |
| | **1.6.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë hapësira të dedikuara për mbështetjen emocionale të nxënësve. | | | | |
| | **1.6.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teknika të ndryshme ndërhyrjeje, për përmirësimin e sigurisë emocionale të nxënësve. | | | | |
| | **1.6.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit për integrimin në aktivitetet që promovojnë | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | zhvillimin social. | | | | |
| | **1.6.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit në situata që shkaktojnë pasiguri (kriza, emergjenca etj.). | | | | |
| | **1.6.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete trajnuese/informuese për mbështetjen e mësuesve dhe nxënësve dhe për ndihmën e parë psikologjike. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 1.2.:** | | | | | |
| **1.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe individuale. | **1.7.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë në bashkëpunim me mësuesit, nxënësit me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.7.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit lëndorë dhe ndihmës për hartimin e planeve individuale për nxënësit me aftësi të kufizuara. | | | | |
| | **1.7.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit lëndorë dhe ndihmës për hartimin e planeve individuale për nxënësit me nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.7.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit, për përshtatjen e mësimdhënies për nxënësit | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | me nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.7.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit, për vlerësimin e gjendjes së nxënësve me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta dhe ecurinë e tyre. | | | | |
| | **1.7.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me prindërit, për vlerësimin e gjendjes së nxënësve me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta dhe ecurinë e tyre. | | | | |
| | **1.7.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit, për angazhimin e nxënësve të tjerë në mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.7.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin e shkollës, për angazhimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta në aktivitete mësimore dhe sociale me qëllim integrimin e tyre në grup. | | | | |
| | **1.7.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të standardizuara, për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve individuale mbi performancën sociale dhe shkollore të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.7.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë në mënyrë periodike ndryshimet në sjellje dhe zhvillimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. | | | | |
| | **1.7.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika kreative, si lojërat ose artin, për të ndihmuar nxënësit të shprehin emocionet e tyre, duke ndihmuar që ata të rriten nga pikëpamja psiko-socio-emocionale. | | | | |
| | **1.7.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë drejtuesit e shkollës, mësuesit dhe prindërit për ecurinë e nxënësve, mbi zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale. | | | | |
| | **1.7.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta për të bashkëpunuar me specialistë të fushave përkatëse për përmbushjen e nevojat terapeutike, rehabilituese etj. | | | | |
| | **1.7.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë seanca informuese, trajnime me mësuesit mbi aftësinë e kufizuar dhe nevojat e veçanta te nxënësit. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **1.7.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orienton mësuesit, bazuar në analizën e funksioneve të sjelljes, në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për menaxhimin e sjelljes te nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta në klasë. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 1.3:** | | | | | |
| **Vlerësimi i fushës 1: (T1+T2+T3)/3** | | | | | |
| **Fusha 2: Procesi i të nxënit** | | | | | |
| **2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në procesin mësimor dhe vetëbesimin në aftësitë e tyre në të nxënë. | **2.1.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme, si: vëzhgime, intervista, pyetësorë dhe teste, për të identifikuar aftësitë dhe nevojat e nxënësve në të nxënë. | | | | |
| | **2.1.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme vlerësimi, për të ndihmuar nxënësit të reflektojnë mbi aftësitë e tyre dhe mundësitë për përmirësim. | | | | |
| | **2.1.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista individuale me nxënësit, për të kuptuar më mirë aftësitë e tyre, pasionet dhe interesat, të cilat mund të ndikojnë në përfshirjen e mëtejshme në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.1.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione nga prindërit, mësuesit dhe aktorë të tjerë të shkollës, | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për të krijuar një pamje më të plotë të aftësive dhe të potencialeve të nxënësve. | | | | | |
| | **2.1.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin në vijimësi të dhëna nga stafi i shkollës, për përfshirjen e nxënësve në veprimtari të ndryshme në klasë dhe jashtë saj, për të analizuar faktorët që ndikojnë në angazhimin ose jo të nxënësve. | | | | | |
| | **2.1.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teste të standardizuara për vlerësimin e aftësive të veçanta akademike të nxënësve, në funksion të hartimit të strategjive mbështetëse për përmirësimin e tyre. | | | | | |
| | **2.1.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë me prindërit për përfshirjen e nxënësve në veprimtari të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj, për të analizuar faktorët që ndikojnë në angazhimin ose jo të nxënësve dhe ndikimin e përfshirjes në aktivitete shkollore. | | | | | |
| | **2.1.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social, bashkëpunojnë me mësuesit për organizimin aktivitete me nxënësit me qëllim zhvillimin e aftësive të tyre. | | | | | |
| | **2.1.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë të dhënat e mbledhura në | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | lidhje me arritjet e nxënësve dhe përfshirjen e tyre në veprimtaritë në klasë e shkollë, për të orientuar mësuesit si të ofrojnë mbështetje ndaj nxënësve në fushat që kanë nevojë për përmirësim. | | | | |
| | **2.1.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social raportojnë në vijimësi te drejtuesit e shkollës dhe mësuesit mbi arritjet dhe vështirësitë e nxënësve brenda kufijve të konfidencialitetit. | | | | |
| | **2.1.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë plane individuale për nxënësit, me qëllim zhvillimin e aftësive dhe përmirësimin e angazhimit në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.1.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë sesione informuese, aktivitete sociale në grup me nxënësit për t'i ndihmuar në forcimin e vetëbesimit dhe përfshirjen në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.1.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë në vijimësi zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe vlerësojnë përparimin me qëllim përshtatjen e strategjive mbështetëse | | | | |
| | **2.1.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi që nxënësit të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre me qëllim përmirësimin e zhvillimin | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | e tyre shkollor dhe personal, duke krijuar mundësi për reflektim dhe vetëvlerësim. | | | | |
| | **2.1.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë raporte periodike mbi ndërhyrjet dhe rezultatet e tyre në arritjet e nxënësve bazuar në objektivat e planifikuara. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 2.1:** | | | | | |
| **2.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe prindërit për të përshtatur strategjitë e të nxënit sipas nevojave individuale të nxënësve, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuar dhe nevoja veçanta. | **2.2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë/ fokus grupe me mësuesit për të mbledhur mendime dhe sugjerime mbi mënyrën e përshtatjes së metodave të mësimdhënies, në përputhje me nevojat individuale të nxënësve dhe përfshirjen e nxënësve aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçanta edukative. | | | | |
| | **2.2.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione nga prindërit, për të kuptuar nevojat e veçanta të fëmijëve dhe për të siguruar që strategjitë e të nxënit të përshtaten me nevojat e tyre individuale. | | | | |
| | **2.2.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë mësimdhënien dhe punën e mësuesve, për të vlerësuar implementimin e strategjive individuale për nxënësit, duke identifikuar mundësitë për përmirësime dhe | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | përshtatje të mëtejshme të metodave. | | | | |
| | **2.2.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit në mënyrë të vazhdueshme për të analizuar të dhënat dhe për të siguruar përfshirjen e çdo nxënësi. | | | | |
| | **2.2.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë mësuesit dhe prindërit të zhvillojnë aktivitete të ndryshme që i përshtaten nevojave të nxënësve dhe që kontribuojnë në përmirësimin e angazhimit të tyre në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.2.6.** Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë rezultatet dhe ndikimin e metodave të mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçanta edukative dhe rekomandojnë ndryshime ose përmirësime në strategjitë e përdorura. | | | | |
| | **2.2.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë udhëzime dhe këshilla për mësuesit në lidhje me përmbushjen e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçanta edukative. | | | | |
| | **2.2.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin shkëmbimin e ideve dhe praktikave mes mësuesve për të siguruar se strategjitë e mësimdhënies janë të përshtatura për | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | nevojat individuale të nxënësve. | | | | |
| | **2.2.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit të integrojnë teknologjinë dhe mjetet didaktike për të mbështetur nxënësit në procesin e të nxënit dhe për t'i bërë mësimet më të përshtatshme për ata. | | | | |
| | **2.2.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit për implementimin e programeve të veçanta mbështetëse për nxënësit me aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçanta edukative, për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për suksese shkollore dhe sociale. | | | | |
| | **2.2.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të standardizuara për të vlerësuar ecurinë e nxënësve në lidhje me metodat individuale të të nxënit dhe ndikimin e këtyre metodave në performancën shkollore dhe sociale. | | | | |
| | **2.2.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin në konsideratë informacionin e dhënë nga nxënësi dhe prindi mbi efektivitetit e strategjive dhe ndikimin e tyre në përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve në procesin mësimor. | | | | |
| | **2.2.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë ndikimin e ndërhyrjeve në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dinamikën e mësimit dhe në adresimin e nevojave të nxënësve në klasë. | | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 2.2:** | | | | | | |
| **Vlerësimi i fushës 4: (T1+T2)/2** | | | | | | |
| **Fusha e cilësisë 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale** | | | | | | |
| **3.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi. | **3.1.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social fillon çdo bisedë duke përshëndetur me një ton të ngrohtë dhe miqësor për të krijuar një atmosferë të rehatshme dhe mirëpritëse për palët. | | | | | |
| | **3.1.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdor gjuhë të thjeshtë dhe të qartë për të shpjeguar çështje psiko-sociale me terma të lehtë për t'u kuptuar, duke shmangur përdorimin e fjalëve teknike të komplikuara. | | | | | |
| | **3.1.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ushtrojnë veprimtarinë në një mjedis ku nxënësit ndihen të sigurt për të shprehur ndjenjat dhe shqetësimet e tyre pa frikë nga gjykimi. | | | | | |
| | **3.1.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përshtasin mënyrën e komunikimit sipas moshës dhe nivelit të të kuptuarit të nxënësve. | | | | | |
| | **3.1.5.** Punonjësit e shërbimit psiko-social në fund të çdo takimi, përmbledhin pikat | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kryesore të bisedës për të siguruar komunikim efektiv. | | | | |
| | **3.1.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social, reagojnë me ndjeshmëri dhe empati ndaj shqetësimeve të nxënësve, duke treguar mirëkuptim, përkushtim dhe mbështetje. | | | | |
| | **3.1.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social, i kushtojnë vëmendje të plotë secilës palë, duke dëgjuar pa ndërprerje dhe duke treguar respekt për mendimet dhe ndjenjat e tyre. | | | | |
| | **3.1.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social, përdorin gjuhë pozitive për të motivuar nxënësit, për të krijuar besim, duke inkurajuar dhe nxitur vetëbesimin e tyre dhe për t'i frymëzuar ata të arrijnë qëllimet e vendosura. | | | | |
| | **3.1.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social shpjegojnë me qartësi të plotë hapat që duhet të ndiqen, duke siguruar që të gjitha palët të kenë udhëzime të qarta për veprimet e mëtejshme. | | | | |
| | **3.1.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social, respektojnë privatësinë e informacionit të ndarë dhe sigurojnë që çdo komunikim të trajtohet në përputhje me standardet e etikës profesionale. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **3.1.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social, prezantojnë rregullat dhe udhëzimet e shkollës në mënyrë të kuptueshme dhe të saktë, duke ndihmuar nxënësit dhe prindërit të ndihen të informuar dhe të mbështetur. | | | | |
| | **3.1.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një atmosferë bashkëpunimi duke nxitur palët të punojnë së bashku për arritjen e zgjidhjeve të përbashkëta. | | | | |
| | **3.1.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social shmangin përdorimin e gjuhës kritikuese ose të ngarkuar emocionalisht, duke shmangur çdo koment që mund të perceptohet si kritikë apo akuzë. | | | | |
| | **3.1.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social planifikojnë dhe organizojnë takime në mënyrë efektive duke konsideruar kohën dhe mundësinë e të gjitha palëve, duke e bërë komunikimin efikas dhe produktiv. | | | | |
| | **3.1.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ftojnë të gjitha palët të kontribuojnë në diskutime, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të konsiderohet në vendimmarrje. | | | | |
| | **3.1.16.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë qetësinë dhe profesionalizmin | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në situata të tensionuara, duke menaxhuar emocionet personale për të ruajtur një komunikim konstruktiv. | | | | |
| | **3.1.17.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë pjesëmarrjen e nxënësve dhe prindërve në procesin e vendimmarrjes për të ndërtuar mirëkuptim dhe për të rritur përgjegjësinë e përbashkët. | | | | |
| | **3.1.18.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të gjitha pikëpamjet e ndryshme të shprehura në diskutime, duke qëndruar neutral dhe profesional në ndërveprime. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.1:** | | | | | | |
| **3.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykime të gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe te nevojat e tyre për të ofruar | **3.2.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurohen që nxënësit të kenë mundësinë të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre pa ndërprerje, duke i dhënë hapësirën e nevojshme për të komunikuar lirshëm dhe pa frikë. | | | | |
| | **3.2.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të dëgjimit aktiv (si shprehje të fytyrës dhe sinjale joverbale), për të treguar se është plotësisht i angazhuar dhe i fokusuar në fjalët dhe emocionet e nxënësit. | | | | |
| | **3.2.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| mbështetje të përshtatshme dhe efektive. | | përdorin pyetje të hapura duke i dhënë mundësinë nxënësit të shpjegojë ndjenjat dhe mendimet e tij në një mënyrë më të thellë. | | | | |
| | **3.2.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social shprehin empati dhe mbështetje për ndjenjat e nxënësit, duke përdorur fraza që tregojnë se e kupton dhe e vlerëson emocionin e tij. | | | | |
| | **3.2.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të vëmendshëm ndaj shprehjeve të fytyrës dhe gjuhës së trupit të nxënësit për të zbuluar ndjenja apo emocione që mund të jenë të fshehura, si ankthi, frika ose pasiguria. | | | | |
| | **3.2.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë shënime të detajuara gjatë bisedave me nxënësit, duke u fokusuar te çështjet dhe shqetësimet kryesore për të siguruar që asnjë informacion i rëndësishëm nuk humbet dhe mund të përdoret për mbështetje të mëtejshme. | | | | |
| | **3.2.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë çdo shqetësim me seriozitet dhe përkushtim të plotë, duke siguruar që çdo situatë trajtohet me respekt dhe përgjegjshmëri. | | | | |
| | **3.2.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | artikulojnë më qartë ndjenjat e tyre, duke përdorur pyetje udhëzuese dhe mbështetje për të ndihmuar në shprehjen emocionale. | | | | |
| | **3.2.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social u krijojnë mundësi nxënësve për të shpjeguar shqetësimet e tyre, duke i inkurajuar të shprehin mendimet e ndjenjat e tyre dhe duke dhënë kohën e nevojshme. | | | | |
| | **3.2.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin riformulimin për t'u siguruar që ka kuptuar saktësisht informacionin që ka dhënë nxënësi, dhe për të shmangur keqkuptimet që mund të ndodhin. | | | | |
| | **3.2.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë nxënësit drejt mundësive për zgjidhjen e shqetësimeve të tyre, duke i ndihmuar të fokusohen te zgjidhjet praktike dhe pozitive për problemet që mund të hasin. | | | | |
| | **3.2.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që çdo vendim dhe ndërhyrje të bëhet duke pasur prioritet nevojat dhe interesin më të lartë të nxënësve. | | | | |
| | **3.2.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje për nxënësit në procesin e vendimmarrjes, duke i | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | udhëzuar dhe ndihmuar të marrin vendime të informuara për situatat që ata përjetojnë. | | | | | |
| | **3.2.14.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të ndjeshëm ndaj përjetimeve të nxënësve mbi ndryshimet kulturore, sociale dhe emocionale, duke qenë të hapur dhe të kujdesshëm për të kuptuar dhe mbështetur këto ndryshime në mënyrë të përshtatshme. | | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.2:** | | | | | | | |
| **3.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuara për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të | **3.3.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë takime të rregullta me nxënësit, prindërit dhe stafit e shkollës për të diskutuar çdo shqetësim, sfidë apo problem që mund të lindë dhe për të shqyrtuar mundësitë e zgjidhjeve të përbashkëta që kontribuojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve. | | | | | |
| | **3.3.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete të përbashkëta, për të forcuar bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërmjet nxënësve, stafit dhe prindërve, duke krijuar mundësi për të ndarë eksperienca dhe për të përmirësuar marrëdhëniet ndërpersonale. | | | | | |
| | **3.3.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| shëndetshëm shkollor. | | nxisin nxënësit të ndajnë përvoja të mira dhe arritjet pozitive mes tyre dhe me të tjerët, për të krijuar një mjedis, ku mund të ndërtohet mirëkuptimi dhe respekti reciprok mes grupeve të ndryshme në shkollë. | | | | |
| | **3.3.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, për të punuar së bashku dhe për të mbështetur marrëdhëniet ndërmjet tyre. | | | | |
| | **3.3.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë grupe diskutimi me nxënësit, ku ata mund të flasin dhe të diskutojnë për tema që lidhen me marrëdhëniet ndërpersonale, si miqësia, bashkëpunimi dhe respekti, për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale. | | | | |
| | **3.3.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete socio-emocionale dhe lojëra në grup, që inkurajojnë nxënësit dhe stafin të punojnë së bashku dhe të ndërtojnë bashkëpunim dhe marrëdhënie më të forta. | | | | |
| | **3.3.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për të krijuar një model të sjelljes pozitive, që nxënësit mund të ndjekin për të | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndihmuar në zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale të shëndetshme. | | | | | |
| | **3.3.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë udhëzime dhe këshilla për prindërit, duke i ndihmuar ata të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të mbështesin zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve të tyre. | | | | | |
| | **3.3.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda dhe teknika efektive për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet nxënësve dhe stafit, duke i ndihmuar të ndërtojnë një komunikim të hapur dhe me respekt. | | | | | |
| | **3.3.10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë trajnime për nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi dhe teknika për ndërtimin e komunikimit të hapur dhe të shëndetshëm mes tyre, duke kontribuar në marrëdhëniet më të mira shkollore dhe familjare. | | | | | |
| | **3.3.11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë nxënësit të zhvillojnë ndjeshmëri dhe të tregojnë respekt ndaj ndjenjave dhe nevojave të bashkëmoshatarëve dhe stafit, duke i mësuar ata të vlerësojnë diversitetin | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe të përfshijnë të tjerët në aktivitetet shkollore. | | | | | |
| | **3.3.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë një kulturë shkollore që mbështet dhe shpërblen sjelljen bashkëpunuese dhe të respektueshme, duke nxitur nxënësit dhe stafin të angazhohen në aktivitete dhe qëndrime pozitive që kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve ndërpersonale. | | | | | |
| | **3.3.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërhyjnë për të ndihmuar në zgjidhjen e keqkuptimeve dhe tensioneve ndërmjet prindërve dhe stafit shkollor me teknika ndërmjetësimi, për të siguruar një komunikim të hapur dhe konstruktiv. | | | | | |
| | **3.3.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë në vijimësi marrëdhëniet ndërpersonale ndërmjet nxënësve, stafit dhe prindërve, për të siguruar që të gjitha palët të ndihen të mbështetura dhe të kenë mundësi përmirësimi në marrëdhëniet e tyre, me mbështetje të vazhdueshme. | | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 3.5:** | | | | | | |
| **Vlerësimi i fushës 3: (T1+T2+T3)/3** | | | | | | |
| **Fusha e cilësisë 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin** | | | | | | |
| **4.2.** Punonjësit | **4.2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime dhe sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve. | | organizojnë seanca ndërgjegjësuese me prindërit për rëndësinë e shëndetit mendor dhe ndikimin e tij në sjelljen dhe suksesin e fëmijëve. | | | | |
| | **4.2.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë me prindërit ndikimin e stresit shkollor, ankthit, depresionit, bullizmit etj., në mirëqenien e fëmijëve. | | | | |
| | **4.2.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë prindërit për menaxhimin e sjelljeve të fëmijëve, duke i trajnuar mbi teknikat për të menaxhuar dhe për t'u përballur me situata të vështira në mënyrë konstruktive. | | | | |
| | **4.2.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë prindërit për strategji të ndryshme për ndërtimin e një mjedisi familjar që mbështet zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve, si dhe për zgjidhjen e konflikteve. | | | | |
| | **4.2.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë prindërit për krijimin e një mjedisi mbështetës që nxit të nxënit dhe zhvillimin e aftësive jetësore. | | | | |
| | **4.2.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social u japin udhëzime prindërve për të forcuar marrëdhëniet prind-fëmijë dhe për të ndërtuar vetëbesimin te fëmijët. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **4.2.7.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë takime me prindër në mjediset e shkollës për të diskutuar në mënyrë interaktive me shembuj praktikë dhe situate reale. | | | | |
| | **4.2.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin platforma virtuale për të përfshirë edhe prindërit që nuk mund të marrin pjesë fizikisht, me prezantime multimediale dhe seanca pyetje-përgjigje. | | | | |
| | **4.2.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë prindërit përmes broshurave dhe udhëzuesve të thjeshtë mbi tema specifike, video ose infografikë për ta bërë përmbajtjen më të kuptueshme dhe të lehtë për t'u zbatuar. | | | | |
| | **4.2.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë këshillime individuale për raste të veçanta, bazuar në nevojat specifike të familjeve. | | | | |
| | **4.2.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social u japin prindërve udhëzime për identifikimin e shenjave të bullizmit dhe trajtimin e tij. | | | | |
| | **4.2.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë prindërit me strategji praktike për fëmijët në përballimin e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | stresit shkollor dhe social. | | | | |
| | **4.2.13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë familjet që fëmijët të përdorin teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme. | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit** | | | | | | |
| **4.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social promovon diversitetin e familjeve dhe të komunitetit si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës. | **4.3.1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledh informacione rreth burimeve të komunitetit që janë të rëndësishme për familjet dhe zhvillimin e nxënësve. | | | | |
| | **4.3.2.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktiviteteve që synojnë edukimin e nxënësit, mësuesit dhe prindërit mbi rëndësinë e respektimit dhe vlerësimit të kulturave dhe identiteteve të ndryshme. | | | | |
| | **4.3.3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë stafin për t'i ndihmuar të jenë të ndjeshëm ndaj diversitetit kulturor, ekonomik, gjinor apo të identiteteve të tjera të nxënësve dhe familjeve. | | | | |
| | **4.3.4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjithë aktorët e shkollës për krijimin e materialeve edukative që reflektojnë një shumëllojshmëri identitetesh dhe kulturash, duke normalizuar kështu diversitetin dhe duke e konsideruar atë | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | një pjesë natyrale të mjedisit të shkollës. | | | | | |
| | **4.3.5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjitha familjet, pavarësisht prejardhjes së tyre kulturore, etnike, gjuhësore dhe shoqërore. | | | | | |
| | **4.3.6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe edukimin e diversitetit, si dhe për të sfiduar dhe për të trajtuar stereotipet. | | | | | |
| | **4.3.7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin e shkollës, nxënësit, prindërit dhe me komunitetin, për organizimin e veprimtarive që lidhen me njohjen e kulturës, së traditave dhe të zakoneve krahinore. | | | | | |
| | **4.3.8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis përfshirës dhe mbështetës për nxënësit nga familje dhe prejardhje të ndryshme, për t'u ndjerë pjesë e shkollës dhe për të pasur hapësira ku mund të ndajnë përvojat e tyre unike. | | | | | |
| | **4.3.9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë diskutime të hapura me nxënësit për të nxitur dialogun mes tyre dhe për të ndarë përvojat e tyre, duke | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | theksuar vlerën e diversitetit kulturor dhe familjar si një pasuri për shkollën. | | | | | |
| | **4.3.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë familjet nga kultura të ndryshme për të kontribuar në jetën e shkollës, duke marrë pjesë në aktivitete, festa, takime, për të promovuar një atmosferë harmonie ndërkulturore. | | | | | |
| | **4.3.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë projekte, nisma vullnetare, që përfshijnë nxënës, prindër dhe anëtarë të komunitetit, stafin e shkollës, në funksion të promovimit të solidaritetit ndërmjet nxënësve nga familje të ndryshme. | | | | | |
| | **4.3.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë takime ndërgjegjësuese me të gjithë aktorët e shkollës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të qarta kundër diskriminimit dhe bullizmit në lidhje me përkatësinë etnike, kulturore, racore ose sociale të nxënësve dhe familjeve. | | | | | |
| | **4.3.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjithë aktorët e shkollës për të përfshirë të gjithë nxënësit në aktivitet e shkollës, duke siguruar që të trajtohen me respekt. | | | | | |
| **Vlerësimi i treguesit 4.3:** | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i fushës 4: (T2+T3)/2** | |
| **Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimit psiko-social: (F1+F2+F3+F4)/4** | |

**Grupi i vlerësimit** **Drejtori i shkollës** **Psikologu** **Punonjësi social**

# Formati i raportit[5] të vlerësimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË**

Nr._____ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

**Lënda:** Raporti i vlerësimit i shkollës për cilësinë e shërbimit psiko-social në fushat “Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve”, “Procesi i të nxënit”, “Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale”, “Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin”, me qëllim sigurimin e mirëqenies psiko-emocionale, ndërtimin e aftësive ndërpersonale dhe promovimin e një klime pozitive në klasë dhe në shkollë.

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

Rruga e Durrësit, nr. 23

**DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

Rruga “Egnatia”

**ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË**

Rruga ”Jeronim de Rada”, Tiranë

[5] Shembulli i formatit të raportit të vlerësimit i referohet shembullit të platformës së mësipërme.

**SHKOLLËS 9-VJEÇARE "__________________________"**

Rruga: "__________________________", Tiranë

## A. QËLLIMI I VLERËSIMIT

Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit psiko-social në fushat "Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve", "Procesi i të nxënit", "Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale", "Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin", me qëllim sigurimin e mirëqenies psiko-emocionale, ndërtimin e aftësive ndërpersonale dhe promovimin e një klime pozitive në klasë dhe në shkollë.

## B. BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar".
- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022, "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar.
- Udhëzimi i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024, "Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar".
- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, "Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social".
- "Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor", ASCAP 2022
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-social shkollor, ASCAP 2024.
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, ASCAP 2020.
- Udhëzuesi "Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës", ASCAP, 2020.

- “Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të shkollës”, ASCAP, 2020.

## C. DREJTIMET E VLERËSIMIT

### FUSHA 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe sjelljeve problematike**.**
- Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe individuale.

### FUSHA 2: Procesi i të nxënit

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në procesin mësimor dhe vetëbesimin në aftësitë e tyre në të nxënë.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe prindërit për të përshtatur strategjitë e të nxënit sipas nevojave individuale të nxënësve, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuar dhe nevoja veçanta.

### FUSHA 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykime të

gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe te nevojat e tyre për të ofruar mbështetje të përshtatshme dhe efektive.

- Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuara për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm shkollor.

**FUSHA 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime dhe sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve.
- Punonjësit e shërbimit psiko-social promovon diversitetin e familjeve dhe të komunitetit si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës.

## D. METODOLOGJIA

- Takime me drejtues të shkollës, punonjësit e shërbimit psiko-social, mësues, nxënës dhe prindër;
- Studimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të shërbimit psiko-social;
- Vëzhgime të seancave ndërgjegjësuese të punonjësve të shërbimit psiko-social, seanca ne grup.
- Analiza të vëzhgimeve;
- Zhvillimi i pyetësorëve, anketave, fokusgrupeve me nxënës, mësues dhe prindër;
- Takim përmbyllës me drejtorinë e shkollës dhe punonjësit e shërbimit psiko-social.

## E. INSTITUCIONI I VLERËSUAR

- Institucionet arsimore sipas urdhrit bashkëlidhur.

## F. KOHA E REALIZIMIT TË VLERËSIMIT

- Koha e realizimit sipas urdhrit bashkëlidhur.

## G. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në këtë rubrikë jepet një informacion i përgjithshëm i shkollës, duke u fokusuar edhe në shërbimin psiko-social.

## H. GJETJE DHE GJYKIME

Në këtë rubrikë jepen gjetjet dhe gjykimit për secilin tregues, bazuar në të gjitha të dhënat e mbledhura dhe të analizuara.

**FUSHA 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve**

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe të sjelljeve problematike**.**

  *Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

- Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht.

  *Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

- Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe individuale.

  *Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

  *Vlerësimi i fushës: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve*

**FUSHA 2: Procesi i të nxënit**

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të

zhvillojnë aftësitë e tyre në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në procesin mësimor dhe vetëbesimin në aftësitë e tyre në të nxënë.

*Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

- Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe prindërit për të përshtatur strategjitë e të nxënit sipas nevojave individuale të nxënësve, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuar dhe nevoja veçanta.

*Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

*Vlerësimi i fushës: Procesi i të nxënit*

**FUSHA 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale**

**Treguesit:**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi.

*Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

- Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykime të gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe te nevojat e tyre për të ofruar mbështetje të përshtatshme dhe efektive.

*Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

- Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuara për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm shkollor.

*Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

*Vlerësimi i fushës: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale*

**FUSHA 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin**

- Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime dhe sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve.

  *Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

- Punonjësit e shërbimit psiko-social promovon diversitetin e familjeve dhe të komunitetit si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës.

  *Vlerësimi i treguesit sipas shkallës së cilësisë.*

  *Vlerësimi i fushës**:** Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin*

  *Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimit psiko-social*

**I. PËRFUNDIME**

Në këtë rubrikë jepet një përmbledhje e pikave të forta dhe dobësitë e shërbimit psiko-social në shkollë, si dhe faktorët që kanë mundësuar apo penguar cilësinë.

**J. REKOMANDIME**

Në këtë rubrikë jepen udhëzime konkrete për fuqizimin e shërbimit psiko-social, duke përcaktuar personat përgjegjës dhe afatet kohore.

**K. PROPOZIM PËR MASA DISIPLINORE/ADMINISTRATIVE**

Në këtë rubrikë, në rast të identifikimit të mangësive të mëdha të shërbimit psiko-social, funksionimit të tij në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, grupi i vlerësimit mund të propozojë masa disiplinore/administrative organit kompetent për dhënien e tyre.

**GRUPI I VLERËSIMIT**

# Formati i planit të përmirësimit për punonjësit e shërbimit psiko-social

**Shembull:**

**Qëllimi kryesor:**

Të rritet efikasiteti dhe ndikimi pozitiv i shërbimit psiko-social në mbështetjen e mirëqenies së nxënësve dhe të komunitetit shkollor.

| Elementet e planit | Qëllimi i veprimtarisë | Veprimtaritë kryesore | Rezultatet e pritshme | Personat përgjegjës | Afati Kohor |
|---|---|---|---|---|---|
| - Trajnime dhe zhvillim profesional. | - Të rritet aftësia e punonjësve për të adresuar sfida komplekse dhe për të përdorur mjete bashkëkohore. | - Organizim i i trajnimeve mbi qasjet moderne psiko-sociale dhe trajtimin e krizave emocionale.<br>- Seanca për teknika ndërhyrjeje për bullizmin dhe | - Një staf psiko-social më i trajnuar dhe më efikas. Përmirësim në menaxhimin e situatave psiko-sociale. | - Drejtoria e shkollës, ekspertë të jashtëm, institucione trajnuese ose OJF-të. | 0-6 muaj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | konfliktet në grup.<br>- Zhvillimi i aftësive për përdorimin e platformave digjitale për mbështetje psiko-sociale. | | | |
| - Mbështetje për nxënësit dhe stafin. | - Të ndihmohet stafi i shkollës dhe nxënësit për të krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës. | - Hartimi i programeve për parandalimin dhe menaxhimin e bullizmit në shkollë.<br>- Seanca ndërgjegjësimi për nxënësit mbi rolin e respektit dhe të | - Rënie në numrin e rasteve të bullizmit.<br>- Rritje e kënaqësisë dhe të mirëqenies në komunitetin shkollor. | - Punonjësit psiko-socialë, mësuesit kujdestarë, këshilli i nxënësve. | 6-12 muaj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | empatisë.<br>- Krijimi i protokolleve për ndërhyrje të shpejtë në raste emergjencash emocionale. | | | |
| - Bashkëpunimi me prindërit. | - Të ndërtohet një aleancë efektive mes prindërve dhe shërbimit psiko-social, për të mbështetur fëmijët në mënyrë gjithëpërfshirëse. | - Organizimi i takimeve të rregullta, për të diskutuar mirëqenien emocionale të nxënësve.<br>- Krijimi i fushatave edukative mbi ndikimin e rolit prindëror në menaxhi | - Rritje e ndërgjegjësimit dhe të përfshirjes së prindërve në përmirësimin e sjelljes dhe të mirëqenies së fëmijëve. | - Punonjësit psiko-socialë, këshilli i prindërve, drejtoria e shkollës. | 3-6 muaj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | min e sfidave sociale dhe emocionale të fëmijëve.<br>- Informimi i prindërve për politikat antibullizëm të shkollës. | | | |
| - Përmirësimi i mjedisit të punës. | - Të krijohet një mjedis që mundëson ndërhyrje cilësore dhe komoditet për punonjësit dhe nxënësit. | - Sigurimi i materialeve dhe i mjeteve të reja për shërbimin psiko-social (literaturë, vegla digjitale, etj.).<br>- Krijimi i hapësirave të përshtatshme për | - Një mjedis pune më i përshtatshëm dhe efektiv.<br>- Rritje e cilësisë së shërbimeve të ofruara për nxënësit. | - Drejtoria e shkollës,<br>- bordi i shkollës,<br>- bashkia,<br>- donatorë të mundshëm. | 6-9 muaj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | konsultime konfidenciale dhe ndërhyrje terapeutike. Përmirësimi i infrastrukturës për aktivitete në grup. | | | |
| - Vlerësimi dhe monitorimi. | - Të sigurohet që plani i përmirësimit është efektiv dhe të bëhen përshtatjet e nevojshme për përmirësim të vazhdueshëm. | - Mbledhja e të dhënave mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe të përmirësimeve. Përdorimi i anketave për të vlerësuar kënaqësinë e nxënësve, të prindërve | - Të dhëna më të sakta për efektivitetin e veprimeve.<br>- Përmirësime të vazhdueshme të bazuara në vlerësime dhe feedback. | - Drejtuesi i shërbimit psiko-social, drejtoria e shkollës, anëtarët e bordit të shkollës. | Në vazhdimësi. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe të stafit.<br>- Organizimi i takimeve periodike për rishikimin e progresit dhe përshtatjen e planit. | | | |

# MODELE ANKETASH/PYETËSORËSH PËR PRINDËRIT, NXËNËSIT DHE MËSUESIT

***Përshkrimi i shkallës së vlerësimit të përdorur për vlerësimin me numra 1-5:***

| | | |
|---|---|---|
| ***1*** | ***Aspak dakord*** | Shërbimi ka disa elemente pozitive, por ka ende shumë mangësi që duhen adresuar dhe ka nevojë për përmirësim të menjëhershëm. |
| ***2*** | ***Pjesërisht dakord*** | Shërbimi është në një nivel të pranueshëm, por mund të përmirësohet në disa aspekte. |
| ***3*** | ***Dakord*** | Shërbimi është i efektshëm dhe ka arritur rezultate të dukshme, por ka ende mundësi për rritje. |
| ***4*** | ***Shumë dakord*** | Shërbimi është shumë efektiv dhe ka ndikuar ndjeshëm në zhvillimin emocional dhe social të fëmijës. |

***Pyetësor për prindërit në lidhje me efikasitetin e shërbimit psiko-social në zhvillimin emocional dhe social të nxënësve***

I nderuar prind,

Niveli i dakordësisë suaj me pohimet në vijim, ka për qëllim të vlerësojë efikasitetin e shërbimit psiko-social në shkollë, duke u fokusuar në ndikimin që ka ky shërbim në zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve tuaj. Përgjigjet tuaja do të na ndihmojnë të përmirësojmë shërbimet që ofrohen për fëmijët tuaj.

| **Nr.** | **Pyetja** | **1** | **2** | **3** | **4** |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë informuar për rolin e tyre në shkollë për menaxhimin e problematikave emocionale dhe sjellore. | | | | |
| **2.** | Fëmija im ka pasur mbështetje nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për menaxhimin e emocioneve dhe të sjelljeve | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | problematike. | | | | |
| **3.** | Shërbimi psiko-social ka qenë efektiv në ndihmën që i ka dhënë fëmijës tim, për të zhvilluar aftësi në menaxhimin e emocioneve (p.sh., zemërim, trishtim). | | | | |
| **4.** | Shërbimi psiko-social ka krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për fëmijën tim, për t'a ndihmuar të shprehë shqetësimet dhe emocionet. | | | | |
| **5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë organizuar aktivitete që ndihmojnë nxënësit në zhvillimin e aftësive sociale dhe të shëndetshme të sjelljes. | | | | |
| **6.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë trajtuar tema për problemet e shëndetit mendor të nxënësve (p.sh., ankth, depresion). | | | | |
| **7.** | Jam i kënaqur me mbështetjen që ofrojnë punonjësit e shërbimit psiko-social për nxënësit në shkollë. | | | | |
| **8.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërhyjnë rregullisht për të parandaluar sjelljet problematike dhe për të promovuar sjellje të shëndetshme të fëmijëve në shkollë. | | | | |
| **9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërhyjnë rregullisht për të trajtuar konflikte dhe situata të tensionuara mes nxënësve. | | | | |
| **10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërhyjnë rregullisht për zhvillimin e aftësive sociale dhe të marrëdhënieve të shëndetshme mes nxënësve. | | | | |
| **11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë kontaktuar dhe kanë informuar për nevojat e fëmijës dhe zhvillimin e tij emocional dhe social. | | | | |
| **12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë përfshirë fëmijën tim në aktivitete që promovojnë zhvillimin e tij emocional dhe social, të zhvilluara në klasë. | | | | |
| **13.** | Sa herë që kam nevojë, unë mund të komunikoj me punonjësit e shërbimit psiko-social për nevojat e fëmijës tim. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **14.** | Ndërhyrjet dhe aktivitetet e realizuara nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për mbështetjen e zhvillimit psiko-emocional të fëmijës tim kanë qenë efikase. | | | | |
| **15.** | Jam i kënaqur me mënyrën si shërbimi psiko-social ka trajtuar dhe ka mbështetur fëmijën tim, për të përballuar sfidat e shëndetit mendor dhe ato emocionale. | | | | |
| **16.** | Ndërhyrjet dhe aktivitetet e realizuara nga punonjësit e shërbimit psiko-social, ka mundësuar zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe të ndihmuarit për të zgjidhur probleme sociale dhe emocionale. | | | | |
| **17.** | Shërbimi psiko-social ka ndihmuar nxënësit që të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre. | | | | |
| **18.** | Cilat janë fushat që mendoni se kërkojnë përmirësim në shërbimin psiko-social për zhvillimin emocional dhe social të fëmijës tuaj?<br><br>___________________________________<br><br>___________________________________<br><br>___________________________________ | | | | |

# Pyetësor për nxënësit, në lidhje me efikasitetin e shërbimit psiko-social në zhvillimin emocional dhe social të tyre

I/e dashur nxënës/e,

Niveli i dakordësisë suaj me pohimet në vijim, ka për qëllim të vlerësojë efikasitetin e shërbimit psiko-social në shkollë, duke u fokusuar në ndikimin që ka ky shërbim në zhvillimin emocional dhe social tuajin. Përgjigjet tuaja do të na ndihmojnë të përmirësojmë shërbimet që ofrohen për ju.

| Nr. | Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Unë kam marrë ndihmë nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për të menaxhuar emocionet (p.sh., zemërim, trishtim). | | | | |
| 2. | Unë jam ndihmuar nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për të zhvilluar aftësitë, për të menaxhuar sfidat me sjelljen. | | | | |
| 3. | Unë kam besim që të flas lirshëm me punonjësin e shërbimit psiko-social për ndjenjat e mia. | | | | |
| 4. | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë mbështetur për t'u ndjerë më e sigurt në shkollë. | | | | |
| 5. | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar që të zhvilloj marrëdhënie më të mira me shokët e mi. | | | | |
| 6. | Shërbimi psiko-social zhvillon aktivitete që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive tona sociale (p.sh., komunikimi, bashkëpunimi). | | | | |
| 7. | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar për të kuptuar më mirë ndjenjat dhe emocionet e nxënësve të tjerë. | | | | |
| 8. | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar për shqetësimet e mia në lidhje me shëndetin mendor (p.sh., ankth, stres). | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **9.** | Aktivitetet që ofron shërbimi psiko-social më kanë ndihmuar të përmirësoj vetëbesimin dhe motivimin në shkollë. | | | | |
| **10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social komunikojnë me gjuhë të qartë dhe korrekte, kur diskutojmë problemet që ndodhin mes nxënësve. | | | | |
| **11.** | Unë ndihem i lirshëm të flas me punonjësin e shërbimit psiko-social për problemet që mund të kem në shkollë. | | | | |
| **12.** | Kam marrë mbështetje sa herë kam kërkuar ndihmë nga punonjësi i shërbimit psiko-social, për të përballuar situata stresuese në shkollë (p.sh., provime, konflikte). | | | | |
| **13.** | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar të zhvilloj më mirë aftësitë e mia, për të zgjidhur problemet sociale dhe emocionale. | | | | |
| **14.** | Shërbimi psiko-social zhvillon aktivitete sensibilizuese mbi tema të shëndetit mendor dhe emocional në shkollë. | | | | |
| **15.** | Puna e shërbimit psiko-social në shkollë, ndihmon për të parandaluar dhunën dhe konfliktet mes nxënësve. | | | | |
| **16.** | Cilat janë fushat që mendoni se kërkojnë përmirësim nga shërbimi psiko-social për zhvillimin emocional dhe social të nxënësve?<br><br>________________________________________________<br><br>________________________________________________<br><br>________________________________________________ | | | | |

# Pyetësor për prindërit, për të vlerësuar cilësinë e shërbimit psiko-social, në lidhje me procesin e të nxënit të fëmijëve

| Nr. | Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Punonjësi i shërbimit psiko-social më ka informuar për rolin e tij në shkollë, për të ndihmuar fëmijën tim që të përmirësojë përfshirjen në mësim. | | | | |
| 2. | Jam i kënaqur me ndihmën që shërbimi psiko-social i ofron fëmijës tim për të rritur vetëbesimin në procesin e të nxënit. | | | | |
| 3. | Shërbimi psiko-social ka bashkëpunuar me mua dhe mësuesit, për të përshtatur strategjitë e të nxënit sipas nevojave të fëmijës tim. | | | | |
| 4. | Shërbimi psiko-social ka orientuar drejt grupin për hartimin e planit individual për fëmijën tim, për përmirësimin e aftësive të tij/saj në të nxënë. | | | | |
| 5. | Shërbimi psiko-social kujdeset për shërbimin që i ofrohet nxënësit me nevoja të veçanta në shkollë (p.sh., aftësi të kufizuara, vështirësi të tjera). | | | | |
| 6. | Kam vënë re përmirësime në aftësitë e fëmijës tim, për zgjidhjen e problemeve dhe përfshirjen në procesin e të mësuarit, si rezultat i ndihmës së shërbimit psiko-social. | | | | |
| 7. | Qasjet që përdor shërbimi psiko-social për të inkurajuar mësimin aktiv dhe për të rritur bashkëpunimin për fëmijën tim, janë të dobishme. | | | | |
| 8. | Ndërhyrja e shërbimi psiko-social ka ndihmuar fëmijën tim të zhvillojë aftësitë sociale dhe bashkëpunuese gjatë procesit të të nxënit. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **9.** | Shërbimi psiko-social ka ofruar mbështetje për fëmijën tim, sa herë ka pasur nevojë të përballet me sfidat që lidhen me procesin e të nxënit (p.sh., mungesa e motivimit, vështirësi në përqendrim). | | | | |
| **10.** | Mendoj se ndërhyrjet dhe mbështetja e shërbimit psiko-social për përmirësimin e performancës akademike të fëmijës tim, është e rëndësishme. | | | | |
| **11.** | Shërbimi psiko-social është kujdesur, të më përfshijë si prind, për të përmirësuar procesin e të nxënit të fëmijës tim. | | | | |
| **12.** | Shërbimi psiko-social ka zhvilluar aktivitete psiko-edukative, të cilat kanë mbështetur aftësitë e fëmijës tim në procesin e të nxënit. | | | | |
| **13.** | Mendoj se shërbimi psiko-social ka ndikuar në përmirësimin e marrëdhënieve të fëmijës tim me shokët dhe me mësuesit, gjatë procesit të të nxënit. | | | | |
| **14.** | Shërbimi psiko-social ka ndihmuar fëmijën tim të zhvillojë më shumë aftësi, për të menaxhuar emocionet që mund të ndikojnë në të nxënit e tij/saj. | | | | |
| **15.** | Shërbimi psiko-social ka krijuar një atmosferë pozitive, që inkurajon fëmijën tim të angazhohet dhe të përparojë në mësime. | | | | |
| **16.** | Cilat janë disa nga mënyrat më të mira që shërbimi psiko-social mund të ndihmojë për të përmirësuar procesin e të nxënit të fëmijës tuaj?<br>________________________________________<br>________________________________________<br>________________________________________ | | | | |

# Pyetësor për nxënësit, në lidhje me shërbimin psiko-social dhe mbështetje për procesin e të nxënit, me pyetje specifike dhe shkallë të standardizuara për përgjigjet

| Nr. | Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | Punonjësit e shërbimi psiko-social më kanë ndihmuar që të identifikoj aftësitë e mia të veçanta për të mësuar. | | | | |
| **2.** | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar të rris besimin në mundësitë e mia për të mësuar. | | | | |
| **3.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar në kuptimin dhe menaxhimin e emocioneve, që mund të ndikojnë në mënyrën e të mësuarit. | | | | |
| **4.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit, për të më ndihmuar në kapërcimin e vështirësive individuale në të mësuar. | | | | |
| **5.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete në klasë, që të bëjnë të ndihesh më i përfshirë dhe i motivuar në procesin mësimor. | | | | |
| **6.** | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar të zhvilloj aftësitë e mia, për të zgjidhur probleme në mësime. | | | | |
| **7.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për të mësuar. | | | | |
| **8.** | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar që të përmirësoj marrëdhëniet me shokët dhe mësuesit në klasë. | | | | |
| **9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar për të kuptuar më mirë mënyrën se si mësoj dhe për të përmirësuar aftësitë e mia për të nxënë. | | | | |
| **10.** | Shërbimi psiko-social ka zhvilluar aktivitete që rrisin angazhimin dhe pjesëmarrjen time në mësim. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar të zhvilloj aftësitë e mia, për të menduar dhe për të analizuar në mënyrë kritike. | | | | |
| **12.** | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar që të menaxhoj më mirë stresin dhe ngarkesën në shkollë. | | | | |
| **13.** | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar në krijimin e aftësive për t'u organizuar që të mësoj më mirë. | | | | |
| **14.** | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar të përballem me vështirësitë që mund të kem pasur gjatë mësimeve. | | | | |
| **15.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar në përmirësimin e aftësive sociale dhe bashkëpunuese me të tjerët në klasë. | | | | |
| **16.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar të marr mbështetje në mësime dhe të jem aktiv në klasë. | | | | |
| **17.** | Çfarë sugjerimesh keni për punonjësit e shërbimit psiko-social, për të përmirësuar mbështetje që ofrojnë në procesin e të nxënit?<br>______________________________<br>______________________________<br>______________________________ | | | | |

# Pyetësor për prindërit, i cili vlerëson cilësinë e shërbimit psiko-social në lidhje me sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale në shkollë.

| Nr. | Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë informuar për rolin e tyre në shkollë për marrëdhëniet ndërpersonale dhe problematikat sjellore. | | | | |
| 2. | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë komunikuar rregullisht me mua në mënyrë të qartë dhe të saktë, lidhur me nevojat e fëmijës tim. | | | | |
| 3. | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi me fëmijën tim, në mjedisin e shkollës. | | | | |
| 4. | Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje shqetësimet dhe ndjenjat e fëmijës tim, duke iu përkushtuar nevojave të tij/saj. | | | | |
| 5. | Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë komunikim të hapur dhe të drejtpërdrejtë mes fëmijës tim, mësuesve dhe mua si prind. | | | | |
| 6. | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë ndihmuar për të trajtuar dhe për të zgjidhur ndonjë konflikt mes nxënësve në klasë. | | | | |
| 7. | Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë, pa favorizime apo paragjykime. | | | | |
| 8. | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë menaxhuar me kujdes dhe pranë nevojave të fëmijëve, situata të ndjeshme, si konflikte apo vështirësi sociale që përfshijnë fëmijën tim. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **9.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin përmirësimin e marrëdhënieve ndërpersonale të fëmijës tim me shokët/shoqet dhe stafit shkollor | | | | |
| **10.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit të shkollës. | | | | |
| **11.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social kontribuojnë në ndërtimin e një komuniteti shkollor të shëndetshëm, ku secili ndihet i vlerësuar dhe i respektuar. | | | | |
| **12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social tregohen të hapur dhe të gatshëm për të biseduar me mua kur kam shqetësime lidhur me fëmijën tim. | | | | |
| **13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi për përfshirjen e fëmijës tim në aktivitete sociale dhe bashkëpunuese në shkollë. | | | | |
| **14.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të gatshëm të trajtojnë shqetësime që mund të kem, lidhur me sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale të fëmijës tim. | | | | |
| **15.** | Shërbimi psiko-social ka treguar gatishmëri, të ndërhyjë në rritjen e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit mes fëmijës tim dhe shokëve/shoqeve të tij/saj | | | | |
| **16.** | Shërbimi psiko-social ka mbështetur fëmijën tim në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme me shokët dhe stafin shkollor. | | | | |
| **17.** | Si mund të përmirësohet mbështetja që shërbimi psiko-social ofron për sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale të fëmijës tuaj në shkollë?<br>____________________________________________<br>____________________________________________<br>____________________________________________ | | | | |

# Pyetësor për nxënësit, i cili vlerëson cilësinë e shërbimit psiko-social në lidhje me sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale.

| Nr. | Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë dëgjuar për shqetësimet dhe ndjenjat e mia. | | | | |
| 2. | Shërbimi psiko-social më ka ndihmuar që të kem një marrëdhënie më të mirë me shokët dhe shoqet e mia. | | | | |
| 3. | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar kur kam pasur probleme me sjelljen e të tjerëve në shkollë. | | | | |
| 4. | E kam të lehtë të komunikoj me punonjësit e shërbimit psiko-social kur kam nevojë për ndihmë. | | | | |
| 5. | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë krijuar mundësi për të diskutuar me të tjerët dhe për të zgjidhur ndonjë problem që mund të kem pasur në shkollë. | | | | |
| 6. | Unë mund të flas me punonjësit e shërbimit psiko-social në mënyrë të hapur dhe pa u frikësuar nga paragjykimet. | | | | |
| 7. | Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë ndihmuar për të krijuar një atmosferë më të qetë dhe të respektueshme në shkollë. | | | | |
| 8. | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë për të menaxhuar dhe për të zgjidhur konfliktet në shkollë. | | | | |
| 9. | Punonjësit e shërbimit psiko-social i trajtojnë të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. | | | | |
| 10. | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar që të ndihem më mirë dhe të kem më shumë besim në veten time. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **11.** | Aktivitetet që janë organizuar nga shërbimi psiko-social, më kanë dhënë mundësinë të bashkëpunoj me shokët dhe mësuesit. | | | | |
| **12.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë për krijimin e një marrëdhënieje më të mirë me mësuesit dhe stafin shkollor. | | | | |
| **13.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi për të ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet nxënësve në klasë. | | | | |
| **14.** | Shërbimi psiko-social më ka mësuar të zgjidh në mënyrë paqësore problemet që has me shokët. | | | | |
| **15.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë ndihmuar të ndihem më i përfshirë në grupin e klasës dhe në aktivitete shkollore. | | | | |
| **16.** | Punonjësit e shërbimit psiko-social më kanë mbështetur, për të ndihmuar shokët dhe shoqet që mund të kenë vështirësi ose probleme. | | | | |
| **17.** | Çfarë mund të bëjnë më mirë punonjësit e shërbimit psiko-social, për të ndihmuar nxënësit në ndërtimin e marrëdhënieve më të mira me shokët dhe stafin shkollor?<br><br>__________________________________________________<br><br>__________________________________________________<br><br>__________________________________________________ | | | | |

# Pyetësor për prindërit në lidhje me komunikimin, mbështetjen dhe përfshirjen e prindërve në aktivitete të ndryshme që lidhen me zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

| Nr. | Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Sa shpesh punonjësit e shërbimit psiko-social të shkollës, komunikojnë me ju për nevojat dhe zhvillimet e fëmijës tuaj? | | | | |
| 2. | A janë punonjësit e shërbimit psiko-social të hapur dhe të gatshëm, për të biseduar me ju kur keni shqetësime për fëmijën tuaj? | | | | |
| 3. | Sa shpesh organizohen sesione informuese nga shërbimi psiko-social, për të ofruar informacion rreth shëndetit mendor dhe mbështetjes për zhvillimin e fëmijëve? | | | | |
| 4. | A keni marrë ndihmë dhe këshilla praktike nga shërbimi psiko-social, për të mbështetur zhvillimin emocional dhe social të fëmijës tuaj? | | | | |
| 5. | Sa i qartë është komunikimi me shërbimin psiko-social për çështjet që lidhen me fëmijën tuaj? | | | | |
| 6. | A janë punonjësit e shërbimit psiko-social të disponueshëm për të diskutuar mundësitë e përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës tuaj? | | | | |
| 7. | A mendoni se shërbimi psiko-social ofron mbështetje të mjaftueshme për zhvillimin e marrëdhënieve të shëndetshme ndërmjet fëmijës tuaj dhe shokëve të tij/saj? | | | | |
| 8. | Sa shpesh ndihmon shërbimi psiko-social për zgjidhjen e problemeve që lidhen me sjelljen e fëmijës tuaj në | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | shkollë? | | | | |
| **9.** | Sa të informuar ndiheni për teknikat dhe strategjitë që shërbimi psiko-social ofron për përmirësimin e sjelljes dhe të shëndetit mendor të fëmijës tuaj? | | | | |
| **10.** | A ka mbështetur shërbimi psiko-social zhvillimin e fëmijës tuaj, duke përfshirë dhe duke promovuar vlerat e diversitetit brenda komunitetit shkollor? | | | | |
| **11.** | A keni marrë ndihmë për të krijuar një mjedis mbështetës dhe të sigurt për fëmijën tuaj në shkollë, përmes shërbimit psiko-social? | | | | |
| **12.** | Sa shpesh shërbimi psiko-social është i gatshëm për të biseduar dhe për të marrë feedback nga ju, për përvojat e fëmijës tuaj në shkollë? | | | | |
| **13.** | A keni pasur mundësinë të merrni pjesë në aktivitete të organizuara nga shërbimi psiko-social, për të mbështetur zhvillimin emocional të fëmijës tuaj? | | | | |
| **14.** | A mendoni se shërbimi psiko-social është një resurs i rëndësishëm për përmirësimin e mjedisit shkollor dhe zhvillimin e fëmijëve? | | | | |
| **15.** | Sa shpesh shërbimi psiko-social ju informon në lidhje me përparimin dhe zhvillimin e fëmijës tuaj? | | | | |
| **16.** | A ndihmon shërbimi psiko-social, për të përmirësuar bashkëpunimin tuaj si prind me mësuesit dhe stafin shkollor? | | | | |
| **17.** | Si mund të përmirësohet komunikimi dhe bashkëpunimi midis prindërve dhe shërbimit psiko-social, për të ndihmuar fëmijën tuaj?<br>____________________________________________<br>____________________________________________<br>____________________________________________ | | | | |

# Pyetësor për mësuesit në lidhje me kënaqësinë e tyre ndaj shërbimit psiko-social

1. Si e vlerësoni në përgjithësi, shërbimin psiko-social në shkollën tuaj?

    a) Shumë të kënaqur
    b) Të kënaqur
    c) Pjesërisht të kënaqur
    d) Të pakënaqur
    e) Shumë të pakënaqur

2. Sa shpesh punonjësit e shërbimit psiko-social janë të pranishëm dhe të disponueshëm për mbështetje?

    a) Gjithmonë
    b) Shpesh
    c) Ndonjëherë
    d) Rrallë
    e) Asnjëherë

3. A mendoni se shërbimi psiko-social ofron mbështetje të mjaftueshme për nxënësit me nevoja të veçanta?

    a) Gjithmonë
    b) Shpesh
    c) Ndonjëherë
    d) Rrallë
    e) Asnjëherë

4. Si e vlerësoni rolin e shërbimit psiko-social në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për nxënësit?

    a) Shumë mirë
    b) Mirë

c) Mjaftueshëm
d) Dobët
e) Shumë dobët

5. A keni vërejtur përmirësime në sjelljen dhe emocionet e nxënësve pas ndërhyrjeve të shërbimit psiko-social?

a) Gjithmonë
b) Shpesh
c) Ndonjëherë
d) Rrallë
e) Asnjëherë

6. A mendoni se shërbimi psiko-social në shkollën tuaj, ka ndihmuar në përmirësimin e marrëdhënieve ndërpersonale ndërmjet nxënësve?

a) Gjithmonë
b) Shpesh
c) Ndonjëherë
d) Rrallë
e) Asnjëherë

8. Sa të kënaqur jeni me komunikimin e shërbimit psiko-social me stafin e shkollës, në lidhje me nevojat e nxënësve?
    a) Shumë të kënaqur
    b) Të kënaqur
    c) Pjesërisht të kënaqur
    d) Të pakënaqur
    e) Shumë të pakënaqur

8. A mendoni se shërbimi psiko-social komunikon mjaftueshëm me prindërit, për të ndihmuar në zhvillimin e nxënësve?

    a) Gjithmonë
    b) Shpesh

c) Ndonjëherë
d) Rrallë
e) Asnjëherë

9. Cilat janë përfitimet më të dukshme që ka sjellë shërbimi psiko-social në shkollën tuaj?

_______________________________________________________________________________

__________________________________________

10. Cilat janë fushat ku mendoni se shërbimi psiko-social mund të përmirësohet në të ardhmen?

_______________________________________________________________________________

__________________________________________

# Pyetësor për drejtuesit e shkollës në lidhje me shërbimin psiko-social

1. ***Në përgjithësi, a jeni të kënaqur nga cilësia e shërbimit psiko-social në shkollën tuaj?***

    a) Shumë të kënaqur
    b) Të kënaqur
    c) Pjesërisht
    d) Të pakënaqur
    e) Shumë të pakënaqur

2. A mendoni se shërbimi i ofruar nga punonjësit e shërbimit psiko-social është i përshtatshëm për të mbështetur nxënësit me nevoja të ndryshme (emocionale, sociale, edukative)?

    a) Gjithmonë
    b) Shpesh
    c) Ndonjëherë
    d) Rrallë
    e) Asnjëherë

3. Si e vlerësoni mënyrën e punës të punonjësve të shërbimit psiko-social, për të adresuar nevojat e nxënësve në situata të ndryshme?

    a) Shumë mirë
    b) Mirë
    c) Mjaftueshëm
    d) Dobët
    e) Shumë dobët

4. A mendoni se shërbimi psiko-social ka një ndikim pozitiv në klimën shkollore (në aspektin e bashkëpunimit, të mirëkuptimit dhe të respektit)?

a) Plotësisht dakord
b) Dakord
c) Pjesërisht dakord
d) Nuk jam dakord
e) Aspak dakord

5. Sa mendoni se shërbimi psiko-social është i angazhuar në promovimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për nxënësit?

a) Gjithmonë
b) Shpesh
c) Ndonjëherë
d) Rrallë
e) Asnjëherë

6. Si e vlerësoni mbështetjen që ofron shërbimi psiko-social për nxënësit me nevoja të veçanta dhe ato që përballen me vështirësi emocionale dhe sociale?

a) Shumë mirë
b) Mirë
c) Mjaftueshëm
d) Dobët
e) Shumë dobët

7. A mendoni se komunikimi i punonjësit e shërbimit psiko-social me prindërit dhe komunitetin është në nivelin e nevojshëm për të mbështetur zhvillimin e nxënësve?

a) Gjithmonë
b) Shpesh
c) Ndonjëherë
d) Rrallë
e) Asnjëherë

8. Si e vlerësoni bashkëpunimin e shërbimit psiko-social me prindërit, në lidhje me nevojat dhe problemet që mund të kenë nxënësit?

a) Shumë mirë
b) Mirë
c) Mjaftueshëm
d) Dobët
e) Shumë dobët

10. Si e vlerësoni profesionalizmin e punonjësve të shërbimit psiko-social në menaxhimin e situatave të ndjeshme që lidhen me nxënësit?

a) Shumë mirë
b) Mirë
c) Mjaftueshëm
d) Dobët
e) Shumë dobët

11. A janë punonjësit e shërbimit psiko-social të disponueshëm dhe të gatshëm për të ofruar ndihmë dhe mbështetje për stafin dhe drejtuesit e shkollës?

a) Gjithmonë
b) Shpesh
c) Ndonjëherë
d) Rrallë
e) Asnjëherë

12. A mendoni se punonjësit e shërbimit psiko-social kanë treguar aftësi të nevojshme për të mbështetur zhvillimin dhe mirëqenien e nxënësve?

a) Gjithmonë
b) Shpesh
c) Ndonjëherë
d) Rrallë
e) Asnjëherë

13. Cilat janë disa nga mundësitë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit psiko-social në shkollën tuaj?

______________________________________________________________________________

________________________________________

14. Cilat janë sfidat kryesore që hasni në menaxhimin e shërbimit psiko-social dhe si mund të adresohen ato?

______________________________________________________________________________

________________________________________

15. A ka fusha të tjera ku mendoni se shërbimi psiko-social mund të kontribuojë më shumë për përmirësimin e shkollës dhe ndihmën për nxënësit?

______________________________________________________________________________

________________________________________

# BAZA LIGJORE

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
- Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025).
- Vendimi nr. 733, datë 20.10.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe të planit të veprimit".
- Vendimi nr. 98, datë 27.02.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit parauniversitar (ASCAP)".
- Vendimi nr. 99, datë 27.02.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)".
- Vendimi nr. 276, datë 12.5.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025".
- Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj".
- "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzim nr. 15, datë 12.07.2013, "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 26, datë 02.08.2013, "Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Këshillit të Mësuesve".

- Udhëzimi nr. 30, datë 02.08.2013, "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore".
- Udhëzimi nr. 43, datë 21.08.2013, "Për planifikimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike".
- Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, "Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë".
- Udhëzimi nr. 10, datë 25.02.2015, katërministror midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës".
- Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015 "Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale", i ndryshuar.
- Udhëzim nr. 25, datë 25.07.2018, "Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor".
- Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, "Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare".
- Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, "Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar".
- Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar".
- Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve".
- Udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë'", i ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 1.12.2021; nr. 28 datë 3.8.2022 dhe nr. 17, datë 26.7.2023.
- Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024, "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë".

- Udhëzimi nr. 10, datë 06.05.2022, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për ngritjen, funksionimin dhe zhvillimin profesional të rrjetit kombëtar të monitoruesve, vlerësuesve dhe vlerësuesve me bazë risku për institucionet arsimore parauniversitare".
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar".
- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, "Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social".
- Urdhri nr. 8, datë 12.01.2017, "Për miratimin e kornizës kurrikulare të arsimit parashkollor dhe standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç".
- Urdhër nr. 100, datë 25.2.2022, "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit".
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, "Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë", ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- Marrëveshja e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Agjencinë Ekzekutive për Arsimin, Mediet Audiovizive dhe Kulturën e Komisionit Evropian.
- Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, më 30.11.2013.
- Standardet profesionale të vlerësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare, ASCAP 2021.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

# BIBLIOGRAFIA


"Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor", ASCAP 2022

https://www.efpa.eu/sites/default/files/2023-04/meta-code-of-ethics.pdf

https://www.efpa.eu/mental-health

https://www.schoolcounselor.org/Standards-Positions/Standards

https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/367426/9789240064751-eng.pdf?sequence=1

https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000387380

https://psychology.org.au/aps/media/resource-finder/frameëork-delivery-school-psych-services-practice-guide.pdf

https://education.nsw.gov.au/content/dam/main-education/about-us/educational-data/cese/2020-school-counselling-service-expansion-final-report.pdf

https://planipolis.iiep.unesco.org/sites/default/files/ressources/ireland_ëellbeing-policy-statement-and-frameëork-for-practice-2018-2023.pdf

https://www.ptsd.va.gov/professional/articles/article-pdf/id30225.pdf

https://ëëë.saasso.asn.au/wp-content/uploads/2013/04/National-School-Chaplaincy-and-Student-Welfare-Program-Guidelines.pdf

https://iris.ëho.int/bitstream/handle/10665/376208/9789240087149-eng.pdf

https://cms.bps.org.uk/sites/default/files/2022-06/BPS%20Response%20-%20Ofsted%20Education%20Inspection%20Frameëork%202019.pdf

https://casponline.org/pdfs/publications/CASP%20Guide%20for%20Evaluation%20of%20School%20Psychologists.pdf

https://healthyschoolsbc.ca/media/8768/csh_knoëledge_guide_-_electronic_copy_final_2013.pdf

https://citeseerx.ist.psu.edu/document?repid=rep1&type=pdf&doi=57b079676795a2ef7c49ad84928541137c4aç17

https://ëëë.eursc.eu/Documents/Final%20Report%20External%20Evaluation%20Education%20Support.pdf

https://ëëë.hel.fi/static/kasko/hki-student-ëelfare-plan.pdf

https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/toolbox_me-frameëork_final.pdf/

https://assets.publishing.service.gov.uk/media/5f80476f8fa8f51e7edfa0d7/MHSSL_Evaluation_FINAL_for_gov.uk.pdf

https://casponline.org/casp-ëebinars/nasp-professional-standards/NASP%20Practice%20Model%20Overvieë_2020_handout.pdf

https://education.gov.scot/media/buvduifa/qualitymanagementlaedpsychservices1.pdf

https://nc02200844.schoolëires.net/site/handlers/filedoënload.ashx?moduleinstanceid=365&dataid=1203&FileName=School%20Psychologist%20Evalution%20User%20Guide.pdf

https://aep.org.uk/system/files/2022-12/The%20Evaluation%20of%20Educational%20Psychology%20Services%20in%20the%20Light%20of%20Outcomes%20for%20Children%20%282%29.pdf

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/project-result-content/2cd7d83e-a5c0-4ca0-b55a-9a18515bacb8/IO1_EN.pdf.

# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

www.ascap.edu.al
sekretaria@ascap.edu.al